

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

RAPORT

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR

STRATEGJIA KOMBËTARE
E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME
UJË DHE KANALIZIMEVE, 2023-2030

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

VIZIONI 2030

Deklarata e Vizionit është një mesazh i thjeshtë por i fuqishëm që përshkruan punën e madhe për ofrimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizime si shërbime thelbësore dhe kritike për jetën e njeriut. Deklarata e kësaj Strategjie Sektoriale përcakton drejtimin ku do të fokusohen investimet duke synuar cilësinë më të lartë të shërbimeve për periudhën 2023-2030.

VIZIONI

Një sistem i besueshëm mbarë kombëtar për furnizimin me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura që plotësojnë nevojat për zhvillimin ekonomik dhe të shoqërisë në përgjithësi, duke ruajtur dhe mbrojtur mjedisin, shëndetin dhe sigurinë e popullsisë në Republikën e Shqipërisë.

Misioni i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime

Bazuar në aspiratat e qeverisë shqiptare për zbatimin e direktivave të BE-së, Deklarata e Misionit pasqyron qëllimin themelor të kësaj Strategjie.

DEKLARATA E MISIONIT

Hartimi i politikave të përshtatshme dhe angazhimi i fondeve të mjaftueshme për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura, dhe për të ecur në mënyrë të qëndrueshme drejt përputhjes me standardet e Bashkimit Europian dhe me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Deklarata e Misionit për këtë Strategji Sektoriale shërben për të përqendruar nismat e Qeverisë në gjashtë objektivat strategjike kyçe që duhet të adresohen, si në politika ashtu edhe në veprime, për të arritur përmirësimin e dëshiruar në shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizime.

Parimet Kryesore të Strategjisë së Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime

Strategjia e Sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizime mund të përcaktojë kushtet që duhen plotësuar si dhe mund të shërbejë si bazë për arritjen e Parimeve Kryesore të sektorit.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

PARIMET KRYESORE TË STRATEGJISË SË SEKTORIT

QËNDRUESHMËRI	Shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizime duhet të jenë ekologjiksht, teknikisht dhe financiarisht të qëndrueshëm përmes mbulimit të plotë të kostos.
PËRPUTSHMËRI	Sektori i furnizimit me ujë dhe kanalizime ofron qasje universale që i plotëson të gjitha kërkesat rregullatore / europiane sipas parimit ndotësi paguan.
EFIÇIENCË	Shoqëritë e furnizimit me ujë dhe kanalizime të kenë efikasitet dhe performancë të cilësisë së shërbimit të barabartë me praktikën e mirë evropiane dhe sipas parimeve të ekonomisë qarkulluese.
PËRBALLUESHMËRI	Të sigurohet ofrimi i shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për konsumatorët me një çmim të përballueshëm.
TRANSPARENCË	Të sigurohet pjesëmarrja e publikut dhe transparenca në politikat e ujit.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

SHKURTIMET – AKRONIMET

AKBN	Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore
AKM	Agjencia Kombetare e Mjedisit
AKUM	Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve
ALL	Lekë Shqiptar (monedhë)
AMBU	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore
ARM	Agjencia Rajonale e Mjedisit
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BAT	Best Available Techniques (TMD – teknikat më të mira të disponueshme)
BE	Bashkimi Evropian
CAPEX	Shpenzimet kapitale
ERRU	Enti Rregullator i Ujit
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
FU&K	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime
KBU	Këshilli i Baseneve Ujore
KE	Keshilli i Evropes
KKU	Këshilli Kombëtar i Ujit
OPEX	Shpenzimet Operimit dhe Mirëmbajtjes
OZHQ	Objektiva për Zhvillimin e Qëndrueshëm
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomise
MIE	Ministria Infrastruktures dhe Energjise
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
MSA	Marreveshja e Stabilizim Asocijimit
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NJQV	Njesite e Qeverisjes Vendore
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PKIE	Plani Kombetar per Integrimin Evropian
SHUKALB	Shoqata Ujësjiellës-Kanalizime e Shqipërisë
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
UPA	Uji pa të Ardhura
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZMBU	Zyra e Menaxhimit të Baseneve Ujore

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

PASQYRA E LENDES:

1	METODOLOGJIA E VSM.....	9
1.1	Çfare eshte VSM.....	9
1.2	Kuadri Ligjor i VSM.....	9
1.3	Fazat Kyç te Procesit te VSM.....	10
1.4	Metodologjia per hartimin e raportit te VSM	12
1.5	Strategjia dhe VSM.....	14
1.6	Procesi i Konsultimit.....	16
2	KONTEKSTI DHE KUSHTET AKTUALE NE SEKTORIN E FURNIZIMIT ME UJE	
	DHE KANALIZIMEVE.....	18
	Informacion i Përgjithshëm.....	18
	Gjeografia, Hidrografia dhe Klima	18
	Demografia	19
	Ekonomia	19
	<i>Burimet Ujore</i>	<i>20</i>
3	VIZIONI STRATEGJIK, POLITIKAT DHE OBJEKTIVAT E SEKTORIT TË	
	FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE, 2023-2030.....	22
3.1	VIZIONI 2030	22
3.2	Misioni i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime	22
3.3	Parimet Kryesore të Strategjisë së Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime	23
3.4	Qëllimet e Politikës dhe Rezultatet / Masat Prioritare	23
3.5	Politikat Strategjike në Mbështetje të Masave Prioritare për Sektorin	30
4	ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, LLOGARIDHËNIA, RAPORTIMI	
	DHE MONITORIMI.....	37
	Planet e detajuara të zbatimit	37
	Monitorimi dhe Raportimi i Strategjisë	38
	Përditësimi i Strategjisë	39
5	PLANET E VEPRIMIT NË MBËSHTETJE TË MASAVE PRIORITARE.....	41
	Nevojat dhe Burimet e Financimit	41
	Nevojat Kapitale për arritjen e Qëllimeve të Politikës dhe Masave Prioritare	41
	Nevojat Korente dhe Kapitale.....	43
	Nevojat Korente dhe Kapitale Totale të Investimeve për Periudhën e Planifikimit	43
	Burimi i Financimit.....	46
6	PERSHKRIMI MJEDISOR.....	47

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

6.1 Toka	47
6.2 Cilesia e ajrit	48
MONITORIMI I CILESISE SE AJRIT:.....	49
Vlerësimi i situatës nga grimcat e pluhurit (PM10).....	49
6.3 Faktoret klimaterike	51
VLERESIMI I NDRYSHIMIT DHE ADAPTIMIT	51
NDRYSHIMET E PARASHIKUARA NE REGJIMIN E TEMPERATURES	51
NDRYSHIMET E PARASHIKUARA NE REGJIMIN E RESHJEVE.....	52
Inventari Kombëtar i Gazeve me Efekt Serrë	53
6.4 Uji	54
6.5 Natyra.....	59
<i>PYJET</i>	59
<i>BIODIVERSITETI</i>	60
<i>FLORA</i>	60
<i>FAUNA</i>	61
<i>ZOGJTE</i>	61
<i>MBROJTJA E SPECIEVE DHE HABITATEVE</i>	61
<i>SPECIET ENDEMIKE DHE NEN-ENDEMIKE</i>	69
<i>RENDESIA E SHQIPERISE PER LLOJET GLOBALISHT TE RREZIKUAR</i>	69
<i>FLORA</i>	69
<i>FAUNA</i>	70
<i>RENDESIA E SHQIPERISE PER LLOJET SHTEGTARE</i>	71
<i>LLOJE ME RENDESI EKONOMIKE</i>	71
6.6 Zhurma.....	72
7 TENDENCAT E MUNDSHME NE TE ARDHMEN, PA STRATEGJINE (ALTERNATIVA "0")	75
7.1 Toka dhe burimet minerale.....	75
<i>PERDORIMI I TOKES BUJQESORE DHE PYJEVE</i>	75
<i>PERDORIMI I BURIMEVE NATYRORE</i>	75
7.2 Ajri	75
7.3 Faktoret klimaterike.....	76
<i>PERSHTATJA NDAJ NDRYSHIMEVE KLIMATIKE</i>	76
7.4 Uji	76
7.5 Biodiversiteti natyror.....	76
7.6 Trashegimia kulturore.....	77
7.7 Peizazhi	77
8 BAZA PER PERGATITJEN E VLERESIMIT MJEDISOR	78
8.1 Percaktimi i Objektivave Mjedisore.....	78
8.2 Identifikimi i ndikimeve mjedisore qe mund te shkaktohen nga infrastruktura e Furnizimit me uje dhe kanalizimeve	79
9 PERPUTHSHMERIA MJEDISORE E OBJEKTIVAVE	82

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

9.1 Vlerësimi i perputhshmerise se drejtimeve prioritare te strategjise me objektivat mjedisore te VSM.....	88
9.2 Analiza e perputhshmerise se drejtimeve prioritare te strategjise me objektivat mjedisore te VSM.....	100
10 VLERESIMI I NDIKIMEVE MJEDISORE.....	101
10.1 Biodiversiteti.....	101
<i>Ndikimet ne zonat me status te veçante mbrojtjeje.....</i>	<i>102</i>
10.2 Popullsia dhe Shendetet i Njeriut.....	103
10.3 Uji	104
10.4 Ndryshimet Klimatike.....	105
10.5 Toka	106
<i>Ndikimet qe lidhen me menaxhimin dhe perdorimin e qendrueshem te tokes.....</i>	<i>106</i>
<i>Ndikimet qe lidhen me shfrytëzimin e burimeve natyrore</i>	<i>107</i>
10.6 Trashegimia Kulturore	108
10.7 Peizazhi	109
10.8 Impaktet Kumulative te Strategjise Kombetare te Sektorit te Furnizimit me Uje dhe	109
Kanalizimeve	109
11 MASAT ZBUTESE.....	111
11.1 Biodiversiteti.....	111
11.2 Popullsia dhe Shendetet i Njeriut.....	114
11.3 Uji	115
11.4 Ndryshimet Klimatike.....	116
11.5 Toka	118
11.6 Trashegimia Kulturore	119
11.7 Peizazhi	120
12 MONITORIMI.....	121
13 KONKLIZIONE DHE REKOMANDIME	126
SHTOJCE 1.....	130
A. KONSULTIMI ME GRUPET E INTERESIT PËR ÇËSHTJET QË DO TË TRAJTOHEN NË RAPORTIN E VSM-së (SCOPING).....	130

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

Lista e tabelave

Tabela 1-1:Fazat kyç te procesit te VSM	10
Tabela 3-1: VIZIONI – MISIONI – QËLLIMET E POLITIKËS – REZULTATET / MASAT PRIORITARE	24
Tabela 3-2: Objektivat Strategjike dhe Indikatorët e Performancës	31
Tabela 4-1: Procesi i monitorimit	38
Tabela 4-2: Procesi i Monitorimit	39
Tabela 5-1:Kostot Kapitale për Njësi të përdorura për llogaritjen e Nevojave Kapitale	42
Tabela 5-2 Nevojat Kapitale (në Lekë)	44
Tabela 5-3: Burimet e Financimit	46
Tabela 6-1 Parashikimet e ndryshimeve ne temperature (°C) nga horizonte te ndryshme kohore te lidhura me vitin 1990	52
Tabela 6-2: Parashikimet e ndryshimeve ne reshje (%) nga horizonte te ndryshme kohore te lidhura me vitin 1990	52
Tabela 6-3: Vleresimi i perafert i perdorimit te ujit ne Shqiperi	55
Tabela 6-4:Lista e zonave te mbrojtura	65
Tabela 6-5: Vlera mesatare e zhurmes per qytetet e monitoruara, gjate dites dhe nates	73
Tabela 8-1: Identifikimi i ndikimeve te mundshme mjedisore	80
Tabela 9-1: Objektivat Strategjike dhe Indikatorët e Performancës	82
Tabela 9-2: Grafiku i veresimit te nivelit te perputhshmerise mes objektivate	88
Tabela 9-3: Vleresimi i Perputhshmerise se Objektivate te Strategjise Kombëtare te Sektorit të Furnizimit me UK, me Objektivat Mjedisore te VSM.....	90
Tabela 12-1: Model i Programit te Monitorimit te Ndikimeve ne Mjedis nga Strategjia	123

Lista e figurave

Figura 1-1: Lidhja mes proceseve te hartimit te Strategjise se Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime dhe VSM	15
Figura 2-1: Harta e Shqipërisë me 7 Basenet Ujore	21
Figura 4-1: Procesi i Përditësimit	40
Figura 6-1: Harta gjeologjike dhe tektonike e Shqiperise.....	47
Figura 6-2: Normat e Bashkimit European për ajrin urban	49
Figura 6-3 Vlerat mesatare të PM10 të monitoruara gjatë periudhës Prill-Dhjetor 2021.....	50
Figura 6-4 Ndryshimet e vlerave te temperaturave vjetore deri ne vitin 2100 sipas skenareve te ndryshem	51
Figura 6-5: Ndryshimi i parashikuar per reshjet vjetore (%)	53
Figura 6-6: Emetimet antropogjene të GES-ve në Shqipëri, të ndara sipas sektorëve (Gg CO ₂ e.)	54
Figura 6-7 Harta e Shqipërisë me 7 Basenet Ujore.....	57
Figura 6-8: Harta e zonave pyjore ne Shqiperi	59
Figura 6-9: Tabela permbledhese e Listes se Kuqe te specieve te flores dhe faunes.....	62
Figura 6-10: Speciet e mbrojtura te faunes se eger sipas grupeve kryesore te klasifikimit	62
Figura 6-11:Statusi i mbrojtjes per speciet e flores	63
Figura 6-12: Statusi i mbrojtjes per speciet e flores	63
Figura 6-13: Harta e zonave te mbrojtura	64
Figura 6-14 Harta e monitorimit të zhurmave, 2021	74

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

1 METODOLOGJIA E VSM

Ky kapitull pershkrvan qasjen e adoptuar, procesin e VSM-se, kufizimet e tij dhe procesin e konsultimit.

1.1 Çfare eshte VSM

Vleresimi Strategjik Mjedisor (VSM) eshte nje nga instrumentet kyç per integrimin e çeshtjeve mjedisore dhe parimeve te zhvillimit te qendrueshem ne planifikimin strategjik dhe vendim-marrjen. Ai eshte nje mjet i njohur globalisht per planifikimin me pjesemarrje qe perdoret per te analizuar dhe perfshire çeshtjet e mjedisit ne politikat, planet dhe programet e propozuara.

Vleresimi Strategjik Mjedisor mund te kuptohet si *“nje proces sistematik i cili parashikon dhe vlereson efektet e mundshme mjedisore gjate hartimit te nje plani apo programi, me qellim adresimin e ketyre efekteve ne menyre te pershtatshme qe ne fazat me te hershme te vendimmarrjes”*.

Qellimi i VSM-se mund te perkufizohet si garantimi qe konsideratat mjedisore informojne dhe integrohen ne vendim-marrjen strategjike ne mbeshtetje te nje zhvillimi te qendrueshem dhe te shendetshem nga kendveshtrimi mjedisor. Me konkretisht, procesi i VSM-se mbeshtet autoritetet pergjegjese per planet dhe programet, si dhe vendim-marresit, ne menyre qe ata te marrin ne konsiderate:

- Tendencat kyç mjedisore, potencialet dhe shqetesimet qe mund te prekin apo mund te preken nga plani apo programi;
- Objektivat dhe indikatoret mjedisore qe jane ne perputhje me planin apo programin;
- Efektet e mundshme dhe te konsiderueshme mjedisore te opsioneve te propozuara dhe te zbatimit te planit apo programit;
- Masat per te shmangur, zvogeluar apo zbutur efektet negative dhe ato per te rritur e perforcuar efektet pozitive;
- Pikepamje, sugjerime dhe informacion nga autoritetet perkatese, publiku dhe – sipas rastit – vendet fqinje qe preken nga zbatimi i planit apo programit.

Ne pergjithesi, VSM-ja aplikohet per plane, programe, politika dhe dokumente te tjere me natyre strategjike (perfshire mundesisht edhe dokumentet ligjore).

1.2 Kuadri Ligjor i VSM

Kuadri ligjor i VSM-se perfshin ne menyre te detyrueshme Ligjin Shqiptar per VSM-ne, nderkohe qe, per te qene koherent, nuk eshte lene menjane edhe kuadri ligjor nderkombetar. Referencat perkatese ligjore jane dhene me poshte:

- **Ligji nr. 91/2013 “Per Vleresimin Strategjik Mjedisor”**, i cili ka per qellim te siguroje mbrojtje te larte te mjedisit dhe zhvillim te qendrueshem, permes perfshirjes se

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

çeshtjeve të mjedisit gjatë hartimit, miratimit, rishikimit, ndryshimit ose modifikimit të planeve a programeve me pasoja të mundshme negative në mjedis. Ligji përcakton institucionet dhe autoritetet përkatëse, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, si dhe rregullat e procedurës për kryerjen e vlerësimit strategjik mjedisor. Ligji është përafëruar me Direktivën 2001/42/KE, datë 27 qershor 2001. Me shumë informacion gjendet në http://www.legjislacioni.gov.al/frontend/change_documents/129.

- **Direktiva 2001/42/EC e Komisionit Evropian** mbi vlerësimin e efekteve në mjedis prej planeve apo programeve të caktuara (Direktiva e VSM-se). Me shumë informacion gjendet në <http://ec.europa.eu/environment/eia/home.htm>.
- **Protokolli i VSM-se i hartuar dhe miratuar në Konventën e Espoo (UNECE)**. Me shumë informacion gjendet në http://www.unece.org/env/eia/sea_protocol.htm.

1.3 Fazat Kyç të Procesit të VSM

Në tabelën më poshtë përshkruhen fazat kyç të procesit të VSM.

Tabela 1-1: Fazat kyç të procesit të VSM

Faza	Përshkrimi
Shqyrtimi	Gjatë shqyrtimit identifikohet nevojja për VSM që aplikohet në një plan, program apo projekt specifik. Shqyrtimi si proces fokuson burimet tek ato plane, programe apo projekte të cilat mund të shkaktojnë efekte të konsiderueshme në mjedis dhe shëndet, dhe përjashton nga procesi i VSM-se ato të cilat kanë ndikime të vogla, ose nuk kanë fare ndikime. <i>Qëllimi i shqyrtimit është të identifikojë nëse VSM-ja duhet të aplikohet për një plan, program apo projekt specifik.</i>
Studimi i fusheveprimit të VSM	Çështjet e identifikuara gjatë studimit të shtrirjes /qëllimit të VSM-se do të orientojnë vlerësimin e gjendjes baze të mjedisit, vlerësimin aktual të ndikimeve të pritshme dhe konsideratat për opsione të mundshme alternative. VSM-ja merr në konsideratë përfshirjen e aspekteve me të gjera mjedisore apo sociale, siç janë adaptimet ndaj ndryshimeve klimatike, mundësitë për punësim etj. <i>Qëllimi i kësaj faze është të përcaktohen çështjet kyç që duhen adresuar në raportin e VSM-se.</i>

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

Faza	Pershkrimi
Analiza e gjendjes ekzistuese	<p>Analiza e gjendjes ekzistuese do te perbeje bazen per vleresimin e ndikimeve dhe perpilimin e skemes se monitorimit. Per VSM eshte e rendesishme te pervijohen tendencat e mundshme ne te ardhmen – keshtu qe duhet te behet analiza e tendencave ne te kaluaren, me qellim qe te parashikohen zhvillimet qe do te ndodhin. Vleresimi i ndikimeve te pritshme nuk mund te behet pa kuptuar mire gjendjen ekzistuese te cështjeve kyç te identifikuara ne fusheveprimin e VSM-se. <i>Qellimi i analizes se gjendjes ekzistuese eshte qe te orientoje drejt nje specifikimi me te mire te cështjeve kyç, dhe nje identifikimi me te mire te problemeve kryesore qe lidhen me planet, programet apo projektet perkatese.</i></p>
Analiza e ndikimeve dhe formulimi i masave zbutese	<p>VSM-ja analizon efektet e konsiderueshme negative si dhe ato pozitive te planeve te propozuara. Nje nga perfitimet kryesore prej VSM-se eshte se ai mundeson identifikimin e efekteve mjedisore te nje numri projektesh te perfshira ne dokumentin strategjik, dhe si i tille ai do te adresojë efektet e pritshme kumulative, te cilat mund te rezultojne prej aktiviteteteve te vogla individualisht, por te konsiderueshme te marra se bashku, qe do te kryhen per nje periudhe te caktuar kohore.</p> <p>Ne vijim te rreziqeve dhe ndikimeve te identifikuara, VSM-ja sugjeron masa zbutese per te adresuar efektet e pritshme negative si dhe per te rritur ndikimet pozitive qe do te vijne nga zbatimi i planeve, programeve apo projekteve perkatese. <i>Kjo faze ka per qellim te vleresojë efektet e konsiderueshme negative dhe pozitive te planeve perkatese, dhe, ne vijim te konkluzioneve te analizes se ndikimeve, te marre ne konsiderate alternativa dhe opsione, dhe te formuloje masat zbutese per te parandaluar, reduktuar dhe, sa me shume te jete e mundur, te kompensoje çdo ndikim te konsiderueshem negativ te planeve programeve apo projekteve perkatese.</i></p>
Hartimi i raportit te VSM-se	<p>Raporti i VSM-se permbledh te gjitha gjetjet dhe konkluzionet e nxjerra gjate gjithë procesit te VSM-se dhe sherben si baze per konsultimet me autoritetet perkatese dhe grupet e tjera te interesit. <i>Qellimi i kesaj faze eshte pergatitja e nje raporti te shkruar mire dhe te kuptueshem, i cili paraqet te gjithë informacionin dhe te dhenat e rendesishme, konkluzionet dhe rekomandimet ne nje menyre te qarte, dhe keshtu do te mundesojë konsultime efektive me autoritetet perkatese dhe grupet e tjera te interesit.</i></p>

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

Faza	Pershkrimi
Adoptimi	Jepet informacion mbi adoptimin e planit, programit apo projektit perkates, si jane reflektuar komentet dhe sugjerimet e procesit te konsultimeve, si dhe per metodat e monitorimit te efekteve te konsiderueshme mjedisore qe vijne nga zbatimi i planit, programit apo projektit perkates.
Monitorimi	Monitorimi i efekteve te konsiderueshme mjedisore dhe realizimi i veprimeve te duhura korrigjuese / zbutese per çdo efekt mjedisor te konsiderueshem te paparashikuar.

1.4 Metodologjia per hartimin e raportit te VSM

Shtimi i popullsisë, rritja e konsumit, prodhimi i mbetjeve urbane, inerte, ujerave te zeza, nevojat per urbanizim dhe shume faktore te tjere, ushtrojne presion ndaj perberesve te mjedisit, ujerave, tokes, ajrit duke rritur rreziqet mjedisore dhe demtimin e mjedisit. Gjate procesit te planifikimit, percaktimit te projekteve dhe strategjise se zhvillimit, nese nuk do t'i nenshtrohen procesit te VSM atehere gabimet dhe impaktet mjedisore do te ishin ne rritje. Bazuar ne parimin mjedisor te “parandalimit”, sipas te cilit çdo nderhyrje e planifikuar duhet te provoje paraprakisht, qe nuk do te kete pasoja negative ne mjedis, te gjitha vendet me legjislacion mjedisor bashkekohor kryejne ate qe quhet Vleresim Strategjik Mjedisor (VSM) per çdo nderhyrje, projekt apo investim konkret.

Per te kryer nje analize mjedisore dhe per te identifikuar problemet kryesore te ndikimeve ne mjedis, rendesi te veçante ka shtrirja ne problematikat me te rendesishme te sektorit te menaxhimit te mbetjeve dhe grumbullimi i tyre, poblematika te cilat jane evidentuar ne dokumentin e strategjise dhe pershkruhen shkurtimisht edhe Raportin te VSM.

Analiza mjedisore perfshin:

- ✓ Te dhena mbi biodiversitetin dhe zonat e mbrojtura, peizazhi, toka bujqesore, pyjet;
- ✓ Ndryshimet klimatike;
- ✓ Ndikimet mjedisore;
- ✓ Hidrologjine, te dhena klimatike dhe burimet ujore;
- ✓ Kushtet sizmike e tektonike;
- ✓ Historia, monumentet e kultures, arkeologjia;
- ✓ Popullsia;
- ✓ Profili ekonomik dhe punesimi.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

Metodologjia për hartimin e raportit të VSM është në përputhje me ligjin nr.91/2013 “Për VSM” i cili është i përafshirë plotësisht me Direktivën e BE: 2001/42/EC “Mbi Vlerësimin e Efekteve të disa Planeve dhe Programeve në Mjedis”.

Mbeshtetur në Ligjin nr. 91/2013, raporti i VSM duhet të përfshijë pikat e mëposhtme:

- a. Përmbledhje të qëllimit dhe objektivave kryesore të planit ose programit dhe përputhjes së tij me planet dhe programet e tjera që kanë lidhje me të si dhe me ligjet dhe politikat kombëtare dhe ndërkombëtare;
- b. Përmbledhje të metodikës së ndjekur për hartimin e raportit të VSM-së si dhe burimet e informacionit që u përdoren për qëllim hartimin e raportit;
- c. Përmbledhje të aspekteve të gjendjes aktuale të mjedisit si edhe zhvillimin e pritur të tij në rast se nuk zbatohet plani ose programi;
- d. Përmbledhje të karakteristikave mjedisore të zonës që ka të ngjarë të ndikohen në mënyrë të konsiderueshme nga plani ose programi;
- e. Përmbledhje të problemeve ekzistuese mjedisore të cilat kanë lidhje me planin ose programin;
- f. Përmbledhje të objektivave për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara në nivel kombëtar dhe/ose ndërkombëtar, të cilat kanë të bëjnë me planin dhe programin si dhe mënyrat në të cilat këto objektiva janë marrë parasysh gjatë përgatitjes së raportit;
- g. Përmbledhje të ndikimeve të mundshme dhe të konsiderueshme në mjedis duke përfshirë shëndetin publik, floren, faunën, biodiversitetin, token, klimën, ajrin, ujin, mbetjet urbane dhe të rrezikshme, burimet natyrore, peizazhin, trashëgiminë kulturore si dhe ndërveprimin ndërmjet këtyre faktorëve;
- h. Përmbledhje të pasojave të mundshme negative në mjedisin ndërkufitar, në rast se ka;
- i. Përmbledhje të masave të parashikuara për të parandaluar, reduktuar ose lehtësuar ndikimet negative në mjedis gjatë zbatimit të planit ose programit.
- j. Një përmbledhje për për zgjedhjen e alternativave të shqyrtuara, duke përfshirë vështirësitë e ndryshme ose mungesën e të dhënave që hasen gjatë përpilimit të raportit.
- k. Përshkrimin e masave të parashikuara për monitorimin e ndikimeve. Duke u mbështetur në sa më sipër VSM përfshin pikat e mëposhtme:
 - Një përmbledhje të informacionit për vlerësimin strategjik mjedisor;
 - Përshkrim të objektivave kryesore të Strategjisë;
 - Vlerësim të përputhshmërisë së objektivave të strategjisë me objektivat mjedisore;
 - Vlerësim të projekteve të propozuara në MP;

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

- Pershkrim te ndikimeve te mundshme dhe te konsiderueshme ne mjedis duke perfshire jeten e njerezve, floren, faunen, biodiversitetin, token, klimen, ujin, peizazhin, zonat natyrore, vlerat materiale, trashgimine kulturore, rreziqet mjedisore dhe kufizimi i tyre;
- Pershkrim te masave per te parandaluar, reduktuar ose lehtesuar ndikimet negative ne mjedis, qe mund te rezultojne nga zbatimi i planit.
- Pershkrimin e masave te parashikuara per monitorimin e ndikimeve.

1.5 Strategjia dhe VSM

VSM per strategjine eshte pergatitur per te permbushur kerkesat e Ligjit nr. 91/2013. Sipas ketij ligji kerkohet te kryhet nje vleresim mjedisor i planeve dhe programeve te caktuara te cilat ka te ngjare te kene efekte te konsiderueshme ne mjedis. Ne perputhje me dispozitat perkatese dhe ne vijim te komunikimit me Ministrine e Turizmit dhe Mjedisit, strategjia duhet t'i nenshtrohet procedures se VSM.

Qellimi dhe objekti kryesor i ligjit (Neni 1) eshte: “te siguroje mbrojtje te larte te mjedisit dhe zhvillim te qendrueshem, permes perfshirjes se ceshtjeve te mjedisit gjate hartimit, miratimit, rishikimit, ndryshimit ose modifikimit te planeve a programeve me pasoja te mundshme negative ne mjedis”.

VSM zhvillohet se bashku me zhvillimin e planit ose programit dhe shqyrtimin e opsioneve alternative. Efektet e konsiderueshme potenciale mjedisore vleresohen dhe paraqiten rekomandime per t'u diskutuar gjate konsultimeve publike. VSM siguron strategji zbutese dhe masa qe mund te perdoren per te minimizuar ose eliminuar efektet e atyre propozimeve te strategjise qe çojne ne ndikime negative, si dhe identifikimin e masave qe mund te permiresojne me tej ndikimet pozitive.


VSM perfshin nje proces perserites te mbledhjes se informacionit, percaktimin e alternativave/propozimeve, identifikimin e efekteve mjedisore, zhvillimin e masave zbutese dhe rishikimin e propozimeve ne driten e efekteve te parashikuara mjedisore.

Synimi eshte qe VSM te integrohet plotesisht ne procesin e hartimit te planit qe ne fazat me te hershme, duke informuar dhe duke u informuar prej tij.

Figura me poshe ilustron se si procesi i strategjise lidhet me procesin e VSM-se dhe nxjerr ne pah fazat kryesore ne procesin e VSM-se.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

Figura 1-1: Lidhja mes proceseve te hartimit te Strategjise se Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime dhe VSM



VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

1.6 Procesi i Konsultimit

Zhvillimi i Strategjisë së Sektorit të Shërbimeve të Ujësjetës Kanalizimeve 2023-2030 ka qenë një nismë e përbashkët e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Qeverisë Gjermane (përmes GIZ Albania). Ofrimi i ekspertizës profesionale u siguroi nga grupi i punës së ekspertëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë, të cilët kanë marrë pjesë aktive duke përfaqësuar aktorët kombëtarë të ministrive të linjës, institucionet qeveritare, OJQ të specializuara dhe/ose të interesuara, si Shoqata Ujësjetës-Kanalizime e Shqipërisë (SHUKALB), Shoqëritë UK, institucionet kërkimore, akademia dhe organizata të tjera të pavarura. Vlerësimet e veçanta shkojnë për Grupin e Punës së Strategjisë që ka qënë i përfshirë në mënyrë aktive me kompaninë **Konsulente Valu Add Management Services** për zhvillimin e kësaj strategjie.

Kjo Strategji Sektoriale për Shërbimet Ujësjetës Kanalizime për periudhën 2023 - 2030 është përgatitur me qëllim për të paraqitur Vizionin, Misionin, Qëllimin e Politikave dhe Planet e Veprimit në Shqipëri në mënyrë të qartë, specifike, sasiore dhe kohore, në përputhje me Angazhimet e Vendit tonë drejt arritjes së Objektivave për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara. Kjo Strategji e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime do të shqyrtohet nga Këshilli i Ministrave për të bashkërenduar objektivat dhe prioritetet kryesore të sektorit UK në Republikën e Shqipërisë, si dhe hartimin e propozimeve për zbatimin dhe financimin e politikave me qëllim arritjen e këtyre objektivave brenda periudhës 7 vjeçare të Strategjisë. Strategjia ndërthur gjetjet nga Konsultimet e Grupit Ndërmintor të Punës dhe analizat përkatëse, duke përfshirë një vlerësim të detajuar të situatës aktuale, kuadrin ligjor dhe rregullator, shpenzimet publike të planifikuara dhe burimet e financimit për sektorin e ujit.

Si një vend bashkëspansorizuese e Rezolutës së Kombeve të Bashkuara për ta bërë “Aksesin me Ujë të Pijshëm të sigurtë dhe Kanalizime si e drejtë e njeriut” është e angazhuar të demonstronjë, përmes fjalëve dhe veprimeve, që një vend i vogël dhe në zhvillim mund t'i përgjigjet një problemi global, dhe të bëjë atë cka i takon për të garantuar barazi për të gjithë qytetarët përse i përket të drejtave të njeriut në lidhje me ujin e pijshëm dhe kanalizimet. Epoka e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZHQ) është duke u zhvilluar dhe përfshin 17 objektiva aspirimi, 169 rezultate dhe 232 indikatorë që synojnë transformimin global brenda 7 viteve të ardhshme. Ekziston një objektiv specifik për ujin dhe kanalizimet, i cili shkon përtej ofrimit të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizime drejt menaxhimit të ujërave të ndotura, cilësisë së ujit në mjedis, efikasitetit të ujit, menaxhimit të integruar të burimeve ujore dhe mbrojtjes së ekosistemeve ujore si tregues të rëndësishëm.

Ne kuader të procesit të VSM janë organizuar 2 degjese me grupet e interesit, perkatesisht per procesin e identifikimit te ceshtjeve qe do te trajtoheshin ne raportin e VSM (scoping) me 03.03.2023, si dhe eshte konsultuar dhe MTM ne forme zyrtare, e cila eshte pergjigjur ne forme shkresore per ceshtjet qe duhet te merreshin ne konsiderate gjate ketij studimi te VSM. Degjese e dyte eshte zhvilluar per te konsultuar draft raportin e VSM me xx.xx.2023, ku kane marre

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

pjesë përfaqësues të institucioneve shtetërore të përfshira në këtë proces dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Gjate këtyre takimeve nuk ka patur komente apo sugjerime konkrete në kuadër të studimit mjedisor (VSM), por kryesisht janë fokusuar në zbatimin në praktik të vetë strategjisë nga institucionet që ngarkohen me përgjegjësi në këtë strategji, veçanërisht ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve dhe bashkitë.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

2 KONTEKSTI DHE KUSHTET AKTUALE NE SEKTORIN E FURNIZIMIT ME UJE DHE KANALIZIMEVE

Përmbledhje e gjendjes aktuale të sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve

Informacion i Përgjithshëm

Qëllimi i Strategjisë është të përmirësojë cilësinë e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizime për qytetarët e Shqipërisë. Gjithashtu, të mbështesë zhvillimin ekonomik të vendit, bazuar në kryerjen e një shërbimi kryesor të infrastrukturës. Për të realizuar përmbushjen e këtij qëllimi, është thelbësore që strategjia të përcaktojë disa të dhëna bazë dhe informacione që kanë të bëjnë me popullsinë, modelet e saj të ndryshimit dhe gjendjen ekonomike të popullsisë.

Strategjia synon vendosjen e qëllimeve dhe objektivave kombëtare për përmirësimin e aksesit me shërbimin ujësjellës kanalizime. Adresimi i problematikave në sektorin e ujësjellës kanalizimeve synohet të arrihet mbi një kuadër transparent nëpërmjet angazhimit të vazhdueshëm institucional dhe mobilizimit të burimeve financiare të nevojshme.

Gjeografia, Hidrografia dhe Klima

Shqipëria shtrihet në pjesën jugperëndimore të Gadishullit Ballkanik kufizuar nga Mali i Zi në veriperëndim, Kosova në verilindje, Republika e Maqedonisë së Veriut në lindje dhe Greqia në jug dhe juglindje. Shumica e vendit ka reliev malor, duke përfshirë Alpet shqiptare në veri, Malet e Korabit në lindje, Malet Cerauniane në jug dhe Malet e Skënderbeut në qendër. Bregdeti i vendit prek Detin Adriatik në veriperëndim dhe Detin Jon në jugperëndim duke përfshirë edhe Rivierën Shqiptare. Shqipëria është rreth 72 km (45 mi) nga Italia në të gjithë Ngushticën e Otrantos që lidh Adriatikun me Jonin.

Vendi ka një rrjet të dendur lumenjsh të karakterizuara nga një shkallë e lartë prurjesh. Ata i përkasin baseneve ujorë të Adriatikut, Egjeut dhe Detit të Zi. Lumenjtë e vendit kryesisht burojnë në gjysmën malore lindore të vendit dhe kanë grykderdhjen e tyre në perëndim përgjatë brigjeve. Ata ushqehen nga shkrirja e borës nga malet e mbuluara me dëborë ose nga reshjet e bollshme që bien në lartësi më të larta. Tetë lumenj të mëdhenj, së bashku me degët e tyre të shumta, përbëjnë sistemin e lumenjve të vendit.

Me më shumë se 250 liqene, Shqipëria ka në territorin e saj dy prej liqeneve më të mëdhenj në Evropën Jugore (Liqeni i Shkodrës dhe i Ohrit) dhe një nga më të vjetrat në botë. Liqenet e vendit janë kryesisht me origjinë karstike ose glaciale. Shqipëria është gjithashtu vendi i shumë lagunave me formë, madhësi dhe strukturë të ndryshme. Lagunat janë të vendosura kryesisht përgjatë bregdetit në perëndim të vendit dhe gjithashtu në juglindje. Ato kontribuojnë në produktivitetin e përgjithshëm të ujërave bregdetare duke mbështetur një shumëllojshmëri të habitateve dhe ekosistemeve.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE, 2023-2030

Shqipëria karakterizohet nga një klimë mesdhetare kontinentale me dimër të ftohtë dhe verë të nxehtë. Shqipëria ka burime të mjaftueshme ujore, të barabarta me 8,700 metra kub për frymë në vit.

Ultësirat kanë dimër të butë, mesatarisht rreth 7°C (45°F). Temperaturat verore është mesatarisht 32°C (90° F), lagështia është e ulët. Në ultësirën jugore, temperaturat variojnë mesatarisht rreth 5°C (41°F) gjatë dimrit dhe 30°C (86°F) gjatë verës.

Mesatarja vjetore e reshjeve në ultësirën perëndimore është nga 1.000 milimetra (39.37 in) deri në më shumë se 1.500 milimetra (59.06 in) në vit, me nivele më të larta në veri. Gati 95% e reshjeve bie në dimër. Vargmalet, kryesisht në zonat malore karakterizohen nga reshje më të dendura dhe me frekuenca të shpeshta. Nuk janë të disponueshme të dhëna të mjaftueshme dhe vlerësimet ndryshojnë shumë, por mesataret vjetore janë ndoshta rreth 1,800 milimetra (70,87 in) dhe shkojnë deri në 2,550 milimetra (100,39 in) në disa zona veriore.

Demografia

Popullsia rezidente e Shqipërisë, siç përcaktohet nga Instituti i Statistikave (INSTAT), është vlerësuar 2,845,955 banorë më 1 janar 2020. Shkalla e përgjithshme e fertilitetit të vendit prej 1.51 fëmijëve të lindur për grua është një nga më të ultat në botë. Dendësia e popullsisë është 259 banorë për kilometër katror. Jetëgjatësia e përgjithshme mesatare është 78.5 vjet; ku 75.8 vjet për meshkujt dhe 81.4 vjet për femrat. Shqipëria është vendi i 8-të më i populluar në Ballkan dhe renditet i 137-të më i populluar në botë. Popullsia e vendit u rrit në mënyrë të vazhdueshme nga 2.5 milionë në vitin 1979 deri në 1989, kur arriti në 3.1 milionë. Është parashikuar që popullsia nuk mund të arrijë numrin e saj të pikut të vitit 1989 deri në vitin 2031, duke marrë parasysh shkallën aktuale të lindjeve dhe nivelin e migrimit.

Rreth 53.4% e popullsisë së vendit jetojnë në qytete. Tre bashkitë më të mëdha (Tiranë, Durrës dhe Fier) përbëjnë gjysmën e popullsisë totale. Gati 30% e popullsisë totale banon në Bashkinë e Tiranës, pasuar nga Bashkia Durrës me 11% dhe Bashkia Fier me 10%. Mbi 1 milion njerëz janë të përqendruar në Tiranë dhe Durrës, duke e bërë atë zonën më të madhe urbane në Shqipëri. Tirana është një nga qytetet më të mëdha në Gadishullin Ballkanik dhe renditet e shtata me një popullsi rreth 800,000 banorë.

Ekonomia

Transformimi ekonomik i vendit vazhdon të bazohet mbi potencialin dhe mundësitë e tij. Megjithatë, kriza globale financiare evidentoi dobësitë e modelit të rritjes dhe theksoi nevojën për t'u zhvendosur nga nxitja e konsumit drejt rritjes së investimeve dhe eksportit.

Qeveria e Shqipërisë në vitet e fundit ka filluar një program të gjerë të fokusuar në qëndrueshmërinë makroekonomike dhe fiskale, stabilizimin e sektorit financiar, përmirësimin e sektorit energjitik, pensionet dhe administratën vendore. Progresi i rëndësishëm, i nxitur nga reformat e vazhdueshme, ka krijuar kushtet për rimëkëmbjen e besimit të biznesit dhe rritjen e

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

kërkesës së brendshme, duke përfshirë rritjen e investimeve publike dhe të eksporteve. PBB-ja reale e Shqipërisë në 2021 u rrit me 8.5%, duke e krahasuar me vitin 2020¹.

Burimet Ujore

Burimet e ujit të pijshëm përbëjnë një aset të madh për Shqipërinë. Sasia mesatare e ujit të pijshëm në dispozicion llogaritet në 8,700 metra kub për frymë në vit², që është një nga më të lartat në Evropë. Burimet e ujit të pijshëm në vend ekzistojnë në formën e burimeve natyrore, lumenjve, liqeneve dhe ujërave nëntokësore. Furnizimi me ujë të pijshëm vjen kryesisht nga burime natyrore dhe burime ujore nëntokësore, me përjashtim të dy rasteve si: zona metropolitane e Tiranës, e cila merr një pjesë të furnizimit të saj nga një burim uji sipërfaqësor në malet ku është ndërtuar një digë për të krijuar një rezervuar artificial, që rrjedhimisht duhet trajtuar; dhe zona turistike e Kavajës e cila merr një pjesë të furnizimit të saj në sezonin veror nga liqeni artificial i Maskurisë, i cili ka krijuar natyrshëm dhe gradualisht një rezervuar sipërfaqësor që duhet të trajtohet.

Burimet ujore në Shqipëri shpërndahen në mënyrë hidrografike në shtatë(7) basene ujore³, të cilat të gjitha rrjedhin në një drejtim perëndimor ose veri-perëndimor në të gjithë vendin dhe kanë si sistemet kryesore të tyre të lumenjve, nga veriu në jug, respektivisht: Lumenjtë Drini-Buna, Lumi Mati, Lumi Ishem, Lumi Erzeni, Lumi Shkumbin, Lumi Semani dhe Lumi Vjosa. Vlen të përmendet se këto sisteme të lumenjve përshkojnë jo vetëm Shqipërinë, por edhe pjesë të mëdha të zonave të banuara të Maqedonisë së Veriut, Kosovës dhe Malit të Zi.

Kapaciteti mesatar vjetor i të gjitha burimeve të ujit të përdorura për prodhimin e ujit të pijshëm të shoqërive ujësjellës-kanalizime të monitoruar për vitin 2021 ishte 495 milion metra kub. Referuar raportit vjetor të bilancit vjetor të ERRU-se për vitin 2021, vëllimi i përgjithshëm i ujit të prodhuar ishte 311,2 milion metra kub, ndërsa kërkesa totale e vëllimit të ujit në të gjitha zonat e juridiksionit të shoqërive ujësjellës-kanalizime për vitin 2021 për popullsinë totale (census 2011) ishte 100 milion metra kub.

Bazuar në sa me sipër, uji total i disponueshëm për të gjitha shoqëritë UK tejkalon kërkesën kombëtare nga konsumatorët që ato shërbejnë me rreth 80%. Megjithatë kjo na tregon se kapaciteti ujqor është i mjaftueshëm, bazuar në raportet Vjetore të Bilancit të Ujit të hartuara nga ERRU, ka dallime të dukshme ndërmjet shoqërive ujësjellës-kanalizime dhe në raste të veçanta ka disa shoqëri UK për të cilat kerkohen burime të reja shtese të furnizimit me uje. Niveli humbjeve të ujit rezulton të jetë i lartë në shumicën e shoqërive UK.


¹ www.financa.gov.al Treguesit Kryesorë Makroekonomik 2021

² Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore 2018-2027.

³ VKM Nr. 696, datë 30.10.2019 "Për miratimin e kufijve territorialë dhe hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe krijimin dhe përbërjen e këshillit të tyre"

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

Figura 2-1: Harta e Shqipërisë me 7 Basenet Ujore



VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

3 VIZIONI STRATEGJIK, POLITIKAT DHE OBJEKTIVAT E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE, 2023-2030

Në një botë që ndryshon çdo ditë e më shumë, Sektori i Shërbimeve Ujësjetës dhe Kanalizimeve duhet të jetë një sektor i qëndrueshëm dhe i besueshëm. Një ndër prioritetet e Qeverisë Shqiptare është ofrimi i shërbimeve të avancuara të furnizimit me ujë dhe kanalizime si dhe menaxhimi i integruar i ujit në lidhje me zhvillimin ekonomik.

Kjo është arsyeja pse Strategjia Kombëtare thekson veprimet që duhen ndërmarrë për të trajtuar njerëzit dhe mjedisin si pasuritë më të mëdhaja.

Në zbatim të kësaj Strategjie, investimet në sektorin e shërbimeve ujësjetës kanalizime mund të jenë një mjet ndihmues për rritjen e shpejtë ekonomike, zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e shëndetit të qytetarëve shqiptarë. Prandaj, uji konsiderohet si një sektor ekonomik i rëndësishëm për Shqipërinë.

3.1 VIZIONI 2030

Deklarata e Vizionit është një mesazh i thjeshtë por i fuqishëm që përshkruan punën e madhe për ofrimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizime si shërbime thelbësore dhe kritike për jetën e njeriut. Deklarata e kësaj Strategjie Sektoriale përcakton drejtimin ku do të fokusohen investimet duke synuar cilësinë më të lartë të shërbimeve për periudhën 2023-2030.

VIZIONI

Një sistem i besueshëm mbarë kombëtar për furnizimin me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura që plotësojnë nevojat për zhvillimin ekonomik dhe të shoqërisë në përgjithësi, duke ruajtur dhe mbrojtur mjedisin, shëndetin dhe sigurinë e popullsisë në Republikën e Shqipërisë.

3.2 Misioni i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime

Bazuar në aspiratat e qeverisë shqiptare për zbatimin e direktivave të BE-së, Deklarata e Misionit pasqyron qëllimin themelor të kësaj Strategjie.

DEKLARATA E MISIONIT

Hartimi i politikave të përshtatshme dhe angazhimi i fondeve të mjaftueshme për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura, dhe për të ecur në mënyrë të qëndrueshme drejt përputhjes me standardet e Bashkimit Europian dhe me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Commented [M1]: Informacion i perseritur si ne fillim te VSM

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

Deklarata e Misionit për këtë Strategji Sektoriale shërben për të përqendruar nismat e Qeverisë në gjashtë objektivat strategjike kyçe që duhet të adresohen, si në politika ashtu edhe në veprime, për të arritur përmirësimin e dëshiruar në shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizime.

3.3 Parimet Kryesore të Strategjisë së Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime

Strategjia e Sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizime mund të përcaktojë kushtet që duhen plotësuar si dhe mund të shërbejë si bazë për arritjen e Parimeve Kryesore të sektorit.

PARIMET KRYESORE TË STRATEGJISË SË SEKTORIT	
QËNDRUESHMËRI	Shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizime duhet të jenë ekologjikisht, teknikisht dhe financiarisht të qëndrueshëm përmes mbulimit të plotë të kostos.
PËRPUTHSHMËRI	Sektori i furnizimit me ujë dhe kanalizime ofron qasje universale që i plotëson të gjitha kërkesat rregullatore / europiane sipas parimit ndotësi paguan.
EFIÇIENCË	Shoqëritë e furnizimit me ujë dhe kanalizime të kenë efikasitet dhe performancë të cilësisë së shërbimit të barabartë me praktikën e mirë evropiane dhe sipas parimeve të ekonomisë qarkulluese.
PËRBALLUESHMËRI	Të sigurohet ofrimi i shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për konsumatorët me një çmim të përballueshëm.
TRANSPARENCË	Të sigurohet pjesëmarrja e publikut dhe transparencë në politikat e ujit.

3.4 Qëllimet e Politikës dhe Rezultatet / Masat Prioritare

Vizioni Misioni, Qëllimet e Politikës dhe Rezultatet / Masat Prioritare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime janë paraqitur grafikisht në Tabelën 2. Masat Prioritare do të shtjellohen më tej në aneksin 1 të Strategjisë duke përfshirë përcaktime si specifike, të matshme dhe afatet kohore.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE, 2023-2030

Tabela 3-1: VIZIONI – MISIONI – QËLLIMET E POLITIKËS – REZULTATET / MASAT PRIORITARE

VIZIONI					
Një sistem i besueshëm mbarë kombëtar për furnizimin me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura që plotësojnë nevojat për zhvillimin ekonomik dhe të shoqërisë në përgjithësi, duke ruajtur dhe mbrojtur mjedisin, shëndetin dhe sigurinë e popullsisë në Republikën e Shqipërisë.					
MISIONI					
Hartimi i politikave të përshtatshme dhe angazhimi i fondeve të mjaftueshme për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura, dhe për të ecur në mënyrë të qëndrueshme drejt përputhjes me standardet e Bashkimit Europian dhe me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.					
Qëllimi i Politikës 1	Qëllimi i Politikës 2	Qëllimi i Politikës 3	Qëllimi i Politikës 4	Qëllimi i Politikës 5	Qëllimi i Politikës 6
Zgjerimi dhe përmirësimi i aksesit në sistemet e furnizimit me ujë për popullsinë.	Zgjerimi dhe përmirësimi i aksesit në sistemet për grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura për popullsinë.	Zbatimi i programit për riorganizimin e shërbimeve UK në baza rajonale.	Përmirësimi i qëndrueshmërisë financiare dhe përbalueshmërisë së shërbimeve UK sipas parimeve të kontrollit dhe mbulimit të plotë të kostove operacionale.	Rritja e kapaciteteve dhe miradministrimi i shërbimeve UK.	Përmirësimi dhe përditesimi i kuadrit ligjor, rregullator që mundëson ofrimin e shërbimeve UK për popullsinë.
REZULTATET / MASAT PRIORITARE	REZULTATET / MASAT PRIORITARE	REZULTATET / MASAT PRIORITARE	REZULTATET / MASAT PRIORITARE	REZULTATET / MASAT PRIORITARE	REZULTATET / MASAT PRIORITARE
Identifikimi dhe raportimi i treguesve tekniko – financiar për shoqëritë SPKUK <u>Rezultatet e parashikuara:</u> <i>Proçeset e Identifikimit për vitin 2023:</i> <i>Matja e saktë e sasisë së ujit në prodhim për zonat urbane.</i> <i>Matja e saktë e sasisë së ujit në prodhim për zonat rurale.</i>	Rritja e aksesit të popullsisë të lidhur me sistemin e grumbullimit dhe largimit të ujrave të ndotura. <u>Rezultatet e parashikuara:</u> <i>Mbulimi me sistemin e grumbullimit dhe largimit të ujrave të ndotura:</i>	Zhvillimi i një programi të bashkërenduar me NJQV për riorganizimin e të gjithë shoqërive egzistuese UK në shoqëri rajonale si Subjekte të Kompetencave të Përbashkëta UK. <u>Rezultatet e parashikuara:</u> <i>Plani deri në 2025: 15 shoqëri rajonale janë krijuar dhe rregjistruar në QKB.</i>	Mbulimi i kostove të mirëmbajtjes, dhe shpenzimeve kapitale për riparime dhe zëvendësime. <u>Rezultatet e parashikuara:</u> <i>Plani deri në 2025: Mbulimi i Kostos Totale në masën 72%</i> <i>Plani deri në 2030: Mbulimi i Kostos Totale në masën 95%</i>	Hartimi i një platforme dhe mekanizimeve për zhvillimin e njohurive dhe trajnimeve për të gjithë aktorët sektorialë në nivel qendror dhe lokal. <u>Rezultatet e parashikuara:</u> <i>Plani deri në 2024: Plani kombëtar i hartuar për zhvillimin e kapaciteteve në nivel qendror rajonal dhe lokal.</i>	Përmirësimi dhe zgjerimi i akteve ligjore dhe rregullatore të nevojshme për të lehtësuar procesin e riorganizimit të shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura, në baza rajonale. <u>Rezultatet e parashikuara:</u> <i>Plani afatshkurtër deri 2024: Miratim i standarteve të shërbimit për shoqëritë rajonale UK dhe përgatitja e</i>

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE, 2023-2030

<p><i>Vlerësimi i humbjeve teknike dhe administrative.</i></p> <p><i>Vlerësimi i saktë i zonës së mbulimit me ujë dhe kanalizime të ndarë në zona urbane / rurale.</i></p> <p><i>Identifikimi i mbulimit të Kostove O&M me Arkëtimet</i></p> <p><i>Identifikimi i Arkëtimeve Korente dhe Totale</i></p>	<p><i>Plani deri në 2025: 55.5 %</i> <i>Plani deri ne 2030: 65.5 %</i></p>			<p><i>Plani deri në 2027: Platforma për zhvillimin e kapaciteteve funksionale dhe e administruar nga AKUM.</i></p>	<p><i>bazes ligjore qe I jep mundesi qeverise te nderhyje ne sktor duke marre drejtimin e shoqerive te cilat nuk lotesojne standardet e licensimit ose operojne per me shume se 2 vite te njepasnjeshme me kapital ngativ.</i></p> <p><i>Plani afatmesëm deri në 2027: Aktet e nevojshme rregullatore përkatësisht për licensimin, vendosjen e tarifave, rregullave uniforme etj. jane plotësisht efektive në funksion të aktivitetit për ofrimin e shërbimeve.</i></p>
<p>Rritja e aksesit të popullsisë në sistemet e furnizimit me ujë të sigurt e cilësor.</p> <p><u>Rezultatet e parashikuara:</u></p> <p><i>Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë:</i></p> <p><i>Plani deri në 2025: 82 %</i> <i>Plani deri në 2030: 90 %</i></p>	<p>Rritja e aksesit të popullsisë të lidhur me një impiant të trajtimit të ujrave të ndotura.</p> <p><u>Rezultatet e parashikuara:</u></p> <p><i>Mbulimi me sistemin e trajtimit të ujrave të ndotura:</i></p> <p><i>Plani deri në 2025: 16.5 %</i> <i>Plani deri ne 2030: 25 %</i></p>	<p>Ristrukturimi dhe reformimi rrënjësor i institucioneve qëndrore në funksion të zbatimit të programit për riorganizimin e shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura në baza rajonale.</p> <p><u>Rezultatet e parashikuara:</u></p> <p><i>Plani deri në 2023: Struktura e re e AKUM e miratuar nga KM dhe e plotësuar me stafin dhe infrastrukturën e nevojshme</i></p>	<p>Zhvillimi dhe unifikimi gradual i tarifave sipas zonave rajonale të shërbimit, për të mundësuar gradualisht, mbulimin e plotë të kostove duke synuar mbrojtjen e konsumatorët me të ardhura të ulta.</p> <p><u>Rezultatet e parashikuara:</u></p> <p><i>Plani deri në 2024: Harmonizimi i tarifave te ujit dhe kanalizimeve për 5 Shoqëri Rajonale sipas metodologjisë se përcaktuar nga ERRU.</i></p> <p><i>Plani deri në 2027: Harmonizimi i tarifave te ujit dhe kanalizimeve për 15</i></p>	<p>Zbatimi i vazhdueshëm i programit për trajnimin e punonjësve të shoqërive rajonale UK për rritjen e kapaciteteve profesionale, forcimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimin e eksperiencave mes tyre.</p> <p><u>Rezultatet e parashikuara:</u></p> <p><i>Plani afatshkurtër deri në 2024: 1 % e fondit të pagave do të alokohet për trajnimin e vazhdueshem të personelit në nivel qëndror, rajonal dhe lokal.</i></p>	<p>Hartimi i ligjit te ri sektorial për shërbimet e furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura, me qëllim ngritjen e mekanizmave për bashkërendimin e politikave dhe përgjegjësi të aktorëve kryesorë sektorialë.</p> <p><u>Rezultatet e parashikuara:</u></p> <p><i>Plani deri 2024: Miratim në parlament i projektligjit për shërbimet e furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura.</i></p> <p><i>Plani deri në 2027: Miratim dhe zbatim i aktet ligjore dhe nënligjorë në zbatim të ligjit</i></p>

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE, 2023-2030

		<p><i>Plani deri ne 2025:</i></p> <p><i>AKUM akreditohet për të të administruar fonde të BE_se për infrastrukturën e furnizimit me ujë dhe kanalizimet.</i></p> <p><i>Plani deri ne 2030: AKUM, qënder ekselence dhe inovacioni për administrimin e shërbimeve dhe teknologjinë e Informacionit.</i></p>	<p><i>Shoqëri Rajonale sipas metodologjisë se përcaktuar nga ERRU.</i></p>	<p><i>Plani afatmesëm deri në 2027:</i></p> <p><i>1.5 % e fondit të pagave do të alokohet për trajnimin e vazhdueshëm të personelit në nivel qëndror, rajonal dhe lokal.</i></p> <p><i>Plani afatgjatë deri në 2030:</i></p> <p><i>2 % e fondit të pagave do të alokohet për trajnimin e vazhdueshëm të personelit në nivel qëndror, rajonal dhe lokal.</i></p>	<p><i>për shërbimet e furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura.</i></p>
<p>Rritja e orëve të furnizimit me ujë për popullsinë në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërive rajonale UK.</p> <p><u>Rezultatet e parashikuara:</u></p> <p><i>Orët e furnizimit me ujë:</i></p> <p><i>Plani deri në 2025: 18 orë/ditë</i> <i>Plani deri në 2030: 24 orë/ditë</i></p>	<p>Ngritja e një sistemi për monitorimin dhe vlerësimin e ecurisë dhe impaktit të zbatimit të procesit për riorganizimin e shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura në baza rajonale.</p> <p><u>Rezultatet e parashikuara:</u></p> <p><i>Plani deri në 2024:</i></p> <p><i>Sisteme i monitorimit dhe vlerësimit i ngritur brenda AKUM dhe funksional</i></p> <p><i>Plani deri në 2027:</i></p> <p><i>Raporte vjetore per monitorimin dhe vlerësimin</i></p>	<p>Rritja e nivelit të arkëtimit, duke synuar zbatimin e praktikave më të mira ndërkombëtare.</p> <p><u>Rezultatet e parashikuara:</u></p> <p><i>Plani deri në 2025:</i> <i>Niveli arkëtimit korrent: 90%</i> <i>Plani deri në 2030:</i> <i>Niveli arkëtimit korrent: 100%</i></p>	<p>Zbatimi i programit kombëtar të certifikimit sipas objektivave që janë përcaktuar për secilën shoqëri rajonale UK.</p> <p><u>Rezultatet e parashikuara:</u></p> <p><i>Plani afatshkurtër deri në 2024:</i></p> <p><i>Manuali i rishikuar për trajnimin dhe certifikimin e punonjësve të shoqërive rajonale UK.</i></p> <p><i>Plani afatmesëm deri në 2027:</i></p> <p><i>Programi i certifikimit funksional dhe i administruar nga AKUM.</i></p> <p><i>Plani afatgjatë deri në 2030:</i></p>	<p>Harmonizimi i kuadrit ligjor kombëtar për shërbimet e furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura në përputhje me direktivat e BE për ujin.</p> <p><u>Rezultatet e parashikuara:</u></p> <p><i>Plani deri në 2024:</i> <i>VKM për përafrimin e legjislacionit me direktivën për trajtimin e ujrave të ndotura urbane.</i></p> <p><i>Plani deri në 2027:</i> <i>Përputhje e plotë e legjislacionit shqiptar për ujin me direktivat e BE.</i></p> <p><i>Plani deri në 2030:</i></p>	

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE, 2023-2030

		<i>e ndikimit në cilësinë e shërbimeve dhe qëndrueshmërinë financiare.</i>		<i>Stafi administrues dhe operues i çdo shoqërie rajonale është i trajnuar dhe certifikuar.</i>	<i>Zbatimi i plotë i legjislacionit dhe monitorimi.</i>
<p>Hartimi i planeve për përdorimin e ujit me efikasitet në të gjithë sektorët, duke siguruar furnizim të qëndrueshëm dhe duke rritur ndjeshëm ripërdorimin e tij sipas parimeve të ekonomisë qarkulluese.</p> <p><u>Rezultatet e parashikuara:</u></p> <p><i>Plani deri në 2025: Rregullore për ripërdorimin e ujit;</i></p> <p><i>Plani deri në 2027:</i></p> <p><i>3 shoqëri rajonale UK zbatojnë planin sipas parimeve të ekonomisë qarkulluese.</i></p> <p><i>Plani deri në 2030: Model efektiv ekonomik për ofrimin dhe administrimin e shërbimeve UK sipas parimeve të ekonomisë qarkulluese.</i></p>	<p>Vlerësimi i efekteve të agregimit të shoqërive dhe vijimi i procesit.</p> <p><i>Rezultatet e parashikuara:</i></p> <p><i>Plani afatshkurtër deri në 2024: Vlerësimi i efekteve të procesit të agregimit në performancën e sektorit.</i></p> <p><i>Plani afatmesëm deri në 2027: Te vlerësohet nga AKUM mundësia për të vijuar procesin e ristrukturimit të sektorit duke kaluar në një fazë tjetër agregimi për uljen e metejshme të numrit të shoqërive ose krijimi i nje modeli të ri tregu ku të përfaqësohet ndarja dhe specializimi i shoqërive sipas funksioneve, prodhim teknike, komerciale ose përfaqësojnë e operatoreve privat.</i></p>	<p>Përmirësimi i sistemit të faturimit dhe instalimi i sistemit të pagesave online për konsumatorët.</p> <p><u>Rezultatet e parashikuara:</u></p> <p><i>Plani deri në 2024: Sistem i unifikuar i faturimit në të gjithë shoqëritë rajonale (50%)</i></p> <p><i>Plani deri në 2027: Leximi (aksesi) online i faturës nga konsumatorët për të gjithë shoqëritë rajonale UK.</i></p> <p><i>Plani deri në 2030: Sistemi i pagesës online për të gjithë shoqëritë rajonale UK.</i></p>	<p>Implementimi i një strukture re eficiente të unifikuar për shoqëritë rajonale UK.</p> <p><u>Rezultatet e parashikuara:</u></p> <p><i>Plani deri në 2023: Strukturë e unifikuar dhe e miratuar në të gjithë shoqëritë rajonale UK.</i></p>	<p>Hartimi dhe Zbatimi i Paketave të Ndërgjegjësimit dhe Informimit për Qytetarët.</p> <p><u>Rezultatet e parashikuara:</u></p> <p><i>Plani afatshkurtër deri në 2024:</i></p> <p><i>Plani kombëtar për informimin dhe ndërgjegjësimin.</i></p> <p><i>Plani afatmesëm deri në 2027:</i></p> <p><i>Platformë vjetore për organizimin e fushatave sensibilizuese në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.</i></p>	

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE, 2023-2030

<p>Hartimi dhe zbatimi i planeve rajonale për reduktimin i nivelit të Ujit Pa të Ardhura.</p> <p><u>Rezultatet e parashikuara:</u> Uji pa të ardhura:</p> <p>Plani deri në 2025: 60 % Plani deri në 2030: 45%</p>			<p>Hartimi dhe zbatimi efektiv i nje sistemi te unifikuar te menaxhimit dhe mirembajtjes se aseteve per shoqëritë rajonale UK.</p> <p><u>Rezultatet e parashikuara:</u></p> <p>Plani deri në 2025:</p> <p>Standarte të unifikuar për vlerësimin të aseteve në të gjithë shoqëritë rajonale UK</p> <p>Plani deri në 2027:</p> <p>Sistemi i digjitalizuar për administrimin e aseteve funksional në 10 shoqëri rajonale UK.</p> <p>Plani deri në 2030:</p> <p>Sistemi i digjitalizuar për administrimin e aseteve funksional në të gjithë shoqëritë rajonale UK.</p>	<p>Hartimi dhe zbatimi i një plani të detajuar për transformimin dixhital dhe i një qasjeje të integruar për sigurinë kibernetike për administrimin e shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura.</p> <p><u>Rezultatet e parashikuara:</u> Plani afatshkurtër deri në 2024:</p> <p>Plan dhe buxhet i vënë në dispozicion për infrastrukturën TIK dhe trajnimet e nevojshme sipas axhendes kombetare për digjitalizimin e shërbimeve për furnizimin me ujë dhe kanalizime.</p> <p>Plani afatmesëm deri në 2027:</p> <p>Platforma digjitale per administrimin e shërbimeve në nivel qëndror, rajonal dhe lokal, që ndërveprojnë në menyrë efektive.</p> <p>Plani afatgjatë deri në 2030:</p> <p>80% e sistemeve infrastrukturore për furnizimin me ujë dhe kanalizimet, të automatizuara.</p>	<p>Zbatimi I mekanizmave për forcimin dhe përfshirjen gjinore, si dhe të pjesëmarrjes së komuniteteve lokale, në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura.</p> <p><u>Rezultatet e parashikuara:</u> Plani afatshkurtër deri në 2024:</p> <p>Studimi kombëtar për barazinë gjinore në sektorin e ujit.</p> <p>Plani afatmesëm deri në 2027:</p> <p>Përqindja e përfaqësimit të grave në Këshillat Mbikqyrës është 50%.</p> <p>Plani afatgjatë deri në 2030:</p> <p>Platformë funksionale komunikimi dhe përfaqësimi të njësive dhe komuniteteve lokale në proceset e planifikimit dhe miradministrimin e shërbimeve.</p>
--	--	--	---	---	--

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE, 2023-2030

<p>Përmirësimi i cilësisë së ujit të pijshëm.</p> <p><i>Rezultatet e parashikuara:</i></p> <p><i>Plani deri në 2025: Ngritja e 15 laboratorëve rajonale në shoqëritë UK rajonale për cilësinë e ujit.</i></p> <p><i>Plani deri në 2030: Zbatimi i Planeve për Sigurinë e Ujit të Pijshëm nga të gjitha shoqëritë rajonale UK</i></p>			<p>Implementimi i një qasje të re në investimet në sektor drejt reduktimit të konsumit të energjisë nga shoqëritë rajonale UK, nëpërmjet investimeve për furnizimin me energji nga fotovoltaiket, vendosjes se pompave sipas kriterëve të BE dhe instalimi i programit SCADA që rrit efektshmërinë e tyre.</p> <p><u>Rezultatet e parashikuara:</u></p> <p><i>Plani afatshkurtër deri në 2024:</i></p> <p><i>Plani për efikasitetin e energjisë për të gjithë shoqëritë rajonale UK.</i></p> <p><i>Plani deri në 2025:</i></p> <p><i>Ndërtimi i sisteme alternative për furnizimin me energji elektrike për 5 shoqëri rajonale UK.</i></p> <p><i>Plani deri në 2030:</i></p> <p><i>Programi për efikasitetin e energjisë funksional në të gjithë shoqëritë rajonale UK.</i></p>		
--	--	--	--	--	--

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

3.5 Politikat Strategjike në Mbështetje të Masave Prioritare për Sektorin

Strategjia Kombëtare e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime është një dokument i rëndësishëm që do të orientojë Qeverinë në përpjekjet e saj në përmirësimin e sektorit UK. Nga Grupi i Punës Ndërmëtor ato janë përcaktuar duke u bazuar dhe në Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, Qëllimi 6 (SDG6) që është:

Sigurimi i disponueshmërisë dhe menaxhimit të qëndrueshëm të ujit dhe kanalizimeve për të gjithë.

Objektivat e përcaktuar për arritjen e këtij qëllimi janë:

6.1 Deri në vitin 2030, të arrihet akses universal dhe i barabartë në ujë të pijshëm dhe të sigurtë për të gjithë.

6.2 Deri në vitin 2030, të arrihet akses në kanalizime dhe higjienë adekuate dhe të barabartë për të gjithë, duke i kushtuar vëmendje të veçantë nevojave të grave dhe vajzave dhe ata që janë në situata të cënueshme.

Në mënyrë Strategjia parashikon (6) gjashtë Qëllime të Politikës të cilat janë specifike, të matshme dhe me afate kohore të përcaktuara.

Më tej, këto gjashtë Qëllime të Politikës janë përkthyer në Rezultate / Masa Prioritare të cilat do të detajohen nëpërmjet Planeve të Veprimit. Secila Masë Prioritare është shoqëruar me një objektiv të caktuar të performancës që do të arrihen në afatet kohore të parashikuara dhe do të monitorohen gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kësaj Strategjie.

Tabela 2-1 paraqet Qëllime të Politikës dhe rezultatet e parashikuara të performancës për secilën masë prioritare, së bashku me vlerat e indikatorëve të performancës për secilin vit të periudhës së planifikimit të Strategjisë. Pashaportat e detajuara të indikatorëve jepen në aneksin 3 të strategjisë.

Për të vendosur një referencë, si vit bazë është marrë 2021. Duke përdorur vlerat vjetore të vitit bazë për Treguesit e Performancës, Grupi i Punës Ndërmëtor, i cili ishte përgjegjës për zhvillimin e Strategjisë Sektoriale, përcaktoi një vlerë të arritshme për Treguesin e Performancës për vitin e fundit të periudhës së planifikimit, 2023-2030, si dhe vlerat e ndërmjetme për secilin nga 8 vitet e periudhës së planifikimit.

Këto tregues të parashikuara për secilën masë prioritare janë elementë kryesorë për të monitoruar, vlerësuar dhe raportuar progresin në zbatimin Strategjisë në termat kohore (2023-2025), dhe (2026-2030). Ato gjithashtu do të përdoren për të identifikuar çdo devijim në mes të performancës së parashikuar dhe arritjeve aktuale vjetore në terren dhe si rrjedhim të përcaktojnë veprimet korrigjuese dhe të përditësojnë Strategjinë kur është e nevojshme. Procesi i monitorimit, raportimit dhe përditësimit të Strategjisë është detajuar më tej në Pjesën e IV.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE, 2023-2030

Tabela 3-2: Objektivat Strategjike dhe Indikatorët e Performancës

Nr	Objektivat Strategjike/Masat Prioritare	Viti Baze 2021	Plani Viti 2022	Plani Viti 2023	Plani Viti 2024	Plani Viti 2025	Plani Viti 2026	Plani Viti 2027	Plani Viti 2028	Plani Viti 2029	Plani Viti 2030
1	<i>Pershkrimi i Objektivit</i>										
	Zgjerimi dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimit të furnizimit me ujë										
1.1	Mbulimi me Ujesjelles (Niveli Kombetar)	77.7%	78.3%	79.7%	80.8%	82.0%	83.5%	85.1%	87.7%	88%	90%
1.1.1	Mbulimi me Ujesjelles per zonat urbane	92.0%	93.0%	94.0%	94.5%	95.0%	95.5%	96.0%	97.0%	98.0%	99.0%
1.1.2	Mbulimi me Ujesjelles per zonat rurale	57.9%	58.0%	60.0%	62.0%	64.0%	67.0%	70.0%	75.0%	80.0%	85.0%
1.2	Vazhdimësia e Furnizimit me Uje (ore/dite)	15	15.5	16	17	18	19	20	21	22.5	24
1.2.1	Vazhdimësia e Furnizimit me Uje (ore/dite) Qytet	16	17	18	19	20	21	22	23	24	24
1.2.2	Vazhdimësia e Furnizimit me Uje (ore/dite) Fshat	12	13	14	15	16	17	18	19	20	24
1.3	Hartimi i planeve për përdorimin e ujit me efikasitet në të gjithë sektorët, duke siguruar furnizim të qëndrueshëm dhe duke rritur ndjeshëm ripërdorimin e tij sipas parimeve të ekonomisë qarkulluese.	-	-	5.0%	10.0%	20.0%	30.0%	45.0%	60.0%	80.0%	100.0%
1.4	Reduktimi i Ujit pa te Ardhura	65.4%	64.0%	63.0%	62.0%	60.0%	57.0%	52.0%	50.0%	48.0%	45.0%
1.4.1	Niveli i matjes se konsumit te ujit shprehur ne numer lidhjesh	78.4%	80.0%	82.0%	85.0%	87.0%	90.0%	93.0%	95.0%	97.0%	100.0%
1.5.1	Sisteme automatike të dezinfektimit të ujit të pijshëm për të gjitha shoqëritë rajonale UK	-	-	30%	50%	70%	90%	100%	100%	100%	100%
1.5.2	Ngritja e Laboratoreve Rajonal per Cilesine e Ujit te Pijshem (15)	-	-	30%	50%	100%	100%	100%	100%	100%	100%

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE, 2023-2030

1.5.3	Plane per Sigurine e Ujit te perfunduara per te gjitha Shoqerite UK te Licensuara	-	-	30%	40%	60%	70%	80%	90%	100%	100%
2	Pershkrimi i Objektivit										
	Zgjerimi dhe përmirësimi i aksesit në sistemet për grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura për popullsinë.										
2.1	Mbulimi me Kanalizime (Niveli Kombetar)	53.0%	53.5%	54.0%	54.5%	55.3%	56.8%	58.8%	60.8%	62.8%	64.8%
2.1.1	Mbulimi me Kanalizime per zonat urbane	82.4%	83.0%	83.5%	84.0%	84.5%	85.0%	87.0%	89.0%	91.0%	93.0%
2.1.2	Mbulimi me Kanalizime per zonat rurale	12.6%	13.0%	13.5%	14.0%	15.0%	18.0%	20.0%	22.0%	24.0%	26.0%
2.2	Mbulimi me Trajtim te Ujrave te Perdorura nga ITUP	14.4%	15.0%	15.5%	16.0%	16.5%	18.0%	20.0%	22.0%	24.0%	26.0%
3	Pershkrimi i Objektivit										
	Zbatimi i programit për riorganizimin e shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura në baza rajonale.										
3.1	Zhvillimi I një programi të bashkërenduar me NJQV për riorganizimin e të gjithë shoqërive egzistuese UK në shoqëri rajonale si Subjekte të Kompetencave të Perbashkëta UK.	-	67%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%
3.2	Ristrukturimi dhe reformimi rrënjësor i institucioneve qendrore në funksion të zbatimit të programit për riorganizimin e shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura në baza rajonale.	-	30.0%	40.0%	50.0%	60.0%	70.0%	80.0%	90.0%	100.0%	100.0%
3.3	Ngritja e një sistemi për monitorimin dhe vlerësimin e ecurisë së zbatimit të procesit për riorganizimin e shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura në baza rajonale.	-	-	50.0%	70.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE, 2023-2030

3.4	Vlerësimi i efekteve të agregimit të shoqërive dhe vijimi i procesit							100%	100%	100%	100%
4	<i>Pershkrimi i Objektivit</i>										
	Përmirësimi i qëndrueshmërisë financiare dhe përballueshmërisë së shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura sipas parimeve të kontrollit dhe mbulimit të plotë të kostove operacionale.										
4.1.1	Mbulimi i Kostove të Operimit dhe Mirembajtjes (O&M) me Arketimet Korente	80.0%	85%	90%	95%	100%	100%	100%	100%	100%	100%
4.1.2	Mbulimi i Kostove Totale të Operimit (KTO përfshirë shpenzimet për shlyerjen e kredive dhe fondet për rezervat kapitale) me Arketimet Korente	58.3%	60%	64%	68%	72%	75%	80%	85%	90%	95%
4.2	Tarifë e unifikuar për shoqëritë rajonale UK	-	-	35.0%	70.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
4.3.1	Norma e Arkëtimit Korent	72.4%	75.0%	77.0%	85.0%	90.0%	93.0%	96.0%	99.0%	100.0%	100.0%
4.4.1	Sistem i unifikuar i faturimit në të gjithë shoqëritë rajonale UK	-	-	50.0%	75.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
4.4.2	Leximi (aksesi) online i faturës për të gjithë shoqëritë rajonale UK.	-	30.0%	50.0%	75.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
4.4.3	Sistemi i pagesës online për të gjithë shoqëritë rajonale UK.	-	-	20.0%	30.0%	40.0%	50.0%	60.0%	80.0%	90.0%	100.0%
4.5.1	Standarte të unifikuar për vlerësimin të aseteve në të gjithë shoqëritë rajonale UK.	-	-	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
4.5.2	Sistemi i digjitalizuar për administrimin e aseteve funksional në shoqëritë rajonale UK.	-	20.0%	40.0%	60.0%	70.0%	80.0%	90.0%	100.0%	100.0%	100.0%
4.6.1	Plani për efikasitetin e energjisë për të gjithë shoqëritë rajonale UK.	-	-	20.0%	50.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE, 2023-2030

4.6.2	Ndërtimi i sisteme alternative për furnizimin me energji elektrike për 5 shoqëri rajonale UK.	-	-	20.0%	50.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
4.6.3	Programi për eficientësi e energjisë funksional në të gjithë shoqëritë rajonale UK.	-	-	20.0%	35.0%	50.0%	60.0%	70.0%	80.0%	90.0%	100.0%
5	Pershkrimi i Objektivit										
	Rritja e kapaciteteve dhe miradministrimi i shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura.										
5.1.1	Plani kombëtar i hartuar për zhvillimin e kapaciteteve në nivel qendror rajonal dhe lokal.	-	-	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%
5.1.2	Platforma për zhvillimin e kapaciteteve funksionale dhe e administruar nga AKUM.	-	-	-	-	100%	100%	100%	100%	100%	100%
5.2	Rritja e Buxhetit të alokuar për trajnimin e Stafit të Shoqërive UK (e shprehur si % e buxhetit total të pagave)	-	-	1.0%	1.2%	1.4%	1.5%	1.5%	1.7%	1.8%	2.0%
5.3.1	Manuali i rishikuar për trajnimin dhe certifikimin e punonjësve të shoqërive rajonale UK.	-	-	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
5.3.2	Programi i certifikimit funksional dhe i administruar nga AKUM.	-	-	-	-	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
5.3.3	Stafi administrues dhe operues i çdo shoqërie rajonale është i trajnuar dhe certifikuar.	-	-	-	30%	60%	80%	100%	100%	100%	100%
5.4	Strukturë e unifikuar dhe e miratuar në të gjithë shoqëritë rajonale UK.	-	20.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE, 2023-2030

5.5.1	Plan dhe buxhet i vënë në dispozicion për infrastrukturën TIK dhe trajnimet e nevojshme sipas axhendes kombetare për digjitalizimin e shërbimeve për furnizimin me ujë dhe kanalizime.	-	-	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
5.5.2	Platforma digjitale për administrimin e shërbimeve në nivel qendror, rajonal dhe lokal, që ndërveprojnë në menyërë efektive.	-	-	-	-	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
5.5.3	Sistemeve infrastrukturore për furnizimin me ujë dhe kanalizimet, të automatizuara.	-	-	10.0%	20.0%	30.0%	40.0%	50.0%	60.0%	70.0%	80.0%
6	Pershkrimi i Objektivit										
	Përmirësimi i qeverisjes dhe kuadrit ligjor/rregullator të sektorit										
6.1.1	Miratim i standarteve të shërbimit për shoqërite rajonale UK.	-	-	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%
6.1.2	Aktet e nevojshme rregullatore përkatësisht për licensimin, vendosjen e tarifave, rregullave uniforme etj, janë plotësisht efektive në funksion të aktivitetit për ofrimin e shërbimeve.	-	-	-	-	100%	100%	100%	100%	100%	100%
6.2.1	Miratim në parlament i projektligjit për shërbimet e furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura.	-	80%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%
6.2.2	Miratim dhe zbatim i aktet ligjore dhe nënligjorë në zbatim të ligjit për shërbimet e furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura.	-	-	-	50%	100%	100%	100%	100%	100%	100%
6.3	Perfundimi i procesit të harmonizimit të kuadrit ligjor kombëtar të sektorit UK në përputhje me direktivat e BE për ujë	-	-	-		100%	100%	100%	100%	100%	100%
6.4.1	Plani kombëtar për informimin dhe ndërgjegjësimin.	-	-	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE, 2023-2030

6.4.2	Platformë vjetore për organizimin e fushatave sensibilizuese në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.	-	-	-	-	100%	100%	100%	100%	100%	100%
6.5.1	Studimi Kombëtar për të adresuar Barazine Gjinore	-	-	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%
6.5.2	Përqindja e përfaqësimit të grave në Këshillat Mbikqyrës është 50%.	-	-	-	-	100%	100%	100%	100%	100%	100%
6.5.3	Platformë funksionale komunikimi dhe përfaqësimi të njësive dhe komuniteteve lokale në proceset e planifikimit dhe miradministrimit e shërbimeve.	-	-	-	10%	30%	50%	70%	80%	90%	100%

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

4 ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, LLOGARIDHËNIA, RAPORTIMI DHE MONITORIMI

Ky kapitull paraqet disa udhëzime për mënyrën se si do të zbatohet, monitorohet dhe përditësohet Strategjia aktuale gjatë zbatimit të saj. Është krijuar një sistem koherent monitorimi dhe vlerësimi në mënyrë që të sigurohet një arritje efikase dhe efektive e objektivave të strategjisë. Bashkëndimi i përgjithshëm i aktiviteteve në lidhje me strategjinë është përgjegjësi e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Çdo vit, MIE do të raportojë mbi përparimin në përmbushjen e objektivave, sa I përket aspektit cilësor dhe sasior të strategjisë dhe planeve përkatëse, si dhe do të informojnë rregullisht Kryeministrin mbi zhvillimet në sektor.

Në zbatim të urdhrin të Kryeministrit nr. 157, datë 22.10.2018 “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektoril/ndërsektorial të integruar”, u miratua urdhri i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 217, datë 24.05.2019 “Për ngritjen e sekretariatit teknik, në kuadër të funksionimit të grupit tematik reforma e ujesjelles kanalizimeve”, ku Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë luan rolin e sekretariatit teknik për grupin tematik “reforma në sektorin ujësjellës kanalizime”.

Me urdherin e Ministri të Infrastrukturës dhe Energjisë nr.77, datë 20.04.2022 u ngrit Grupi Tematik për Reformën e Riorganizimit të Ujësjetllës Kanalizimeve sha, i cili luan edhe rolin e Komitetit Sektorial të Monitorimit të IPA-s për Reformën e Ujit, që drejtohet nga zëvendësministër i infrastrukturës dhe energjisë.

Planet e detajuara të zbatimit

Siç paraqitet Aneksin 1, çdo Objektiv Strategjik detajohet në Masat Prioritare dhe për çdo masë Prioritare përcaktohen Planet e Veprimit. Institucionet përgjegjëse, duke përfshirë një Institucion Përgjegjës kryesor (lider), gjithashtu identifikohen dhe përcaktohen për të mbikqyrur zbatimin dhe monitorimin e Planeve e Veprimit për të arritur rezultatet e parashikuara (targetet) të vendosura për afate kohore të shkurtra, të mesme dhe të gjata.

Institucioni Përgjegjës kryesor do të hartojë një plan zbatimi të detajuar për secilën prej Masave Prioritare të përcaktuara, ku do të përshkruhet në mënyrë të plotë si do të realizohet arritja e rezultateve të parashikuara. Këto plane të detajuara të zbatimit do të përfshijnë një qasje graduale në përputhje me rezultatet që parashikohet të arrihen për periudhat afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata. Këto plane duhet të përpunohen brenda tre muajve pas miratimit të këtij dokumenti dhe do të konsultohen në vijim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

Monitorimi dhe Raportimi i Strategjisë

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është përgjegjëse për vlerësimin, monitorimin e progresit dhe zbatimin e kësaj Strategjie në bashkëpunim me institucionet e ndryshme përgjegjëse.

Monitorimi luan një rol kyç në vlerësimin dhe raportimin e progresit në zbatimin e një strategjie. Për më tepër, ai u ofron palëve të interesuara, në të gjitha nivelet, informacion kyç në lidhje me përparimin e zbatimit dhe sfidat e mundshme, duke bërë të mundur ndërmarrjen e veprime korrigjuese sa herë që është e nevojshme. Procesi i monitorimit duhet të jetë i vazhdueshëm, i qëndrueshëm, i fokusuar dhe i disiplinuar.

Tabela 4-1: Procesi i monitorimit

Karakteristikat e procesit të monitorimit	Veprimet operacionale
I vazhdueshëm	Të kryhet mbi baza vjetore
I qëndrueshëm	Të përdoret e njëjta bazë dhe burim të dhënash në cdo kohë
I fokusuar	Të krahasohen arritjet me rezultatet e parashikuara
I disiplinuar	Të ndiqet një mekanizëm i veçantë monitorimi

• **Proçes i vazhdueshëm**

Për të monitoruar zbatimin dhe progresin e Strategjisë Kombëtare, Institucioni Përgjegjës kryesor do të përgatitë një raportim vjetor që detajon arritjet në lidhje me Masat Prioritare të caktuara dhe Planet e Veprimit përkatëse.

• **Proçes i qëndrueshëm**

Institucioni përgjegjës kryesor do të përdorë të njëjtën bazë dhe burim të dhënave për të monitoruar dhe raportuar përmirësimet dhe rezultatet e arritura në lidhje me masat prioritare të përcaktuara dhe planet e veprimit përkatëse. Në të vërtetë, vendosja e standardeve të qarta për raportimin e të dhënave është kritike për një monitorim efektiv.

• **Proçes i fokusuar**


Për raportim, progresi i arritur për çdo Masë Prioritare dhe Planet e Veprimit përkatës duhet të jetë qartësisht të detajuara, për të bërë të mundur krahasimin dhe vlerësimin kundrejt Objektivave të Parashikuara në periudhat afat të shkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë.

• **Proçes i disiplinuar**

Institucioni përgjegjës kryesor duhet të ndjekë një mekanizëm specifik monitorimi për raportin vjetor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë siç paraqitet në Figurën 5-1 si më poshtë.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

Tabela 4-2: Procesi i Monitorimit



Përditësimi i Strategjisë

Qëllimi përfundimtar i procesit të monitorimit dhe raportimit të Strategjisë, i përshkruar më sipër, është që të sigurohet se zbatimi i Strategjisë dhe përmirësimet e arritura janë realizuar në mënyrë efektive siç është planifikuar.

Kur raporti i përgatitur nga Institucioni Përgjegjës kryesor tregon një devijim ndërmjet rezultateve të parashikuara të ndërmjetem dhe progresit të realizuar, duhet të kryhet një analizë e thellë për të evidentuar shkakun dhe arsyet për devijimin e vërejtur. Kjo diagnozë duhet gjithashtu të përfshijë dhe të përshkruajë veprimet e përshtatshme korrigjuese që duhen ndërmarrë për t'u përgjigjur problemeve eventuale dhe çështjeve që janë evidentuar dhe ende sigurojnë arritjen e rezultateve të parashikuara. Kur është e nevojshme, rezultatet e parashikuara për afat të shkurtër, të mesëm ose të gjatë mund të rregullohen, duke çuar kështu në një përditësim të Strategjisë. Është e rëndësishme të dallohen veprimet korrigjuese nga përditësimi i Strategjisë. Veprimet korrigjuese nuk synojnë të modifikojnë Objektivat Strategjike të Strategjisë Kombëtare, por të modifikojnë Planet e Veprimit për të siguruar arritjen e Objektiveve Strategjike. Strategjia duhet të përditësohet vetëm kur veprimet korrigjuese mendohet të jenë të pamjaftueshme për të lejuar që Institucionet Përgjegjëse të arrijnë Rezultatet e Parashikuara në kohën e duhur dhe në koston e parashikuara.


Analiza e progresit dhe propozimi i veprimeve korrigjuese do të përgatitet nga Institucioni Përgjegjës kryesor dhe më pas do të diskutohet, rishikohet dhe vlerësohet me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë gjatë një takimi pune përmbledhës të strategjisë.

Në fund të çdo viti, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë do të konsolidojë raportimin e bërë nga Institucionet Përgjegjëse për të zhvilluar një dokument operacional, duke theksuar progresin e bërë për të arritur të gjitha rezultatet e parashikuara të ndërmjetme dhe identifikimin e boshllëqeve të parealizuara si dhe veprimet korrigjuese të miratuara dhe të zbatuara. Ky dokument përcjellës do të ndihmojë në vlerësimin e efektivitetit të Planeve të Veprimit për të arritur Rezultatet e Parashikuara dhe do të përdoret për të hartuar çdo vit një version të përditësuar të Strategjisë Kombëtare.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

Procesi i plotë i përditësimit përshkruhet në Figurën 4-1 si më poshtë.

Figura 4-1: Procesi i Përditësimit



VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

5 PLANET E VEPRIMIT NË MBËSHTETJE TË MASAVE PRIORITARE

Ky kapitull i Strategjisë Sektoriale paraqet Planet e Veprimit për zbatimin e Masave Prioritare të identifikuar si kusht për arritjen e Objektivave Strategjike. Çështjet e mëposhtme adresohen si mëposhtë:

- Çfarë kërkohet për zbatimin e masës prioritare
- Kush është përgjegjës për zbatimin e masës prioritare
- Kur duhet (dhe mund) të zbatohet masa prioritare, dhe
- Sa do të kushtojë zbatimi i masave prioritare
- Sa do mbulohen nga PBA e rradhës;
- Sa është hendeku financiar.

Plani i veprimit i detajuar paraqitet në aneksin 1 të strategjisë.

Nevojat dhe Burimet e Financimit

Ky kapitull i Strategjisë Sektoriale paraqet shpërndarjen e burimeve sipas Vizionit, Misionit, Qëllimit e Politikës dhe Masave Prioritare, të cilat janë trajtuar më parë në këtë dokument, si dhe ndikimet e tyre në lidhje me nevojat për financim në të ardhmen. Këto nevoja për financim mund të mbulohen drejtpërdrejt nga Thesari i Shtetit, nga Donatorët si grante, kredi apo çdo kapital tjetër i parashikuar dhe fondet për asistencë teknike.

Strategjia Sektoriale tashme përfaqëson një angazhim për shpërndarjen e shpenzimeve publike në koordinim të plote me buxhetin vjetor ose afatmesëm. Roli i Strategjisë Sektoriale, sa i përket përcaktimit të nivelit të parashikuara të shpenzimeve kapitale, është të shërbejë si një dokument referimi që orienton planet e ardhshme për shpenzimet buxhetore. Megjithatë, Strategjia Sektoriale shërben për të paraqitur prioritetet në mënyrë të qartë. Në këtë mënyrë, në ndikimet fiskale të politikave të ndërmarra dhe Masave Prioritare janë marrë parasysh të gjitha burimet e mundshme të financimit si dhe është përcaktuar hendeku financiar.

Nevojat Kapitale për arritjen e Qëllimeve të Politikës dhe Masave Prioritare

Pas përcaktimit të Treguesve të Performancës, të dhënat e vitit bazë dhe niveli Treguesve të Performancës i përcaktuar si target i arritshëm në vitin 2030, u bë e mundur të përcaktohej nëse do të kishte nevojë për shpenzime kapitale dhe korente për të arritur nivelet e synuara. Në rastet ku kishte nevojë për shpenzime kapitale, u vendos një nivel i matshëm për përcaktimin e këtyre shpenzimeve. Tabela 4-1, për secilën Masë Prioritare që ndikon në shpenzime kapitale, merr në konsideratë në mënyrë të arsyeshme konvertimin e nivelit të synuar në një kosto kapitale, për shembull: rritja e mbulimit me uji në zonat urbane. Në këtë shembull, numri i lidhjeve të reja të nevojshme për të arritur nivelin e

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

synuar të treguesit të performancës në secilin vit, shumëzohet me një kosto kapitale për njësi të vlerësuar për çdo lidhje të re të shtuar.

Tabela e mëposhtme 5-1 paraqet kostot kapitale për njësi të përdorura në Modelin Financiar me qëllim llogaritjen e kostove të investimeve kapitale për secilin Objektiv Strategjik:

Tabela 5-1: Kostot Kapitale për Njësi të përdorura për llogaritjen e Nevojave Kapitale

Kosto	Për lidhje	Për person
	Euro	Euro
Rrjeti Ujësjiellës	2,000	600
Rrjeti i Kanalizimeve	4,000	1000
Impianti i Trajtitimit	1,000	270
Ujëmatës Familjar	100	100
Ujëmatës Prodhimi	5,000	-
Ujëmatës Zonal	1,000	-

Kostot për njësi për Rrjetin e ri të Furnizimit me Ujë/Kanalizime dhe Lidhjet e Kanalizimeve të lidhura me ITUN janë bazuar në Projektet e Investimeve Kapitale të realizuara kohët e fundit në Shqipëri nga Banka Botërore dhe KfE.

Kosto për njësi për Ujëmatësit Familjar, Ujëmatësit e Prodhimit dhe Ujëmatësit Zonal janë bazuar në Raportin “Plani Kombëtar i Veprimit për Reduktimin e Ujit pa të Ardhura në Shqipëri” hartuar në vitin 2018 nga Qeveria e Shqipërisë me mbështetjen e USAID.

Niveli i Shpenzimeve Kapitale të parashikuara për Rehabilitimin e Rrjetit të Furnizimit me Ujë, është kryesisht rezultat i Planifikimit për Reduktimin e Humbjeve Teknike. Bazuar në "Strategjinë e Financimit të Sektorit të Ujësjiellës Kanalizimeve në Shqipëri" supozohet se për reduktimin e Humbjeve Teknike me **1%**, nevojitet rehabilitimi i **93km** rrjet ujësjiellësi.

Për të parashikuar Shpenzimet Korente dhe Kapitale të nevojshme për të arritur Objektivat Strategjike, janë marrë në konsideratë normat e mëposhtme:

- Norma vjetore e rritjes së popullsisë (INSTAT) është 0.0% (të dhënat e INSTAT referojnë trend në ulje të popullsisë 2017-2020).
- Një lidhje e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve përbëhet nga **4.1** persona (bazuar në të dhënat vjetore të vitit 2021 nga AKUM)
- Një ujëmatës zonal (DMA) për 1,500 lidhje
- Popullsia totale në juridiksionin e bashkive **4,355,649 banorë** sipas të dhënave të AKUM (2021) të rakorduara edhe me të dhënat e Regjistrat të Gjëndjes Civile.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

Nevojat Korente dhe Kapitale

Duke pasur parasysh faktin se Shqipëria nuk ka kapacite të mjaftueshëm në burime njerëzore në institucionet e saj, për të ndërmarrë disa nga planet e veprimit që nuk kërkojnë kapital, do të nevojiten shpenzime kapitale shtesë në formën e asistencës teknike dhe shpenzime kapitale të patrupëzuara. Këto shpenzime të veçanta janë përshkruar në disa prej Planeve të Veprimit dhe janë përmbledhur më poshtë në Tabelën 5-2 sipas afateve kohore dhe objektivave të parashikuara gjatë periudhës së planifikimit.

Nevojat Korente dhe Kapitale Totale të Investimeve për Periudhën e Planifikimit

Në Tabelën 5-2 janë paraqitur nevojat korente dhe kapitale totale të investimeve në afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, duke marrë në konsideratë:

- Investimet kapitale "të reja" për arritjen e objektivave strategjike të përcaktuara;
- Kapitali i nevojshëm për investimet e "rinovimit, riparimit dhe zëvendësimit"
- Investimet kapitale në formën e asistencës teknike.

Investimet "e reja" dhe investimet për "rinovim, riparim dhe zëvendësim" janë grupuar dhe quajtur "kosto të infrastrukturës" në tabelën e mëposhtme.

Në Strategjinë Kombëtare të Sektorit Ujësjellës Kanalizime 2023-2030, kosto e përgjithshme arrin në rreth **161,832,691,076 Lekë**, ku kostot kapitale zëne **92%** të totali dhe kostot korente **8%**.

Grafiku 5.a: Struktura përbërëse e kostove të strategjisë sipas Tabeles 5-2 më poshtë:



VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE, 2023-2030

Tabela 5-2 Nevojat Kapitale (në Lekë)

Qëllimi i Politikës	Lloji i kostos	Kosto Totale	Kosto e Planifikuar	Tavanet Buxhetore Planifikuar per vitin 2026	Tavanet Buxhetore Planifikuar per vitin 2027	Tavanet Buxhetore Planifikuar per vitin 2028	Tavanet Buxhetore Planifikuar per vitin 2029	Tavanet Buxhetore Planifikuar per vitin 2030	Hendeku Financiar	
		2023-2030	PBA 2023-2025							2026-2030
		Buxheti dhe Donatoret	Buxheti dhe Donatoret	Buxheti dhe Donatoret						Buxheti dhe Donatoret
Zgjerimi dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimit të furnizimit me ujë	Korente	7,134,646,912	4,933,125,209	400,000,000	400,000,000	400,000,000	400,000,000	400,000,000	201,521,703	
	Kapitale	63,644,206,620	42,796,126,883	4,000,000,000	4,000,000,000	4,000,000,000	4,000,000,000	4,000,000,000	848,079,737	
Zgjerimi dhe përmirësimi i aksesit në sistemet për grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura për popullsinë.	Korente	4,488,690,740	1,328,575,756	600,000,000	600,000,000	600,000,000	600,000,000	600,000,000	160,114,985	
	Kapitale	84,748,814,804	11,957,181,800	11,700,000,000	11,700,000,000	11,700,000,000	11,700,000,000	11,700,000,000	14,291,633,004	
Zbatimi i programit për riorganizimin e shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura në baza rajonale.	Korente	28,500,000	16,500,000	2,400,000	2,400,000	2,400,000	2,400,000	2,400,000	0	
	Kapitale	45,000,000	45,000,000						0	
	Korente	551,495,000	0	100,000,000	100,000,000	100,000,000	100,000,000	100,000,000	51,495,000	

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE, 2023-2030

Përmirësimi i qëndrueshmërisë financiare dhe përballueshmërisë së shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura sipas parimeve të kontrollit dhe mbulimit të plotë të kostove operacionale.	Kapitale	526,500,000	0	90,000,000	90,000,000	90,000,000	90,000,000	90,000,000	76,500,000
Rritja e kapaciteteve dhe miradministrimi i shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura.	Korente	534,105,000	0	100,000,000	100,000,000	100,000,000	100,000,000	100,000,000	34,105,000
	Kapitale	0	0	0	0	0	0	0	0
Përmirësimi i qeverisjes dhe kuadrit ligjor/rregullator të sektorit	Korente	130,732,000	89,080,000	8,000,000	8,000,000	8,000,000	8,000,000	8,000,000	1,652,000
	Kapitale	0	0	0	0	0	0	0	0
TOTALI [Leke]		161,832,691,076	61,165,589,648	17,000,400,000	17,000,400,000	17,000,400,000	17,000,400,000	17,000,400,000	15,665,101,428
TOTALI [Euro]		1,383,185,394	522,782,818	145,302,564	145,302,564	145,302,564	145,302,564	145,302,564	133,889,756
<i>1 euro 117 Leke</i>									

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

Burimi i Financimit

Rritja e nivelit të shërbimit ndaj përdoruesve nënkupton kosto më të larta operimi dhe mirëmbajtje dhe për investimet në shërbimin e furnizimit me ujë. Këto kosto mund të financohen përmes tarifave, taksave dhe transfertave, e ashtuquajtura korniza “3T” hartuar nga OECD (2009).

- Taksat: Fonde të mbledhura nga taksat kombëtare (buxheti i shtetit) që përdoren për të financuar sektorin UK. Për shkak të kufizimeve domethënëse fiskale, fondet e disponueshme që vijnë nga taksat për të financuar sektorin UK janë gjithnjë e më të reduktuara.
- Tarifat: tarifat e konsumatorit ose pagesat (shërbimi i furnizimit me ujë - tarifa për lidhje dhe shërbimin e ofruar – tarifa aforfe / volumetrike) përdoren për të financuar sektorin UK. Ky është burimi më i qëndrueshëm i financimit të sektorit. Megjithatë, çështja e përballeshmërisë dhe përfaqja politike e tarifave duhe të merren parasysh.
- Transfertat: grandet nga burime të huaja, asistencë teknike për zhvillim mund të sigurojnë fonde për sektorin UK. Kryesisht këto transfertat bëhen përmes programeve dypalëshe dhe përmes Instrumentit të Bashkimit Evropian për Programin e Paraderimit II (IPA II). Transfertat të tilla mund të financojnë një pjesë të shpenzimeve kapitale, por nuk mund të përdoren për të financuar shpenzimet operacionale. Vlen të theksohet se **kreditë shërbejnë vetëm për të zhvendosur pagesat e parave në kohë**. Përfundimisht kreditë duhet të paguhet nga taksat ose tarifat. Kreditë nuk përbëjnë një burim përfundimtar financimi, por janë më tepër një marrëveshje për të shtyrë pagesat nga taksat ose tarifat.

Bazuar në Strategjinë Financiare të Sektorit UK, shpërndarja e burimeve të financimit për të mbuluar të gjitha shpenzimet kapitale të nevojshme, sipas kategorive të mësipërme, do të jetë si më poshtë:

Tabela 5-3: Burimet e Financimit

Burimi i Financimit	Shpërndarja (në %)
Taksat	25%
Transfertat	30%
Tarifat	45%

Në Tabelën 5-3 paraqitet shpërndarja e Financimit për të gjithë sektorin duke përfshirë OPEX dhe CAPEX. Shpenzimet Kapitale të nevojshme për të arritur objektivat strategjik të kësaj Strategjie do të financohen kryesisht nga Taksat dhe Transfertat. Tarifat do të jenë burimi kryesor për financimin e Shpenzimeve Operative dhe të Mirëmbajtjes në periudhën afatshkurtër. Më pas, gradualisht niveli i mbulimit të O&M me të ardhurat do të arrijë 100%, kështu që tarifat do të përdoren si burim financimi shtesë për CAPEX.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

6 PERSHKRIMI MJEDISOR


Kjo pjesë paraqet një panoramë të gjërë të faktoreve mjedisore që janë ndikuar nga sektori i nergjisë. Ka një mundësi të theksuar të të dhënave në disa fusha, një boshllëk që vetë strategjia dhe puna analitike që rrjedh prej saj do të përpiqen ta adresojnë. Informacioni i disponueshëm dhe perkates është paraqitur në një mënyrë sa më të ngjeshur. U mendua që informacioni i përgjithshëm pa lidhje nuk duhet të përfshihej pa ndonjë arsye të fortë.

6.1 Toka

Cilesia e tokës varen nga nderveprimet biologjike, kimike dhe fizike. Toka është veçanërisht e rëndësishme në ofrimin e një substrate në të cilën bimët mund të lulëzojnë, në pastrimin e ujit si dhe transformimin dhe riciklimin e mbetjeve dhe ndotesve dhe ofrimin e biodiversitetit. Menaxhimi i keq i tokës mund të ndikojë negativisht mbi habitatet natyrore dhe biodiversitetin, si dhe bujqesinë, pyjet, peizazhin, trashëgiminë kulturore dhe industrinë.

Në Shqipëri dallohen zonat e mëposhtme: Sedimentet molase dhe neogjene - zonat e sedimenteve kuantenare, zona e Shqipërisë së brendshme (zona pelagioniane), zona e Shqipërisë së jashtme (zona greke, zona joniane, dinaritet, zona pre-apulia) dhe zona ofiolitike.

Figura 6-1: Harta gjeologjike dhe tektonike e Shqipërisë




Burimi: <http://www.gsa.gov.al/>

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

Tokat e Shqipërisë janë të ndryshme dhe krijojnë zona të veçanta sipas klimes, flores, lehtësimit, etj. Zonat e tokave janë ndare në katër grupe sipas lartësisë së tyre:

- Gri - toka kafe që gjendet në lartësi deri në 600 m. Ato përfshijnë zonën e ultësirës bregdetare dhe kodrave, të cilat përbëjnë rreth 15% të vendit. Nga këto toka, 70% përbëjnë tokë mbjellë. Në zonën e ultësirës ka 84,000 hektare tokë aluviale dhe 15,000 hektare tokë të kripur.
- Tokat malore kafe ndodhen në brendësi të vendit, në lartësi prej 600 deri në 1.000 m. Ato përbëjnë 38% të sipërfaqes së përgjithshme dhe 40% të tokës së punëshme.
- Tokat gri të pyjeve ndodhen në lartësi prej 1.000 deri në 1.800 m dhe përbëjnë 15% të sipërfaqes së përgjithshme të tokës, 10% të cilave është e kultivuar.
- Tokat që janë livadhe malore ndodhen në lartësi prej 1.600 - 2.600 m dhe përbëjnë 10% të tokës së vendit.

Grafiku 6.a Struktura e përdorimit të tokës



Burimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit - Raporti i Gjendjes së Mjedisit

6.2 Cilesia e ajrit

Shqipëria si një vend me zhvillime të shpejta të ndryshimeve infrastrukturore dhe zhvillime të qendrave urbane, po përballë me faktorët e ndotjes së mjedisit nga ky zhvillim, e si pasojë e kësaj ndotje mjedisore ka dhe impaktin në shëndetin e popullatës.

Ndotja e ajrit është kontaminimi i mjedisit të jashtëm dhe atij të brendshëm nga faktorë kimikë, fizikë dhe biologjik, të cilët modifikojnë karakteristikat normale të atmosferës. Pajisjet shtëpiake për ngrohje që përdorin djegie fosile, automjetet, objektet industriale dhe djegiet e pyjeve janë burimet më të zakonshme. Çdo burim i ndotjes është kontribues në territorin ku

shfaqet, por ndotja e ajrit gjithnjë e më shumë po merr përmasa globale.

Ndryshimet klimatike dhe ndotja e ajrit janë të lidhura ngushtësisht me njëra-tjetren. Pikerisht, ajri i ndotur ka efekte negative në shëndetin e njeriut dhe ekosistemet; në shtresën e sipërme të atmosferës ajri i ndotur ndikon në klimën globale duke ndikuar në shtresën e ozonit, e cila na mbron nga efektet e demshme të rrezeve të diellit.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

Ndotja e ajrit vazhdon të jetë problem serioz për shëndetin e popullatës. Shkarkimet nga automjetet dhe ndertimet e ndryshme, kontribuojnë shumë në ndotjen e ajrit urban, duke shkaktuar probleme në frymëmarrje, sidomos tek moshat shumë të reja dhe të moshuarit. Rëndësi të veçantë ka cilësia e lëndës djegëse që përdoret nga automjetet, e cila në venditose është me cilësi më të ulët se ajo e vendeve të BE-se.

MONITORIMI I CILËSISË SE AJRIT:

Për monitorimin e cilësisë së ajrit urban janë zbatuar metodat standarte sipas të cilave përcaktohen mesataret kohore të monitorimit të cilësisë së ajrit, bazuar në direktivën CAFE të BE për një ajër të pastër dhe kërkesave të EEA për raportime. Vlerësimi është kryer duke i krahasuar me limitet sipas standarteve të Bashkimit Europian (BE).

Figura 6-2: Normat e Bashkimit Europian për ajrin urban

Normat e BE	PM10 µg/m ³	SO ₂ µg/m ³	O ₃ µg/m ³	CO mg/m ³	NO ₂ µg/m ³
1 orëshe		350			200
8 orëshe			120	10	
24 orëshe	50	125			
Vjetore	40				40

Burimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Raporti i Gjendjes së Mjedisit 2021

Monitorimi e cilësisë së ajrit urban realizohet në qytetet kryesore të vendit si: Durrës, Shkodër, Korçë, Fier, Berat, Lezhë dhe Vlorë. Monitorimi bëhet për treguesit kryesorë të ndotjes së ajrit urban si: PM10, NO₂, SO₂, O₃, CO.

Vlerësimi i situatës nga grimcat e pluhurit (PM10)


Grimcat e pluhurit (PM) janë një përzierje e aerosoleve (të ngurta ose të lëngëta) që përfshijnë një diapazon të gjërë në madhësi dhe kompozime kimike. PM10 i referohet grimcave me diametër 10 micrometër ose më të vogël, dhe emetohet direkt në atmosferë si grimca primare, ose formohet si rezultat i emisioneve të SO₂, NO_x, NH₃ dhe NMVOC. PM10 emetohen dhe nga shumë burime antropogjenike si djegja e lëndës djegëse, ndërtimi, pluhuri natyral pezull, kripa e detit etj. PM mund të shkaktojë dhe përkeqësojë sëmundjet e zëmërës dhe mushkërive, goditjet në zemër dhe aritmi. PM mund të dëmtojë sistemin nervor qendror, sistemin riprodhues dhe mund të shkaktojë kancer. Gjithashtu nga ekspozimi i gjatë i njeriut në një mjedis me ndotje të madhe nga PM10 shkakton vdekje të parakohshme. Monitorimi është realizuar me TECORA, me metodën gravimetrike dhe të dhënat janë llogaritur ditore. Aparatet TECORA për monitorimin e grimcave të pluhurit PM10 instalohen pranë Bashkive të qyteteve të marra në studim.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

Figura 6-3 Vlerat mesatare të PM10 të monitoruara gjatë periudhës Prill-Dhjetor 2021.

Qytetet	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Vlorë	32.77 µg/m ³	23.31 µg/m ³	35.09 µg/m ³	30.39 µg/m ³	31.62 µg/m ³	24.14 µg/m ³	17.38 µg/m ³	20.58 µg/m ³	22.2 µg/m ³
Berat	26.92 µg/m ³								
Lezhë			46.89 µg/m ³						
Norma Vjetore e BE	40 µg/m ³	40 µg/m ³	40 µg/m ³	40 µg/m ³	40 µg/m ³	40 µg/m ³	40 µg/m ³	40 µg/m ³	40 µg/m ³

Grafiku 6.b Shpërndarja e PM10 për të tre qytetet gjatë vitit 2021



Burimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Raporti i Gjendjes së Mjedisit 2021

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

6.3 Faktoret klimaterike

Pas perfundimit Komunikimit Kombetar te Pare dhe te Dyte te Konventes se Kombeve te Bashkuara per Ndryshimet Klimatike (UNCCC), Shqiperia ka perparuar me procesin e Komunikimit te Trete Kombetar.

VLERESIMI I NDRYSHIMIT DHE ADAPTIMIT


Qellimi i vleresimit perfshin si modelimin klimaterik ashtu dhe vleresimin e integruar te ndikimeve te ndryshimeve klimaterike ne sektoret kryesore ne zonat bregdetare te Shqiperise. Keta sektore kryesore jane: bujqesia, shendetesia, burimet ujore, fatkeqesite natyrore, turizmi dhe biodiversiteti.

Vemendje e veçante i eshte kushtuar vleresimit te fatkeqesive natyrore te lidhura me ndryshimet klimatike dhe menaxhimit te tyre. Fokusi ne keta sektore ne zonen bregdetare eshte percaktuar me ane te konsultimeve me palet e interesuara, i cili theksoi rolin e rendesishem qe zona bregdetare ka ne prioritetet kombetare te zhvillimit ne Shqiperi. Shkalla e vleresimit eshte ne nivel kombetar, pra pergjate gjithe vbregdetit. Do te zhvillohet nje plan i pershtatjes per zonen bregdetare (i perbere nga nje portofol i projekteve per zbatim), duke pasur si pikenisje rezultatet e projektit "Identifikimi dhe zbatimi i adoptimit te masave reaguese ne deltat e lumenjve Drin - Mat".

NDRYSHIMET E PARASHIKUARA NE REGJIMIN E TEMPERATURES

Per shkak te ndryshimit te mundshem te regjimit te temperatures, zona bregdetare shqiptare ka te ngjare te ngrohjet me tej. Te gjitha skenaret tregojne nje rritje te mundshme te temperaturave vjetore per te gjitha horizontet kohore, lidhur me vitin 1990 (Figura me poshte).

Figura 6-4 Ndryshimet e vlerave te temperaturave vjetore deri ne vitin 2100 sipas skenareve te ndryshem



Burimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit - Raporti i Gjendjes se Mjedisit, 2017

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

Tabela me poshte tregon ndryshimet e parashikuara te temperatures deri ne vitin 2100 si rezultate mesatare ne skenare te ndryshem.

*Tabela 6-1 Parashikimet e ndryshimeve ne temperature (*C) nga horizonte te ndryshme kohore te lidhura me vitin 1990*

Vitet	2030	2050	2080	2100
Vjetore	1.0 (0.7 deri 1.2)	1.7 (1.3 deri 2.2)	2.8 (2.0 deri 3.5)	3.2 (2.4 deri 4.1)
Dimer	0.8 (0.7 deri 0.9)	1.2 (1.1 deri 1.4)	2.0 (1.7 deri 2.3)	2.4 (1.9 deri 2.7)
Pranvere	1.0 (0.8 deri 1.12)	1.5 (1.3 deri 1.8)	2.6 (2.2 deri 3.0)	3.1 (2.6 deri 3.6)
Vere	1.6 (0.5 deri 1.8)	2.5 (2.1 deri 2.8)	4.3 (3.8 deri 4.9)	5.3 (4.6 deri 6.0)
Vjeshte	1.0 (1.0 deri 1.1)	1.6 (1.5 deri 1.8)	2.8 (2.7 deri 3.0)	3.5 (3.2 deri 3.7)

Burimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit - Raporti i Gjendjes se Mjedisit, 2017

NDRYSHIMET E PARASHIKUARA NE REGJIMIN E RESHJEVE


Te gjithë skenaret tregojne nje ulje te reshjeve vjetore per te gjitha horizontet kohore, lidhur me vitin 1990. Duke u bazuar ne rezultatet e tyre arrihet ne perfundimin se ekziston mundesia e zvogelimit te reshjeve vjetore me -8,5 % (nga -56,0 % deri ne 47,4 %) ne vitin 2050; dhe me -18,1 % (nga -89,7 % deri ne 94,0 %) ne vitin 2100 (Tabela me poshte dhe Figura me poshte).

Tabela 6-2: Parashikimet e ndryshimeve ne reshje (%) nga horizonte te ndryshme kohore te lidhura me vitin 1990

Vitet	2030	2050	2080	2100
Vjetore	-3.84(-35.4 deri 27.7)	-8.46(-56.0 deri 47.4)	-14.37(-78.6 deri 81.1)	-18.13(-89.7 deri 94.9)
Dimer	-5.96(-15.9 deri 4.0)	-10(-27.9 deri 7.7)	-14.3(-44.6 deri 16.1)	-18.1(-55.8 deri 19.6)
Pranvere	-2.45(-11.9 deri 7.0)	-7.26(-25.3 deri 10.75)	-14.26(-45.1 deri 16.6)	-17.7(-55.3 deri 19.8)
Vere	-10.4(-12.8 deri -7.9)	-19.7(-24.1 deri -15.3)	-41.9(-49.2 deri -34.5)	-50.4(-59.4 deri -41.3)
Vjeshte	0.5(-10.1 deri 11.1)	-2.5(-21.3 deri 16.3)	-6.9(-38.1 deri 25.2)	-9.5(-48.1 deri 29.1)

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

Figura 6-5: Ndryshimi i parashikuar për reshjet vjetore (%)



Burimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit - Raporti i Gjendjes së Mjedisit, 2017

Inventari Kombëtar i Gazeve me Efekt Serrë

Shqipëria ka zhvilluar një inventar të emetimeve antropogjene sipas burimeve dhe përthithjeve nga përthithësit për të gjitha gazet me efekt serrë (GES) të emetuara në atmosferë ose të përthithura nga atmosfera që prej vitit 1990, si pjesë të Komunikimeve të saj Kombëtare për Ndryshimet Klimatike. Shqipëria, publikoi për herë të parë një Raport për Inventarin Kombëtar i cili ofron informacione të hollësishme në lidhje me inventarin e GES-ve për vitet 2010-2016 dhe një rishikim të rezultateve të inventarit për vitin 2009, për t'u përshtatur me përdorimin e Udhëzimeve të Programit të Ndryshimeve Klimatike (PNK) të vitit 2006.

Inventari mbulon emetimet për të gjitha gazet me efekt serrë dhe përllotatitjet e përthithjeve sipas ndarjeve në Udhëzimet e PNK-së të vitit 2006: Energjia, PIPP, BPPTT dhe mbetjet. Inventari mbulon GES-et e mëposhtme: CO₂, CH₄, N₂O, PFC-të dhe HFC-të dhe emetimet e prekursorve dhe të gazeve me efekt jo të drejtpërdrejtë të CO, NOX, NMVOC dhe SO₂.


Inventari i Gazeve me Efekt Serrë: u koordinua nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit si pika e kontaktit e KKKBNK-së dhe autoriteti qendror në Shqipëri përgjegjës për politikën për ndryshimet klimatike. Në tabelën dhe figurën e mëposhtme paraqiten emetimet neto, përfshirë përthithjet nga Bujqësia, Pyjet dhe Përdorimet e Tjera të Tokës (BPPTT), për vitet 2009-2016, të ndara sipas sektorëve. Kontribuesit më të rëndësishëm të emetimeve të GES-ve në Shqipëri janë sektori i energjisë dhe ai i bujqësisë, pyjet dhe përdorimet e tjera të tokës (BPPTT).

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

Figura 6-6: Emetimet antropogjene të GES-ve në Shqipëri, të ndara sipas sektorëve (Gg CO₂ e.)

Sektori	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Energjia	4340	4347	4398	4252	5026	4746	4813	4781
PIPP	1358	967	1125	1154	1245	1194	1106	1020
BPPTT	3748	3870	6647	7641	3641	3560	3620	3688
Mbetjet	621	660	705	747	784	801	821	839
Të tjera	75	80	82	83	86	104	129	134
Totali	10 141	9924	12 957	13 876	10 782	10 405	10 489	10 461

Grafiku 6.c Emetimet dhe përthithjet e CO₂ e. nga të gjithë sektorët e ekonomisë (Gg)



6.4 Uji

Nderkohe që Shqipëria ka burime ujore të konsiderueshme, përdorimi dhe shfrytëzimi i këtyre burimeve ka vuajtur nga administrimi i papërshtatshëm dhe joefikas i ujit. Sektori i ujit është menaxhuar në mënyrë të fragmentuar nga disa institucione të lidhura me ujin, shpesh me mbivendosje përgjegjësite dhe detyrash.

Për t'iu përgjigjur kësaj situatë mbizotëruese, Qeveria e ka identifikuar ujin: (1) si një nga gjashtë prioritetet kyçe të saj (siç është diskutuar në Pjesën II të këtij dokumenti); (2) si një nga pilotet për qasjen e Sektorit dhe përdorimit të Grupeve të Menaxhimit të Politikave të Integruara (IPMGs); dhe (3) kombinuar me çështje të ujerave të zeza është përcaktuar si një

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

nga 27 strategjite sektoriale te miratuara te qeverise: "Strategjise Kombetare Sektoriale per ujesjellesit dhe kanalizimit 2014 - 2020". "Strategjia Kombetare Ndersektoriale per Menaxhimin e Mbetjeve 2010-2025" dhe "Plani Kombetar per Menaxhimin e Mbetjeve 2010-2025" jane miratuar ne janar 2011.

Keto nisma te kombinuara te politikave pritet te gjenerojne permiresime te konsiderueshme ne menaxhimin e ujit, ofrimin e sherbimeve, mbrojtjen e mjedisit, prodhimin bujqesor, zhvillimin turistik dhe sektoret perkates. Megjithate, ne udhe perpara theksi duhet vene ne rritjen e cilesise se sherbimit dhe permiresimin e kushteve qe kane lidhje me jetesen e qytetareve.

Per sa i perket sektorit si nje i tere, sherbimet e furnizimit me uje dhe kanalizimeve ne Shqiperi kane pesuar disa permiresime gjate viteve te fundit. Investimet kryesore per sa i perket ujit dhe kanalizimeve jane drejtuar kryesisht ne zonat e medha urbane dhe bregdetare. Megjithate, keto investime nuk kane gjeneruar perfitimet e pritura te efektshmerise ne nivelin e sherbimeve. Kjo ka ndodhur per nje sere faktoresh: (1) menyra se si jane shperndare investimet nder vite; (2) kostot e larta te operimit dhe mirembajtjes se impianteve te trajtimit te ujerave te zeza; dhe (3) cilesia nenoptimale e menaxhimit ne ofrimin e sherbimit. Situata aktuale dhe çeshtjet specifike me kater "perdorimet" kryesore ose nensektoret e ujit (per njerezit, per ushqim, per natyren dhe per industrine dhe qellime te tjera) eshte permblodhur me poshte.⁴

Per sa i perket ujit per njerezit (furnizimi me uje dhe kanalizime) - nen-sektori me i rendesishem - Shqiperia perballat me probleme serioze, pavaresisht faktit se niveli mesatar i investimit per sherbimet e ujit dhe kanalizimeve gjate periudhes 2007-2013 ka qene i konsiderueshem (€ 50 milion ne vit). Megjithate, niveli i humbjeve te ujit ne rrjet mbetet problematik. Per vitin 2013, keto humbje ishin 67%, po thuaj i njejti nivel 68,6% i regjistruar ne vitin 2007. Per momentin, kapaciteti i prodhimit te ujit ne Shqiperi eshte 270 milion m³ prodhuar nga 316 burime⁵. Te dhenat tregojne se 89 milion m³ ose 33% e ujit te prodhuar shitet per te gjeneruar te ardhura nga sektori. Si pasoje 181 milion m³ ose 67% e ujit te prodhuar rezulton ne humbjen e te ardhurave.

Tabela 6-3: Vleresimi i perafert i perdorimit te ujit ne Shqiperi

Perdorimi i ujit	Vellimi (miliarde m ³)
Uji per njerez	0,22
Uji per ushqim	1 013
626 rezervuare	0 560
Lumenjte dhe liqenet	0 450
Ujerat nentokesore	0 003
Uji per industrine	14,0
Totali	15 233

⁴ Kjo analizë përmbledhëse është bazuar po ashtu mbi "Dokumentin e Planifikimit të Sektorit" për sektorin e ujit që është zhvilluar nga Qeveria në mesin e vitit 2015.

⁵ Ku 109.8 milion m³/ujë në vit prodhohet nga 93 burime të sistemeve me rrjedhje të lirë dhe 160.5 milion m³/ujë në vit prodhohet nga 223 burime me sisteme mekanike.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

Burimi: Shqipëria - Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore

Burimet e ujit të pijshëm përbëjnë një aset të madh për Shqipërinë. Sasia mesatare e ujit të pijshëm në dispozicion llogaritet në 8,700 metra kub për frymë në vit⁶, që është një nga më të lartat në Evropë. Burimet e ujit të pijshëm në vend ekzistojnë në formën e burimeve natyrore, lumenjve, liqeneve dhe ujërave nëntokësore. Furnizimi me ujë të pijshëm vjen kryesisht nga burime natyrore dhe burime ujore nëntokësore, me përjashtim të dy rasteve si: zona metropolitane e Tiranës, e cila merr një pjesë të furnizimit të saj nga një burim uji sipërfaqësor në malet ku është ndërtuar një digë për të krijuar një rezervuar artificial, që rrjedhimisht duhet trajtuar; dhe zona turistike e Kavajës e cila merr një pjesë të furnizimit të saj në sezonin veror nga liqeni artificial i Maskurisë, i cili ka krijuar natyrshëm dhe gradualisht një rezervuar sipërfaqësor që duhet të trajtohet.

Burimet ujore në Shqipëri shpërndahen në mënyrë hidrografike në shtatë(7) basene ujore⁷, të cilat të gjitha rrjedhin në një drejtim perëndimor ose veri-perëndimor në të gjithë vendin dhe kanë si sistemet kryesore të tyre të lumenjve, nga veriu në jug, respektivisht: Lumenjtë Drini-Buna, Lumi Mati, Lumi Ishem, Lumi Erzeni, Lumi Shkumbin, Lumi Semani dhe Lumi Vjosa. Vlen të përmendet se këto sisteme të lumenjve përshkojnë jo vetëm Shqipërinë, por edhe pjesë të mëdha të zonave të banuara të Maqedonisë së Veriut, Kosovës dhe Malit të Zi.

Kapaciteti mesatar vjetor i të gjitha burimeve të ujit të përdorura për prodhimin e ujit të pijshëm të shoqërive ujësjellës-kanalizime të monitoruar për vitin 2021 ishte 495 milion metra kub. Referuar raportit vjetor të bilancit vjetor të ERRU-se për vitin 2021, vëllimi i përgjithshëm i ujit të prodhuar ishte 311,2 milion metra kub, ndërsa kërkesa totale e vëllimit të ujit në të gjitha zonat e juridiksionit të shoqërive ujësjellës-kanalizime për vitin 2021 për popullsinë totale (census 2011) ishte 100 milion metra kub.


Bazuar në sa me sipër, uji total i disponueshëm për të gjitha shoqëritë UK tejkalon kërkesën kombëtare nga konsumatorët që ato shërbejnë me rreth 80%. Megjithatë kjo na tregon se kapaciteti ujqor është i mjaftueshëm, bazuar në raportet Vjetore të Bilancit të Ujit të hartuara nga ERRU, ka dallime të dukshme ndërmjet shoqërive ujësjellës-kanalizime dhe në raste të veçanta ka disa shoqëri UK për të cilat kerkohen burime të reja shtese të furnizimit me uje. Niveli humbjeve të ujit rezultojnë të jetë i lartë në shumicën e shoqërive UK.

⁶ Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore 2018-2027.

⁷ VKM Nr. 696, datë 30.10.2019 "Për miratimin e kufijve territorialë dhe hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe krijimin dhe përbërjen e këshillit të tyre"

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

Figura 6-7 Harta e Shqipërisë me 7 Basenet Ujore



VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

Problemet kryesore ne lidhje me ujin per njerezit perfshijne:

- (1) mungesa e infrastruktures adekuate;
- (2) vetem 28 nga 56 ndermarrjet e ujit jane ne gjendje te ofrojne furnizim me uje dhe kanalizimeve;
- (3) mbulimi me uje per zonat urbane dhe rurale eshte 80,3% ;
- (4) mbulimi me kanalizime eshte vetem 47,9 %;
- (5) numri i madh i lidhjeve te paligjshme;
- (6) disponueshmeria e sherbimit ne nje mesatare prej 12 ore ne dite;
- (7) perdorimi i ulet i matjes (normat e sheshta aplikohen gjeresisht);
- (8) uji i pa- faturuar eshte 67.1 % dhe norma e faturimit eshte 82,25 %; dhe
- (9) nga tete impiantet e trajtimit te ujrave te zeza te ndertuara, vetem pese funksionojne aktualisht.

Ka ende shqetesime edhe per menaxhimin e pergjithshem te sherbimeve te ujit dhe kanalizimeve: (1) qeverite vendore nuk ushtrojne kompetencat e tyre siç jane percaktuar nga ligji; (2) Keshillat Mbiqeqyrese formale nuk i vezhgojne rregullisht kerkesat e ligjit, perfshi zbatimin e dobet; dhe (3) kapacitetet e pergjithshme te dobeta profesionale dhe teknike te kompanive te furnizimit te ujit.

Sektori i bujqesise eshte nje nga perdoruesit me te rendesishem, veçanerisht per **prodhimin e ushqimit**. Megjithate, ky sektor perballlet me disa probleme: (1) mungesa e ujit per ujitje gjate periudhes se veres; (2) rreziku i permbytjeve gjate reshjeve te renda ne periudhen e dimritpranveres; (3) shqetesime te sigurise rreth rezervuareve te ujitjes dhe digave; (4) infrastrukture e vjeter dhe e amortizuar (nderhyrjet ne sisteme jane duke u bere teper te kushtueshme); (5) mungesa e fondeve dhe e investimeve ne mirembajtjen e sistemeve ujitese dhe kulluese; dhe (6) mungesa e nje sistemi te rikuperimit te kostos operative.

Uji per natyren eshte nje komponent kyç i mjedisit dhe vendi ka pesuar ndryshime te pakthyeshme ne shtratet e lumenjve. Shqetesimet aktuale jane: (1) strategjia per menaxhimin e burimeve ujore eshte e vjetruar (1997) dhe nuk pasqyron realitetin aktual (nje strategji e re eshte ne pergatitje e siper); (2) mungesa e menaxhimit te basenit lumor; (3) mungesa e inventari te burimeve ujore bazuar ne basenet e lumenjve; (4) nxjerrja e paligjshme dhe e pakontrolluar e zhavorrit te lumit; (5) nxjerrjen e paligjshme dhe e pakontrolluar e ujit; dhe (6) kapacitetet e dobeta institucionale ne nivel lokal.

Uji per industrine Prodhimi dhe shitja e energjise hidro-elektrike eshte nje nga burimet kryesore te te ardhurave te qeverise dhe per kete arsye ka nje ndikim direkt mbi stabilitetin fiskal. Pavaresisht rendesise se tij ekonomike, zhvillimi i pershtatem per industrine eshte penguar nga mungesa e inventareve te ujerave mbitokesore dhe nentokesore (veçanerisht per burimet e ujit qe mund te perdoren per prodhimin e energjise elektrike) dhe boshlleqet ligjore ne pergjegjesite e autoriteteve per bazenin e lumenjve.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

6.5 Natyra


Shqipëria është e mirënjohur për ekosistemet dhe habitatet me shumë larmi. Brenda territorit të saj ka ekosisteme detare, zona bregdetare, liqene, lumenj , gjelberim të perjetshëm dhe shkurre, pyje gjethëgjere, pyjet me pish , kullota alpine e nen-alpine, livadhe dhe ekosisteme të larta malore.

Sipërfaqja totale e tokës në Shqipëri është e ndarë në tre zona kryesore ekologjike (zona bregdetare thjeshtë, zona kodrinore nen-malore tranzicionit dhe zona malore) dhe 13 nen-zona, të cilat kontribuojnë në biodiversitetin e pasur të vendit.

PYJET

Shqipëria është e pasur në burime pyjeve dhe të kullotave. Ka 4 zona fitoklimatike në Shqipëri si rezultat i disa faktorëve si toka, klima, dhe bimesia të quajtura: zona e pyjore dhe e shkurreve mesdhetare, zona me pemë lisi, zona me pemë ahë dhe halorë, dhe kullotat alpine. Pyjet mbulojnë 1,030,000 ha ose 36 % të territorit të vendit dhe kullotat rreth 400,000 ha ose 15% . Përafërsisht 60 % (244,000 ha) e kullotave janë kullota alpine, nen-alpine dhe livadhet.

Figura 6-8: Harta e zonave pyjore në Shqipëri



VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

Pyjet dhe kullotat kane nje larmi te llojeve, formacioneve dhe komuniteteve bimore dhe shtazore. Prafersisht 60% e kullotave jane kullota alpine, nen-alpine dhe livadhe. Pyjet dhe kullotat kane nje diversitet te larte te shkurreve mesdhetare, pyjeve me lis, pyjeve me ah, pishave malore, etj. dhe komuniteteve te kafsheve.

Pergjate bregdetit te vendit ka shume ekosisteme me rendesi ne rajonin e Mesdheut si per shembull laguna, ligatina, duna ranore, delta lumenjsh, pyje hidrofile dhe higrofile. Liqenet dhe lumenjte jane gjithashtu te rendesishem per larmine biologjike dhe peizazhore te vendit. Bukuria e peizazhit e ben Shqiperine terheqese per aktivitete rekreative bazuar ne natyre.

BIODIVERSITETI

Duke marre parasysh informacionin ekzistues, Shqiperia ka nje diversitet te pasur te flores dhe faunes me rreth 3.200 lloje te bimeve vaskulare, 2.350 lloje te bimeve jo vaskulare dhe 15.600 specie invertebroresh dhe vertebroresh. Shqiperia eshte nje rruge e rendesishme migrimi per zogjte.

Ne Shqiperi gjenden afersisht 30% e flores evropiane dhe 42% e gjitareve evropiane. Relievi ka krijuar kushtet per ekzistencen dhe mbrojtjen e nje speciesh endemike dhe nen-endemike. Ka 32 specie bimore me 150 nenspecie qe jane endemike ne Shqiperi dhe 160 specie te tjera bimore qe jane nen- endemike ne rajonin e Ballkanit.

Shqiperia ka 91 specie ornitofauna te rrezikuara globalisht dhe disa prej tyre kane rendesi kritike (p.sh. *Pelecanus crispus*, *Phalacrocorax pygmeus*, and *Acipenser sturio*). Lagunat bregdetare dhe liqenet e medha jane zona te rendesishme, veçanerisht per zogjte qe migrojne ne dimer. Ne to, çdo vit hasen 70 specie te shpendeve te ujit dhe zogjve te ujit me nje popullsi te pergjithshme prej 180.000 individesh ne Shqiperi gjate dimrit. Shqiperia ka nje numer racash autoktone te bagetive dhe te lashtave. Rreth

30 specie te lashtash jane autoktone te Shqiperise. Ka 9 raca autoktone dhish dhe 5 delesh. Ka nje trashegimi te rendesishme per mbrojtjen dhe permiresimin e prodhimit dhe cilesise se bujqesise dhe blegtorise.

Ne malesite ka me shume se 52 00 ha pyje natyrore me peme me shume se 200 vjeçare me vlere te larte per biodiversitetin e kafsheve dhe shpendeve te egra dhe per qellime argetimi. Kjo zone eshte zona me e rendesishme per kerkime dhe burime gjenetike.

FLORA

Flora e shumellojshme e Shqiperise perben rreth 30% te te gjitha llojeve bimore evropiane ne vend ku rreth 3.200 lloje te flores dhe rreth 250 specie kane vlere mjekesore, si ereza dhe aromatike. Elementet kryesore te flores shqiptare jane mesdhetare (24%), ballkanike (22%), evropiane (18%) ,dhe euroaziatike (14%) .

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

FAUNA

Persa i perket spektrit faunistik te vendit ai dominohet nga elemente Euroaziatik, Holartik, Mesdhetar dhe Ballkanik. Pyjet e larte te Shqiperise mbajne komunitete gjitaresh te medhenj si ujku, ariu, rreqebulli, dhia e eger, derri i eger, kaprolli etj. Rreth 756 lloje rruazoresh raportohen deri me sot ne Shqiperi dhe prej tyre 70 lloje gjitaresh, 323 shpende, 36 reptile dhe 15 amfibe. Shume prej tyre jane lloje te rrezikuara ose te kercenuara. Terreni malor ne brendesi siguron habitat per gjitaret e medhenj si ariu.

ZOGJTE

Shqiperia ka nje klime te bute mesdhetare qe mbeshtet nje grup unik llojesh shpendesh, qe perfshin lloje te rralla dhe te rrezikuara si Pelikani kaçurrel. Ne Shqiperi gjenden 277 lloje shpendesh te 48 familjeve. Gjithashtu 2 nga 9 llojet endemike evropiane gjenden ketu.

MBROJTJA E SPECIEVE DHE HABITATEVE

Ne ndjekje te zbatimit te dispozitave te ligjeve hartohen aktet nenligjore, te cilat plotesojne bazat ligjore per elemente te veçanta te natyres. Ne mesin e dokumenteve te tilla eshte lista e flores dhe faunes qe jane nen mbrojtje dhe jane materializuar me botimin e Librit te Kuq te Flores shqiptare dhe Librin e Kuq te Faunes Shqiptare.


Mbrojtja e llojeve me interes per t'u ruajtur realizohet permes dispozitave te veçanta te ligjit per biodiversitetin dhe ligjit per mbrojtjen e faunes se eger. Ligji i biodiversitetit ne te njejten kohe permban dispozita per speciet pushtuese dhe masat mbrojtese per ruajtjen e specieve. Arritja e statusit te favorshem te ruajtjes per speciet synohet nepermjet ligjit te biodiversitetit dhe ligjit per zonat e mbrojtura qe permbajne dispozita per mbrojtjen e biodiversitetit brenda zonave te mbrojtura dhe jashte tyre.

Mbrojtja e habitatit behet nepermjet dispozitave te ligjit per zonat e mbrojtura, bazuar mbi te cilat eshte shfaqur rrjeti perfaqesues i zonave te mbrojtura qe do te sherbejne per te identifikuar dhe krijuar rrjetin ekologjik NATURA 2000. Ligji per mbrojtjen e faunes se eger parashikon dispozita mbrojtese per habitatet e rendesishme per shpendet ne pergjithesi dhe shpendet shtegtare ne veçanti.

Bazuar ne dispozitat ligjore kombetare te gjitha llojet e listuara ne Listen e Kuqet te flores dhe faunes se eger te Shqiperise, sipas kategorive te ndryshme ne rrezik te IUCN-se, gezojne mbrojtje te veçante dhe nuk mund te perfshihen ne listen e llojeve per gjueti ne Republikene Shqiperise. Aktualisht, 405 llojet flores se eger dhe 575 lloje te faunes se eger jane perfshire ne Listen e Kuqe (Ministria e Mjedisit, Urdhri i Ministrise nr. 1280 i dates 20.11.2013).


VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

Figura 6-9: Tabela permbledhese e Listes se Kuqe te specieve te flores dhe faunes



Burimi: Ministria e Mjedisit - Raporti i Peste Kombetar i Shqiperise ne Konventen e Kombeve te Bashkuara per Diversitetin Biologjik - May 2014

Figura 6-10: Speciet e mbrojtura te faunes se eger sipas grupeve kryesore te klasifikimit



Burimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit - Raporti i Peste Kombetar i Shqiperise ne Konventen e Kombeve te Bashkuara per Diversitetin Biologjik - May 2014

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

Figura 6-11: Statusi i mbrojtjes per speciet e flores

Grupi	Numri i përgjithshëm në Shqipëri	Speciet e kërcënuara në nivel:			Speciet e mbrojtura nga:				
	Totali	Kombetar	Global	Evropian	Konventa Barcelones	Konventa Bernit	Qytetet	Direktiva e habitateve	VKM
Bimet	3228	363	80	80		11	37	2	308
Alga detare	Totali 156	13			3	3			
	Alga e kuqe 82	7			1	1			
	Alga kafe 36	4			2	2			
	Alga jeshile 38	2							

Burimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Figura 6-12: Statusi i mbrojtjes per speciet e flores

Grupi	Nr. i përgjithshëm në Shqipëri	Speciet e kërcënuara në nivel	Speciet e mbrojtura nga:							
			Kombetar	Global	Konvent. Barcelones	Konvent. Bernit	Konvent. Bonit	qytetet	Direktiva e habitateve	Direktiva per zogjte
Gjitaret	91	46	21	5	63	31	11	40		42
Zogjte	330	115	17 / 119 (Eur)	14	217	146	52		186	
Zvarraniket	37	37	9	3	37	3	3			24
Amfibet	15	15	2		15					8
Peshqit	311	54	16	17	31	5	4	13		1
Insektet	680	108	16		10	2	4			
Molusket	183	130	1	9	8		1			

Burimi: Ministria e Mjedisit

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

Disa nga llojet me te rendesishme te shpendeve qe gjenden ne vend, perfshi shqiponjen e arte - e njohur si simboli kombetar i Shqiperise - llojet e grabitqareve, thellezat e pyllit dhe shpendet dimeronjes. Pyjet e Shqiperise ende ruajne komunitete te konsiderueshme te gjitareve te medhenj, siç jane ariu kaf, ujku gri, dhia e eger dhe derri i eger. Malet ne veri dhe lindje te vendit jane habitati i i fundit i mbetur i rreqebullit ballkanik - nje popullate e rrezikuar se tepermi e rreqebullit euroaziatik.

Figura 6-13: Harta e zonave te mbrojtura



IUCN II: Park kombetar

IUCN III: Monument natyre

IUCN IV: Rezerve natyrore e menaxhuar IUCN V: Peizazh/vije detare e mbrojtur

IUCN VI: Rezerve me burime te menaxhuara

Burimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

Gjate viteve të fundit Shqipëria ka ecur përpara dhe ka bërë investime të mëdha për mbrojtjen e ardhme të aseteve natyrore unike dhe të peizazhit. Në ndjekje të fushave kryesore të punës që janë identifikuar nga NBSAP 2000 si dhe rezultatet e Programit Kombëtar të Punës mbi Zonat e Mbrojtura (PKPZM) për periudhën 2006-2009, rrjeti i zonave të mbrojtura është zgjeruar.

Që nga viti 1996, sipërfaqet e deklaruara ligjrisht si zona të mbrojtura në Shqipëri janë me se trefishuar nga 108,475 ha në 378,748 ha, duke e çuar përqindjen totale të zonave të mbrojtura në kategori të ndryshme të menaxhimit në 13,17% në vitin 2011, krahasuar me vetëm 5,7% në 2002. Trendi pozitiv është veçanërisht i dukshëm për caktimin ligjor të zonave të mbrojtura që korrespondojnë me kategorinë IUCN:

IUCN I: Rezerve rreptesisht natyrore/rezerve shkencore

Tabela 6-4: Lista e zonave të mbrojtura

Id	Zona	Kategoria	Zona (ha)	Jo nga PA
Zonat e mbrojtura shpërndare në disa rajone				
01	Divjake-Karavasta	IUCN II: Park kombëtar	22 230,2	1
02	Shebenik-Jabllanice	IUCN II: Park kombëtar	33 927,7	1
03	Bredhi i Hotoves-Dangelli	IUCN II: Park kombëtar	34 361,1	1
04	Mali i Dajtit	IUCN II: Park kombëtar	29 216,9	1
05	Mali i Tomorrit	IUCN II: Park kombëtar	24 723,1	1
06	Korab-Koritnik	IUCN IV: Rezerve natyrore e mbrojtur/Park natyror	55 550,2	1
07	M. Gropa-Bizë-Martianesh	IUCN V: Peizazh i mbrojtur	25 266,4	1
08	Monumente biologjike	IUCN III: Monument natyre	0,0	348
09	Monumente gjeologjike	IUCN III: Monument natyre	0,0	398

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

Id	Zona	Kategoria	Zona (ha)	Jo nga PA
Rajoni i Vlores				
10	Vjose – Narte	IUCN V: Peizazh i mbrojtur	19 738,0	1
11	Rrezoma	IUCN IV: Rezerve natyrore e mbrojtur/Park natyror	1 400,0	1
12	Butrinti	IUCN II: Park kombetar	9 424,4	1
13	Syri i Kalter	IUCN III: Monument natyre	180,0	1
14	Llogara	IUCN II: Park kombetar	1 010,0	1
15	Karaburun	IUCN IV: Rezerve natyrore e mbrojtur/Park natyror	20 000,0	1
16	Karaburun – Sazan	IUCN II: Park kombetar	12 428,0	1
Rajoni i Gjirokastrës				
17	Kardhiq	IUCN I: Rezerve rreptesisht natyrore/rezerve shkencore	1 800,0	1
18	Zhej	IUCN III: Monument natyre	1 500,0	1
19	Bredhi i Sotires	IUCN III: Monument natyre	1 740,0	1
Rajoni i Korçës				
20	Guri i Nikes	IUCN VI: Rezerve me burime te menaxhuara	2 200,0	1
21	Liqeni i Pogradecit	IUCN V: Peizazh i mbrojtur	27 323,0	1
22	Prespa	IUCN II: Park kombetar	27 750,0	1
23	Cangonji	IUCN IV: Rezerve natyrore e mbrojtur/Park natyror	250,0	1
24	Bredhi i Drenoves	IUCN II: Park kombetar	1 380,0	1
25	Krastafillak	IUCN IV: Rezerve natyrore e mbrojtur/Park natyror	250,0	1

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

Id	Zona	Kategoria	Zona (ha)	Jo nga PA
26	Nikolice	IUCN V: Peizazh i mbrojtur	510,0	1
27	Germenj-Shelegur	IUCN IV: Rezerve natyrore e mbrojtur/Park natyror	430,0	1
28	Piskal – Shqeri	IUCN VI: Rezerve me burime te menaxhuara	5 400,0	1
Rajoni i Durresit				
29	Qafe Shtame	IUCN II: Park kombetar	2 000,0	1
30	Rrushkull	IUCN IV: Rezerve natyrore e mbrojtur/Park natyror	650,0	1
Rajoni i Fierit				
31	Pishe Poro	IUCN IV: Rezerve natyrore e mbrojtur/Park natyror	1 500,0	1
32	Levan	IUCN IV: Rezerve natyrore e mbrojtur/Park natyror	200,0	1
Rajoni i Elbasanit				
33	Kuturman	IUCN IV: Rezerve natyrore e mbrojtur/Park natyror	3 600,0	1
34	Qafe Bushi	IUCN IV: Rezerve natyrore e mbrojtur/Park natyror	500,0	1
35	Polis	IUCN IV: Rezerve natyrore e mbrojtur/Park natyror	45,0	1
36	Stravaj	IUCN IV: Rezerve natyrore e mbrojtur/Park natyror	400,0	1
37	Sopot	IUCN IV: Rezerve natyrore e mbrojtur/Park natyror	300,0	1
38	Dardhe-Xhyre	IUCN IV: Rezerve natyrore e mbrojtur/Park natyror	400,0	1
Rajoni i Shkodres				
39	Thethi	IUCN II: Park kombetar	2 630,0	1
40	Liqeni i Shkodres	IUCN IV: Rezerve natyrore e mbrojtur/Park natyror	26 535,0	1
41	Lumi i Bunes-Velipoje	IUCN V: Peizazh i mbrojtur	23 027,0	1

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

Id	Zona	Kategoria	Zona (ha)	Jo nga PA
Rajoni i Lezhës				
42	Berzane	IUCN IV: Rezerve natyrore e mbrojtur/Park natyror	880,0	1
43	Kune-Vain-Tale	IUCN IV: Rezerve natyrore e mbrojtur/Park natyror	4 393,2	1
44	Patok-Fushekuqe-Ishem	IUCN IV: Rezerve natyrore e mbrojtur/Park natyror	5 000,7	1
45	Bjeshka e Oroshit	IUCN VI: Rezerve me burime te menaxhuara	4 745,0	1
Rajoni i Kukësit				
46	Lumi i Gashit	IUCN I: Rezerve rreptesisht natyrore/rezerve shkencore	3 000,0	1
47	Lugina e lumit te Valbones	IUCN II: Park kombetar	8 000,0	1
48	Tej Drini Bardhe	IUCN IV: Rezerve natyrore e mbrojtur/Park natyror	30,0	1
49	Nikaj Mertur	IUCN IV/1: Park natyror rajonal	17 505	1
Rajoni i Dibres				
50	Lura	IUCN II: Park kombetar	1 280,0	1
51	Zall Gjogaj	IUCN II: Park kombetar	140,0	1
52	Vlashaj	IUCN III: Monument natyre	50,0	1
53	Liqeni i Ulzes dhe pjesa perreth	IUCN IV/1: Park natyror rajonal	4 206,0	1
54	Luzni-Buiac	IUCN VI: Rezerve me burime te menaxhuara	5 900,0	1
Rajoni i Beratit				
55	Bogoni	IUCN IV: Rezerve natyrore e mbrojtur/Park natyror	330,0	1
56	Balloll	IUCN IV: Rezerve natyrore e mbrojtur/Park natyror	330,0	1
Totali		16% e territorit te vendit	460 060,9	799

Burimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

Habitatet natyrore si dhe flora e fauna janë nën një presion të vazhdueshëm dhe kanë pësuar ulje të ndjeshme cilësore dhe sasimore. Gjithnjë e më shumë lloje dhe habitate janë nën kërcënim në shkallë të ndryshme. Ndryshimet e mëdha negative ndodhin në vendbanimet e fermave bujqësore, pyjet dhe zonat bregdetare. Shumica e presionit ushtrohet mbi biodiversitetin, veçanërisht në zonat ku përdorimi i tokës për aktivitete nga njerezit është intensiv.

SPECIET ENDEMIKE DHE NEN-ENDEMIKE

Relievi i Shqipërisë ka krijuar kushtet për ekzistencën dhe mbrojtjen e një numri specimesh endemike relikte dhe nen-endemike. Në Shqipëri ka 27 specie bimesh endemike dhe 150 nen-specie bimesh. Një total prej 160 specimesh bimore janë nen-endemike në Shqipëri, Greqi dhe Ish- Republikat Jugosllave.

Midis paleoendemikeve takohen relikte me origjinë shumë të hershme si *Ëulfenia baldaccii*, *Forsythia europea*, *Gymnospermium*, *shqipetarum*, ndërsa prej neoendemikeve mund të përmenden *Lunaria telekiana*, *Crepis bertiscea*, *Petasites doerfleri*, *Leucojum valentinum* subsp. *Vlorense*, *Aster albanicus* subsp. *Paparistoi* dhe të tjera. Në krahasim me floren, faunën shqiptare është më pak e njohur dhe e studiuar. Ajo ka një numër të konsiderueshëm të llojeve endemike dhe relikte. Liqeni i Ohrit shquhet si më i rëndësishmi në vend për sa i përket endemizmit faunistik: mbi 50 lloje Moluskesh të njohur prej këtij grupi në këto liqen dhe 2 lloje peshqish (korani dhe belushka) janë endemike.

Insektet e njohur deri më sot ofrojnë 16 lloje relikte (11 lloje hemipteresh dhe 5 lloje fluturash). Njohja e metejshme e faunës së vendit, në mënyrë të veçantë studimet biospeleologjike, që janë në hapat e para në vendin tone, me siguri do të zbulojnë endemizma të ri në vend.

RENDESIA E SHQIPERISE PËR LLOJET GLOBALISHT TË RREZIKUAR

Shqipëria strehon lloje që janë të kërcënuar në nivel evropian dhe botëror. Ka një numër llojesh globalisht të rrezikuara, me të paktën 73 lloje vertebrorësh dhe 18 invertebrorësh që kanë pjesë të habitatit dhe popullatave të tyre në vend. Për disa nga ato (*Pelecanus crispus*, *Phalacrocorax pygmeus*, *Salmo letnica* dhe *Acipenser sturio*), Shqipëria ka një rëndësi tepër të madhe, deri në kritike për jetën e tyre.

Breshka e detit është gjetur përgjatë bregdetit Jon ku plazhet e ngushta dhe të virgjera janë të pershtatshme për lëshimin e vezëve. Pelikani kaçurrel është një lloj i kërcënuar i cili ka vendndodhjen e vetme të folezimit në Shqipëri në lagunën e Karavastasë. Foka e detit që është praktikisht e zhdukur në Mesdhe me përjashtim të zonave të veçanta të Egjeut dhe Adriatikut, është parë ndonjëherë edhe në Shqipëri.

FLORA

Flora e Shqipërisë përfaqësohet nga 165 familje me rreth 910 gjini. Rreth 15% janë lloje të karakterit Ballkanik dhe pjesa tjetër nen-ballkanike. Elementi floristik mesdhetar përben rreth

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

24% te diversitetit llojor, prej te cilave 8% jane euromesdhetare, 7% stenomesdhetare, 25% mesdhetare atlantike, etj. Elementi floristik evropian ze rreth 18 % ku vendin kryesor e zene llojet e Evropes jugore (5,5%) dhe ato te Evropes juglindore (4,5%). Elemente tejet floristike jane dhe ato euroaziatike me 14% dhe eurosiberiane me 4%. Ne kete numer afro 350 lloje e varietete jane drure e shkurre pyjore, 85% e te cileve rriten e zhvillohen spontanisht ne natyre, kurse 15% jane te introdiktuar (te sjelle nga jashte), per qellime ekonomike e dekorative.

Ne Librin e Kuq 320 lloje bimore konsiderohen te kercenuara apo te rralla. Nga pikepamja e elementit floristik, llojet endemike zene rreth 11%, subendemike rreth 39%, ballkanike rreth 11% dhe subballkanike rreth 4%. Pjesa tjeter rreth 35%, e ze elementi joballkanik. Ne kete liber permenden tre lloje pyjore qe mund te zhduken: geshtenja e kalit (*Aesculus hippocastanum*), tisi (*Taxus baccata*) dhe ylli i Alpeve (*Leontopodium alpinum*). Geshtenja e kalit dhe Tisi konsiderohen si bime relike te terciarit.

FAUNA

Fauna perfaqesohet kryesisht nga elementi euroaziatik por edhe nga elementet holarktik, mesdhetar si dhe endemizmat e subendemizmat ballkanike. Vendi perben gjithashtu nje biokorridor te levizjes se faunes nga veriu ne jug te Evropes e me tej ne Afriken veriore e Azine e vogel dhe e ndersjella.

Ne ujerat e detit Adriatik, te Jonit dhe ato te brendeshme gjendet nje faune e pasur pararruazoresh dhe rruazoresh, qe nga celenteratet e deri te gjitaret e medhenj. Nga pararruazoret takohen rreth 46 lloje ekinodermatesh, 115 lloje krustacesh dhe 520 lloje molusqesh bivalvore dhe gasteropode te ujerave detare, te embla dhe tokesore, nga 720 te pritshem.

Numerohen afro 4.000 lloje insektesh, nga 14.000 lloje te pritshem. Grupin me te madh e perben Rendi Lepidoptera me rreth 1.700 lloje, Rendi i flatramembranoreve me 850 lloje, te flatraforteve me 600 lloje dhe gjysemflatraforteve me 320 lloje.

Iktiofauna perfshin 313 lloje e nenlloje, nga 350 lloje te pritshem ne kete grup. Ujerave te embla i perkasin 64 lloje dhe ujerave detare 249 lloje, nga te cilet 4 lloje jane endemike.

Amfibet dhe reptilet perfaqesojne nje herpetofaune te pasur me 15 lloje amfibesh, nga 16 te pritshem, dhe 37 lloje reptilesh, nga 38 te pritshem. Ne pyje jetojne nje numer i konsiderueshem nga ky grup, qe perfaqesojne afro 10-12 lloje amfibesh dhe 8-10 lloje reptilesh. Nga amfibet lloji *Rana epeirotica* eshte lloj subendemik.

Shpendet perbehen nga 323 lloje, nga 335 lloje te pritshem, e perfaqesohen ne 19 rende dhe 54 familje. Rreth 118 lloje shpendesh jane te perhershme ose 46% e ornitofaunes, 72 lloje jane veronjes, 45 lloje jane dimeronjes, 22 lloje jane kalimtare, 26 lloje jane rastesor dhe 22 lloje te tjera citohen nga literatura. Nga shpendet rreth 62 lloje jane te lidhur teresisht me jeten e pyllit, ku 42 lloje jane te perhershme. Pjesa me e madhe e zogjve gjenden ne zonat ligatinore dhe vecanerisht ne lagunat bregdetare dhe ne liqenet nderkufitare (Shkodra, Ohri dhe Prespa).

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

Gjitarët përfaqësohen me 69 lloje (64 janë tokësore dhe 5 detare), të përafshirë 84 lloje, e përbejnë afro 42% të mamalofaunës europiane (200 lloje). Rendi i lakuriqëve të natës (Chiroptera) ka 26 lloje, Rendi i brejtësve (Rodentia) ka 23 lloje, Rendi i mishngrënësve (Carnivora) ka 13 lloje dhe Rendi i insektngrënësve (Insectivora) përbehet nga 11 lloje. Afro 60 lloje të këtij grupi janë të lidhur me jetën e pyllit, veçanërisht për 13 lloje gjitarësh, jeta e të cilëve është e lidhur tepër ngushtë me ekosistemin pyjor, siç janë ariu (*Ursus arctos*), rriqebulli (*Lynx lynx*), ujku (*Canis lupus*), dhia e eger (*Rupicapra rupicapra*) dhe kaprolli (*Capreolus capreolus*). Lepuri i gropës (*Oryctolagus cuniculus*) jeton vetëm në ishullin e Sazanit. Nga gjitarët 3 lloje janë cilesuar subendemike, *Pitymys thomasi*, *Pitymys felteni* dhe *Talpa stankovic*.

RENDESIA E SHQIPERISE PËR LLOJET SHTEGTARE

Shqipëria është një udhëkryq i rëndësishëm për migrimin e shpendëve, lakuriqëve të natës dhe insekteve. Në të, çdo vit hasen 70 specie të shpendëve të ujtit dhe zogjve të ujtit me një popullatë të përgjithshme prej 180,000 individesh në Shqipëri gjatë dimrit. Gjithashtu në Shqipëri janë regjistruar 5 lloje të rrezikuara shpendësh. Ato janë pelikani kaçurrel, Lesser Kestrel, Corn crane, pata ballebardhe dhe Ferruginous Pochard.

Lagunat bregdetare dhe liqenet e mëdhenj në brendësi të vendit përfaqësojnë zona të rëndësishme veçanërisht për dimerimin e shpendëve shtegtarë. Në paku katër prej këtyre ligatinave (Laguna e Karavastase, Laguna e Nartës, Liqeni i Shkodrës dhe ai i Ohrit) mund të konsiderohen si Zona të një Rëndësie Nderkombëtare për shpendet, të njohura si ZRSH (Zona me Rëndësi për Shpendet), dhe plotësojnë kushtet për të qenë si zona Ramsar (Karavastaja, Butrinti dhe Shkodra janë shpallur të tilla), me më shumë se 20,000 mijë shpende dimeronjës uji secila.

Shqipëria si një vend mesdhetar i pasur me gelqerore dhe shpella, ofron varietete habitatesh që mund të përdoren si vende jetese për lakuriqët e natës. Rreth gjysma e llojeve të gjetura të lakuriqëve të natës njihen si lloje që jetojnë në shpella. Tunelet e ndërtuara në kohët e shkuara për qëllime ushtarake dhe shumica e minierave që nuk përdoren më, janë vende të vlefshme për lakuriqët e natës. Disa nga këto janë tashmë të populluara nga kolonitë e lakuriqëve të natës. Një rast i veçantë është Shpella e Trenit që ndodhet në hyrje të Liqenit të Prespës së Vogel, dhe që është mbushur nga sedimentet e shkarkuara nga devijimi i Lumit Devoll keto 20-25 vjetet e fundit. Mëqenëse kjo shpellë është bërë me e vogël dhe e tharë, ka humbur rëndësinë e saj për të bujtur koloni të vegjëlshme për disa lloje lakuriqësh, veçanërisht për *Miniopterus schreibersi*, *Myotis capaccinii* dhe *Myotis daubentoni* dhe *Eptesicus serotinus*.

LLOJE ME RËNDESI EKONOMIKE

Vlerat mjekësore, industriale dhe ushqimore të shumë bimëve dhe kafshëve janë tashmë të njohura. Deri më sot njihen rreth 300 lloje bimësh mjekësore dhe aromatike, ose afro 10% e florisë së bimëve të larta të vendit. Numri i bimëve që mund të kenë veti kuruese apo rëndësi aromatike mund të jete dhe më i lartë. Rreth 40 lloje bimësh kanë rëndësi foragjere, ndërsa afro

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

35 lloje bimesh kane veti regjese apo ngjyruese. Numri i bimeve mjaltese te njohura deri me sot arrin ne afro 50 lloje, ndersa numri i bimeve qe perdoren si ushqim ne afro 70 lloje. Gjithe llojet e peshqve detare dhe te ujerave te embla, nje pjese e konsiderueshme e molusqeve (sepjet, kalamaret, oktapodet) dhe parruazoreve te tjere detare (si psh karkalecat) perdoren gjeresisht sot si ushqim per njeriun. Kohet e fundit ka filluar dhe konsumi i disa lloje bretkosash. Molusqet jane nje burim i rendesishem per pergatitjen e produkteve farmaceutike dhe produkteve te tjera kozmetike. Guaskat e tyre sherbejne per te prodhuar objekte artistike, pulla, pjese te veglave muzikore etj Insektet kane rendesi te madhe per pjalmim dhe nje pjese e tyre ka vlere ushqimore dhe industriale, si bleta dhe krimbat e mendafshit. Gezofrat e disa gjitareve si kunadhet, dhelpra, ketri etj., kane patur dhe kane ende rendesi per industrine e gezofrave.

Zhvillimi i infrastruktures se transportit ka nje numer efektesh te mundshme mbi biodiversitetin, duke perfshire demtimin e drejtperdrejte te vendeve te rendesishme me natyre te mbrojtur, apo zakonet e llojeve te mbrojtura, fragmentimin ose humbjen e habitateve, duke krijuar barriera ndaj levizjes dhe shkembimit gjenetik ndermjet popullatave dhe pengimin e zakoneve per shkak te zhurmes, ndotjes se lehte dhe materialeve te ndotura qe rrjedhin.

6.6 Zhurma

Ekspozimi ndaj zhurmes mund te kete ndikime negative mbi shendetin e njerezve dhe cilesine e perceptuar te jetes. Toleranca e ekspozimit ndaj natyres ndryshon shume ndermjet individeve, por ne nivel komunitet ka nje lidhje te arsyeshme ndermjet matjes fizike te zhurmes dhe reagimit ndaj bezdisjes. Ndikimet e nivelit strategjik jane te veshtira qe t'ju percaktohet sasia sepse individet reagojne ndryshme ndaj modaliteteve te ndryshme te transportit dhe eshte e veshtire te percaktohet sasia e marredhenies ndermjet burimit te zhurmes dhe marresve. Zona qe ka te ngjare te ndikohet nga zhurma e trafikut eshte llogaritur duke marre parasysh gjatesine e rrjetit ne cdo zone dhe duke aplikuar nje gjeresi standarde korridori ndikimi (sugjerimi i pergjithshem eshte 50m).

Monitorimi tregon se Shqiperia qendron afer vendeve te para ne Evrope me parametra te larte te ndotjes nga zhurma urbane. Si vlerat mesatare te dites ashtu dhe ato te nates e tejkalojne standardin e legjislacionit te BE-se dhe ate shqiptar. Ne veçanti, vlerat mesatare te zhurmes gjate dites dhe nates ne qytetet e monitoruara jane perkatesisht **LAeq 63 dB (A)** dhe **LAeq 49.1 dB (A)**. Te dy vlerat e tejkalojne standardin legjislacionin te BE-se dhe ate shqiptar (LAeq/Diten 55 dB (A) dhe LAeq/Naten 45 dB (A)).

Gjate vitit 2014, vlere mesatare e zhurmes si ditin dhe naten, ka qene me e ulet krahasuar me vitin 2011 (monitorimi i fundit). Tirana vazhdon te jete qyteti me vlere me te larta te zhurmes, gjate dites dhe nates, perkatesisht **LAeq 67.9 dB (A)** dhe **LAeq 57.3 dB (A)**.


VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

Tabela 6-5: Vlera mesatare e zhurmës për qytetet e monitoruara, gjatë ditës dhe natës

	Laeq Ditën dB	Laeq Natën dB
Tirana	63.36	53.05
Vlorë	61.82	49.05
Lezhë	62.64	49.83
Sarandë	62.36	50.39
Pogradec	58.07	46.60
Fier	62.07	51.62
Kukës	53.88	42.41
Gjirokastrë	59.83	50.8
Korçë	59.99	47.72
Berat	58.26	47.07
Shkodër	62.01	50.84
Niveli kufi	55 dB	45 dB

Burimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit - Raporti i Gjendjes së Mjedisit, 2021

Grafiku 6.d Niveli i zhurmave ditën, në qytetet e monitoruara



VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

Grafiku 6.e Niveli i zhurmave natën, në qytetet e monitoruara





Figura 6-14 Harta e monitorimit të zhurmave, 2021



Burimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit - Raporti i Gjendjes se Mjedisit, 2021

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

7 TENDENCAT E MUNDSHME NE TE ARDHMEN, PA STRATEGJINE (ALTERNATIVA "0")

7.1 Toka dhe burimet minerale

PERDORIMI I TOKES BUJQESORE DHE PYJEVE

Ne qofte se strategjia nuk miratohet, vellimi i perdorimit aktual te tokes bujqesore dhe pyjeve do te mbetet ne nivelin aktual. Infrastruktura perkatese e furnizimit me uje dhe kanalizimeve nuk do te rikonstruktohet apo ndertohet mbi bazen e nje analize te nevojave dhe mundesive; prandaj krijimi i kesaj infrastrukture te furnizimit me uje dhe kanalizimeve mund te jete i paplanifikuar, gje e cila do te kete nje efekt negativ ne perdorimin aktual te hapesires, si dhe ne vellimin e perdorimit aktual tokes bujqesore dhe pyjeve.

PERDORIMI I BURIMEVE NATYRORE

Vendi ynë disponon realisht burime natyrore optimale, respektivisht për frymë popullsie krahasuar me statistikat rajonale por edhe ato botërore (në disa burime natyrore me vlereë për ekonominë), pozicion të mirë gjeostrategjik, popullsi të re dhe me nivel arsimor në rritje, krahas trashëgimisë së një tradite, në disa sektorë të furnizimit me uje dhe kanalizimeve. Në këto kushte, një orientim me optimal për zhvillim, duke patur në konsideratë edhe një shpërndarje me të mirë në rajonet e vendit, krijon mundësi për zhvillim harmonik e të qëndrueshëm.

Ne qofte Strategjia Kombetare e Sektorit te Furnizimit me Uje dhe Kanalizimeve nuk miratohet, infrastruktura perkatese e zhvillimit të Sektorit te Furnizimit me Uje dhe Kanalizimeve bazuar ne parimin e zhvillimit te qendrueshem nuk do te ndertohet apo modernizohet ne menyre te tille qe dheu i germuar dhe mbetjet nga ndertimet te trajtohen, ne menyre qe shumica e tyre te riperdoret ne nje kantier ndertimi te infrastruktures apo te riciklohet ne materiale ndertimi. Nderhyrjet infrastrukture te paplanifikuara, projektet e menaxhimit te mbetjeve apo te rastit, pengojne gjithashtu perdorimin e sasive te medha te materialeve te ndertimit te prodhuara nga riciklimi i ketyre materialeve ne kantieret e tjera te ndertimit apo nga perpunimi i llojeve te tjera te mbetjeve te cilat perdoren per te prodhuar materiale ndertimi te cilesise se njejte me materialet e ndertimit qe merren direkt nga burimet minerale natyrore.

7.2 Ajri

Ne qofte se Strategjia Kombetare e Sektorit te Furnizimit me Uje dhe Kanalizimeve nuk miratohet, projektet e Furnizimit me Uje dhe Kanalizimeve dhe infrastruktura e tyre nuk do te planifikohet dhe rregullohet ne menyre qe te eliminoje ndikimet negative dhe jo vetem dhe ne infrastrukture me barre me te vogel ndaj mjedisit, duke marre parasysh rritjen e ekonomike dhe infrastrukturore. Mungesa e investimeve ne sektorin e Sektorit te Furnizimit me Uje dhe Kanalizimeve do te thote se shumica e skenarit "Mos bej asgje" lidhur me rritjen e parashikuar te projekteve per Furnizimin me Uje dhe Kanalizimeve jo miqesore me mjedisin do te ndikojte

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

ne ndotjen e ajrit te mjedisit per shkak te emetimeve te substancave ne ajer nga ujrat e pa trajtuara, te cilat eutrofikohen.

7.3 Faktoret klimaterike

PERSHTATJA NDAJ NDRYSHIMEVE KLIMATIKE

Ne qofte se Strategjia Kombetare e Sektorit te Furnizimit me Uje dhe Kanalizimeve nuk miratohet, zbatimi i masave per te reduktuar ndjeshmerine e sektorit te te Furnizimit me Uje dhe Kanalizimeve ndaj ndryshimeve klimatike nuk do te trajtohet ne menyre sistematike gjate planifikimit dhe rregullimit te sistemit te menaxhimit te integruar te komponenteve te mjedisit dhe jo vetem. Çdo ndertim i ri apo rikonstrukcion i projekteve te Furnizimit me Uje dhe Kanalizimeve duhet te analizohet ne lidhje me ndjeshmerine e tij ndaj fenomeneve ekstreme te motit, ndersa kostot financiare te demtimit te mundshem te infrastruktures duhet te vleresohen paraprakisht. Bazuar ne analizen e ndjeshmerise se sektorit te te Furnizimit me Uje dhe Kanalizimeve ndaj fenomeneve ekstreme te motit, duhet te planifikohen masa te qendrueshme per te reduktuar efektet negative te ndryshimeve klimatike ne infrastrukturen e te Furnizimit me Uje dhe Kanalizimeve ne nivele ekonomikisht dhe shoqerisht te pranueshme.

7.4 Uji

Ne qofte se Strategjia Kombetare e Sektorit te Furnizimit me Uje dhe Kanalizimeve nuk miratohet, sektori i Furnizimit me Uje dhe Kanalizimeve dhe politika perkatese nuk do te planifikohet dhe rregullohet ne menyre gjithepershires. Infrastruktura e menaxhimit per mbrojtjen e komponenteve mjedisore nuk do te rikonstruktohet apo ndertohet mbi bazen e nje analize te nevojave dhe mundesive. Prandaj, ndertimi i projekteve dhe infrastruktures se re per Furnizimin me Uje dhe Kanalizimet mund te mos marre ne konsiderate karakteristikat ekzistuese natyrore (siperfaqet mbrojtese, pershkueshmerine e tokes dhe ndikimin ne cilesine e ujerave nentokesore, etj).

7.5 Biodiversiteti natyror

Ka mundesi qe zbatimi i projekteve te propozuara, mund te kete efekte negative te perkohshme dhe te lokalizuara ne shendetin e njeriut. Efektet negative mund te perfshijne ne veçanti shqetesimet nga zhurmat dhe ndikimet ne cilesine e ajrit, dhe lidhen me, per shembull, levizjen e mjeteve dhe makinerive te punes. Veprimtaria ndertimore mund gjithashtu te ndikojte perkohesisht ne receptoret rekreative, gje qe mund te kete efekte indirekte negative ne shendetin e njeriut (duke ulur mundesite per aktivitete rekreative). Nderkohe qe potenciali per efekte te padeshirueshme ne shendetin e njeriut do te varet nga shkalla dhe lloji i propozimeve te ardhshme, si dhe nga vendndodhja e tyre (lidhur me distancen nga receptore e ndjeshem dhe situata aktuale mjedisore, si psh. cilesia e ajrit), punimet do te jene te perkohshme dhe ka te ngjare qe ndikimet do te menaxhohen / zbuten, aty ku eshte e mundur, duke perdorur praktikat me te mira. Si pasoje, asnje efekt negativ nuk pritet te jete i rendesishem.

Ne menyre indirekte, kjo strategji e Sektorit te Furnizimit me Uje dhe Kanalizimeve do te mbroje shendetin e njeriut duke siguruar menaxhim te mire dhe te sigurt te struktures se Sektorit te Furnizimit me Uje dhe Kanalizimeve, si ajo ekzistuese ashtu edhe propozimet per te ardhmen.

Strategjia Kombetare e Sektorit te Furnizimit me Uje dhe Kanalizimeve lidhet edhe me optimizimin e investimeve te fondeve ne dispozicion per te maksimizuar keshtu performancen e aseteve dhe per te siguruar kthimin maksimal te investimit, si dhe perfitimin e konsumatoreve nga ky investim. Keto perpjekje pritet te kontribuojne ne perballimin e sfides se menaxhimit te Sektorit te Furnizimit me Uje dhe Kanalizimeve, gje qe ka nje efekt pozitiv ne shendetin e njeriut, duke siguruar akses te barabarte tek burimet natyrore.

Menaxhimi i efekteve me te gjera mjedisore nga ndertimi dhe mirembajtja e sistemeve te grumbullimit, trajtimit dhe asgjesimit te mbetjeve te gjeneruara nga zhvillimi i Sektorit te Furnizimit me Uje dhe Kanalizimeve, te cilat mund te perfshijne faktore te tille si pluhuri, zhurma dhe aromat e pakendshme, do te ndihmojne ne minimizimin e shkarkimeve ne ajer dhe keshtu do te kete nje ndikim te rendesishem pozitiv.

Garantimi se zhvillimet e reja sigurojne nje sherbim te duhur ne kohe dhe cilesi nepemjet planifikimit ne nivel strategjik, investimit ne rrjetin e Furnizimit me Uje dhe Kanalizimeve, si

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

dhe lejimit të një hapësire të pershtatshme për të lehtësuar zhvillimin midis periudhave të investimit, do të mbroje shëndetin e njeriut dhe do të zvogelojë rrezikun, nepermjet minimizimit dhe mire menaxhimit të mbetjeve, duke rezultuar në një efekt të rëndësishëm pozitiv.

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse që paraqiten në kapitullin mëposhtë duhet të merren parasysh për të arritur objektivin mjedisor përkatës.

10.3 Uji

Ndikimet me të mëdha në këto fushë pritet nga zhvillimet e sektoreve kyç të lidhur me ujin, si edhe ato që mund të ndikojnë në cilësinë dhe funksionimin natyror të baseneve ujore. (në rastin konkret ujesjelles/kanalizimet, por edhe shërbimet dhe turizmi, shëndetësia, etj).

Ndikimet mbi ujërat sipërfaqësore, ujërat nëntokësore dhe burimet e ujit të pijshëm janë karakteristike të periudhës së ndërtimit ose rindërtimit të infrastrukurës dhe gjithashtu në vijim të operimit të sistemeve / rrjeteve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve edhe më tepër. Kjo në varesi respektive të sektoreve përkatës në lidhje me nevojën për përdorimin e ujit ose ndërveprimet me burimet dhe trupat natyrore ujore. Në shumicën e rasteve këto impakte krijohen si të limituara në mjedisin lokal, megjithatë në mjaft raste ndodh efekti kumulativ i impaktit dhe krijohen ngarkesa ndotëse të mëdha që ngrihen në nivel rajonal dhe disa herë edhe nderkufitar. Impaktet ndërtimore të infrastrukurës për ngritjen apo rehabilitimin e sistemeve/rrjeteve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve ngelen në përgjithësi afat-shkurter dhe të rikthyeshme (rasti për cilësinë e ujërave). Pas fazës ndërtimore, impaktet janë kryesisht me pak të përhapura, por të pakthyeshme (rasti për impaktin të morfologjisë së vijës ujore natyrore, kushteve hidrologjike, ruajtja e zonave). Impaktet e mesiperme mund të prodhojnë ndryshime në elementet cilësore për krijimin e statusit ekologjik të ujërave sipërfaqësore, që janë elementet biologjike, hidromorfologjike, mbështetës, kimike dhe fiziko-kimike dhe në statusin kimik të ujërave. Nëse udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse vëzhgohen, ndryshimet në elementet cilësore nuk do të kapërcejnë se tepërmi që të kërcënojnë arritjen e objektivave mjedisore.

Veprimet e sektoreve që ndikojnë në ujërat dhe objektivat mjedisore mbi ujërat përmbledhen si më poshtë:

- Pozicionimi i veprave të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve mund të ndikojë në mënyrë permanente të drejtperdrejtë ose indirekt në situatën hidrologjike në një zonë të caktuar duke sjellë edhe situatë ekomorfologjike mbi rrjedhën e ujit;
- Rrjedhja e vazhdueshme e substancave të rrezikshme që rezultojnë nga burime të ndryshme ndotëse të strukturave / sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve (ndikim në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe ato nëntokësore);
- Dërdhja e substancave të rrezikshme për shkak të ngjarjeve të jashtëzakonshme (impakt potencial direkt, në distancë të largët deri nderkufitar mbi cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore);

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

- Ndryshimet ne regjimin uJOR te ujrave nentokesore per shkak te nderhyrjeve infrastrukturore ne Sektorin e Furnizimit me Uje dhe Kanalizimeve (direkt ose ne distance);
- Pozicionimi i srukturave / sistemeve te furnizimit me uje dhe kanalizimeve ne zonat aquifere me ndjeshmeri te larte ose shume te larte mund te kene impakt negativ mbi burimet uJore ekzistuese dhe potenciale (direkt, indirekt, nderkufitar);
- Pozicionimi ne zonat e burimeve uJore te mbrojtura (ndikim lokal, potencialisht rajonal dhe nderkufitar).

Shqipëria ka aprovuar Ligjin Nr. 111/2012 “Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore” te ndyshuar dhe “Strategjine Kombetare Sektoriale per Furnizimin me Uje dhe Kanalizimet 2014-2040”. Midis te tjerave, keto dokumente percaktojne qe aktivitetet ne uje dhe tokat anash ujrave mund te kryhen vetem nese ato jane bazuar mbi planet e zhvillimit hapesinor dhe nuk mund te pozicionohen diku tjeter pa gjeneruar kosto te larta disproporcionale. Pozicionimi i ketyre aktiviteteve mund te ndikojne thelbesisht mbi statusin ekologjik te rrjedhave uJore dhe te pakesoje zonat e mbajtjes dhe impaktet kumulative mbi biodiversitetin e zones dhe sherbimet e ekosistemeve te zones.

Udhezimet e pergjithshme dhe masat zbutese qe paraqiten ne Kapitullin e meposhtem duhet te merren parasysh per te arritur objektivat mjedisore perkates.

10.4 Ndryshimet Klimatike

Nje sere aktivitetesh ndertimore te Sektorit te Furnizimit me Uje dhe Kanalizimeve dhe praktika sektoriale kane ndikim permanent (te pakthyeshem) mbi shkarkimet e gazeve sere (GHG), qe perbejne shkakun kryesor te ndryshimeve klimatike. Ndikimi ne ndryshimet klimatike eshte gjithashtu pasoje ne kushtet e motit dhe klimes qe po rriten çdo vit. Nje tjeter pasoje e temperaturave te larta globale jane ndryshimet ne modelimet e fenomeneve mesatare klimatike dhe ngjarjet me te shpeshta te kushteve ekstreme te motit (thatesira, permbytje, erozione, stuhi me breshër, vale te nxehta, temperatura te uleta me ngrica, etj.).

Vendimi 406/2009/KE percakton kontributin minimal te vendeve anetare te BE-se per te arritur detyrimin per zvogelimin e emetimit te gazeve ‘serre’ per periudhen nga 2013 deri ne 2020 per emetimet e gazeve ‘serre’ qe mbulohe nga ky vendim si dhe rregullat per arritjen e ketyre kontributeve dhe vleresimin e tyre.

Sfidat kryesore dhe prioritetet e prezantuara ne SKZHI II jane: (1) kompletimi i adoptimit dhe zbatimit te standarteve Evropiane mbi cilesine e ajrit urban dhe shkarkimeve ne ajer; (2) konsolidimi i Sistemit Kombetar te Monitorimit sipas standarteve Evropiane; dhe (3) adoptimi e zbatimi i planeve te veprimit mbi cilesine e ajrit ne nivel lokal. Per me teper, SKZHI-II percakton kufijte e synuar per emetimet e gazeve ‘serre’ ne 2020 si me poshte:

- Nje reduktim i synuar prej 8% i GHG-ve krahasuar me skenarin baze; dhe
- Nje reduktim i synuar prej 40% ne sasine e HCFC-ve (hidroklorfluorkarbonit).

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

Si rezultat i ndryshimi të temperaturës dhe regjimit të reshjeve, janë parashikuar ndikimet e mëposhtme:

- Rritja e temperaturave minimale ditore me shumë se ato maksimale ka të ngjare të ndodhe në të gjitha zonat e tokës
- Thatesira të shpeshta të gjata dhe me rrezik të madh zjarri janë të mundshme.
- Numri i diteve me temperaturë mbi 35°C është parashikuar të rritet mesatarisht 10 dite në vit deri 2100. Si pasojë e kësaj, numri i valeve të nxehta dhe i diteve me temperaturë të ftohtë janë parashikuar gjithashtu të rriten.
- Ditët e fresketa dhe valet e ftohta janë shumë të mundshme të zvogelohen. Dimerat e ngrohjeve do të reduktojnë kërkesën e energjisë për ngrohje.
- Një rritje e numrit të diteve me shira të rrembyeshëm që shkaktojnë permbytje deri në 2100.
- Temperaturat e rritura të pranverës do të rrisin temperaturën e tokës, të mbjellat e verës në zonat e pershtatshme do të zgjasin periudhën e rritjes. Zgjatja e periudhës së rritjes është parashikuar të rritet me 26 ditë krahasuar me 1990.
- Si rezultat i reduktimit të reshjeve totale vjetore, zonat bregdetare mund të përjetojnë një rënie të përgjithshme. Kërkesa për ujë mund të rritet, veçanërisht në verë.
- Deri në vitin 2100 kushtet që do të jenë më të mira për turistët do të zgjerohen. Në verë kushtet do të ndryshojnë nga ideat në të shkelqyeshme.

Në nivelin strategjik të zhvillimit të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, aktivitetet e lidhura me ndryshimet klimatike mund të trajtohen si të përgjithshme. Para hartimit dhe zbatimit të çdo aktiviteti individual, është e nevojshme të përcaktohen udhëzime specifike, metodologji dhe procedura për mbledhjen e informacionit mbi ngjarjet ekstreme të motit, si dhe për planifikimin dhe zbatimin e aktivitetit përkatës.

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse që paraqiten në Kapitullin e mëposhtëm duhet të merren parasysh për të arritur objektivin mjedisor përkatës.

10.5 Toka

Ndikimet që lidhen me menaxhimin dhe përdorimin e qendrueshëm të tokës

Ndikimi më i madh gjatë fazës së ndertimit pritet të zhvillohet dhe të parashikohet në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, megjithatë në shumicën e rasteve këto zhvillime do të jenë të kufizuara në një territor me të ngushtë lokal.

Përmes okupimit të tokës, ndertimet e parashikuara për Sektorin e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve dhe infrastrukturen e tyre ndihmëse prodhojnë ndikime të gjera të pakthyeshme, që reflektohen pas zhvillimit si një ndryshim në përdorimin e tokës. Toka bujqësore dhe pyjet do të pësonin shkatërrim të pakthyeshem në seksionet e marra nga ndertimet e reja ose ato të rindërtuara mbi seksionet e vjetra. Shpesh ndertimet e reja krijojnë edhe fragmentime të tokës bujqësore. Ndikimet afatshkurtra (të riparueshme) që mund të ndodhin gjatë fazës së

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

ndertimit përfshijne lidhjet përmes tokave bujqesore ose pyjore, demtimet dhe okupimet e tokave ose demtimin e produkteve për shkak të afersise me sheshet e ndertimit, ndotjet e tokes etj.

Për shkak të zhvillimeve të reja në infrastrukture në lidhje me rrjetet e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, përdorimi i tokës bujqesore ekzistuese pëson ndryshim nga ana e pozicionimit të lidhjeve të reja infrastrukturorë. Masat që zbatohen mund të sjellin rënie të përhershme të potencialit dhe prodhimtarisë së tokës bujqesore, që nënkupton humbjen e përhershme të funksionimit të tokës për prodhimtarinë bujqesore. Nëse masat e infrastruktures shtrihen edhe përtej territoreve aktuale të zhvillimit, fragmentimi i tokës bujqesore do të rritet dhe kushtet për prodhimtarinë bujqesore do të përkeqësohen edhe më tej.

Pozicionimi i zhvillimeve të reja të rrjeteve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve dhe infrastrukturorë në zona të hapura apo të mbrojtura nga këndvështrimi i biodiversitetit, do të sjellin ndërhyrje direkte në zonat e vazhdueshme pyjore, funksioni primar i të cilave është prodhimi i drurit, si dhe në zonat e mbrojtura (demtime të pakthyeshme).

Ndikimet që lidhen me shfrytëzimin e burimeve natyrore

Aktivitetet ndërtimore në përgjithësi (rindertime ose të reja) janë burim i prodhimit të sasive të mëdha të mbetjeve dhe gjithashtu krijojnë presione mbi përdorimin e burimeve natyrore. Mbetjet gjenerohen jo vetëm përkohezisht gjatë fazës së ndertimit, por edhe në mënyrë të vazhdueshme gjatë fazës operacionale, si edhe për efekt të proceseve të mirëmbajtjes së strukturave. Impakti nga gjenerimi i mbetjeve ndërtimore është i përhershëm dhe në mjaft raste i pakthyeshem në lidhje me impaktin ndaj burimeve natyrore. Prandaj, ky impakt negativ ndaj mjedisit duhet të pakesohet me anë të masave për menaxhimin e mbetjeve.

Duke konsideruar mënyrën sesi gjenerohen dhe llojin e strukturës, sasitë e mbetjeve të gjeneruara nga zhvillimet në infrastrukture në nivel lokal priten të jenë më të lokalizuara dhe më lehtësisht të menaxhueshme.

Ndertimet e reja ose rehabilitimi i instalimeve ekzistuese sipas kategorive të rrjeteve /sistemeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve dhe mënyrës së menaxhimit të tyre, brenda kuadrit të zbatimit të masave specifike të angazhimeve për secilin nga drejtimet e veprimeve prioritare respektive të Strategjisë/Planit, ofrojnë një mundësi ideale gjatë fazës së ndertimit për ripërdorimin ose procesimin e materialeve dhe mbetjeve industriale të prodhuara, ku efekti i sinergjisë reflektohet veçanërisht në faktet e mëposhtme:

- Sasira të mëdha mbetjesh mund të përdoren veçanërisht në ndertimet e rrugëve dhe infrastrukturave të ngjashme ku materialet mbushese janë mjaft të nevojshme;
- Substanca potenciale toksike të mbetjeve mund të imobilizohen në mënyrë permanente në rast se ato përdoren në mënyrën e duhur; dhe
- Kompozitë të reja të ndertimit shpesh kanë karakteristika më të mira funksionale në krahasim me ato konvencionale.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

Ne vijim te zbatimit te masave specilike qe paraqiten ne strategji, administrimi ekonomik i burimeve natyrore duhet te mbeshtetet nga masa te tjera te pergjithshme shtese qe promovojne pakesimin e ndotjes se mjedisit duke perdorur materiale te riciklueshme ne ndertimin dhe rindertimin e infrastruktures se parashikuar per çdo sektor. Prandaj, masa te tilla duhet te pergatiten dhe te perfshihen qe ne fazat e hershme per çdo projekt me vete.

Udhëzimet e pergjithshme dhe masat zbutese qe paraqiten ne Kapitullin me poshte duhet te merren parasysh per te arritur objektivin mjedisor perkates.

10.6 Trashegimia Kulturore

Ndikimet e aktiviteteve te parashikuara, mbi mjedisin historik do te jene kryesisht ne asetet e prekshme siç jane ndertesat, monumentet dhe peizazhet, megjithese, potencialisht mund te shkaktohen disa ndikime ne zonat arkeologjike nentokesore. Pjesa me e madhe e ndikimeve te mundshme ne ambientin historik jane shume specifike per nje zone te caktuar, dhe natyra e ndikimit varet pothuajse teresisht nga pozicionimi i zones historike dhe i zones nderhyrjes infrastrukture per ndertimin e rrjeteve te shperndarjes se ujit te pijshem dhe sistemit te kanalizimeve. Ketu perfshihen ndikimet qe shkaktohen nga zhurma, pluhuri, ndikimet hidrologjike dhe levizjet e automjeteve.

Zhvillimet e sektorit te Furnizimit me Uje dhe Kanalizimeve dhe infrastruktures qe shoqeron ate mund te krijojne impakte direkte ne njesi dhe zona te trashegimise kulturore gjate fazes se ndertimit dhe me tej te operimit si rezultat i efekteve te meposhtme:

- Degradimi i veçorive te peizazhit perreth njesive te trashegimise kulturore (impakt indirekt, i pakthyeshem);
- Demtimi i strukturave te trashegimise kulturore (impakt direkt, i pakthyeshem);
- Shkaterrim i mbetjeve arkeologjike gjate fazes se ndertimit (impakt direkt, lokal, i pakthyeshem);
- Vibrime qe mund te shkaktojne demtime te strukturave te trashegimise kulturore (impakt indirekt, i pakthyeshem);
- Çlirime gazrash ndotes qe bejne pjese ne kontribuimin e shirave acid dhe qe shkaktojne demtime te strukturave te trashegimise (impakt indirekt, kumulativ, ne distance).

Duke qene se Shqipëria ka nje diversitet te madh te trashegimise kulturore, ne terma kompozimi dhe shperndarjeje ne te gjithe vendin, ka te ngjare qe ndertimet e reja te infrastruktures do te perzihen ne keto zona, veçanerisht me peizazhin kulturor, peizazhin historik, trashegimine arkitekturore dhe zonat e tyre te influences si edhe pikat arkeologjike. Pozicionimi i infrastruktures do te ndryshoje ne menyre permanente perdorimin e hapësirës ne keto zona. Per kete, duhet te zbatohen masa te pershtatshme per te ruajtur veçorite e zones se trashegimise kulturore.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

Nga aspekti i ruajtjes së mbetjeve arkeologjike, aktivitetet në mjedis konsiderohen akte destruktive (psh germimet). Do të duhet të kryhen kërkime paraprake arkeologjike në plan të gjere, rezultatet e të cilave do të duhet të merren në konsideratë kur të pozicionohen strukturat e infrastruktures të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, nderkohe që do të duhet të zbatohen edhe masat për të ruajtur mbetjet arkeologjike.

Gjithsesi mund të theksojmë faktin se mire-menaxhimi i sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve do të sjellë në reduktimin e kosniderueshem të tyre në mjedis dhe zonat urbane dhe me rendesi të vecante kulturore, gjë që do të shtojë vlerat e këtyre zonave.

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutese që paraqiten në Kapitullin më poshtë duhet të merren parasysh për të arritur objektivin mjedisor perkates.

10.7 Peizazhi

Percaktimi i ndikimit mbi cilesinë e peizazhit, buron kryesisht nga veçoritë vizive të hapësirës dhe nga elementet karakteristike të peizazhit që janë të pranishme në këto hapësire. Peizazhi cenohet me shumë nga projektet e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve dhe infrastruktura që i shoqëron ato që shtrihet në zona të hapura, ku impaktet janë më të dukshme për shkak të një niveli të lartë shtrirjeje (impakte të perhershme, të pakthyeshme). Ndikimi është veçanërisht i lartë në rastin e një nderhyrjeje infrastrukturore për ngritjen e strukturave / sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në zona me peizazh të jashtëzakonshëm, apo me tipare të veçanta, si dhe në zona peizazhistike me elemente natyrore të mbrojtur, të cilët mbartin një kuptim të rëndësishëm simbolik.

Ndikimet mbi veçoritë peizazhistike të zonave mund të perkufizohen si direkte, kumulative, indirekte dhe të dobëta. Strukturat e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve dhe infrastrukturore që i shoqëron ato në hapësirë, behen elemente të peizazhit dhe pjesë perberese e tij. Kështu që, sistemimi i këtyre strukturave duhet të behet në përputhje me tipologjinë ekzistuese të peizazhit. Marrja në konsideratë e veçorive natyrore dhe topografisë së zonës ku parashikohet të zhvillohet një projekt i caktuar, do të reduktojë fragmentimin e peizazhit.

Gjithsesi mund të theksojmë faktin se mire-menaxhimi i sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve do të sjellë në reduktimin e kosniderueshem të tyre në mjedis me rendesi të vecante peizazhistike, gjë që do të shtojë vlerat e këtyre zonave.

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutese që paraqiten në Kapitullin më poshtë duhet të merren parasysh për të arritur objektivin mjedisor perkates.

10.8 Impaktet Kumulative të Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve

Impaktet kumulative të Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve (si dhe nderveprimi e saj me planet dhe programet e tjera) janë vlerësuar cilesisht duke u bazuar në vlerësimet individuale të qelimeve dhe projekteve të ardhshme të këtyre

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

dokumenti stategjik. Ne menyre te domosdoshme, ka disa paqartesi, duke pasur parasysh natyren strategjike te vleresimit; megjithate, gjykimi yne me i mire tregon se shumica e OM do te perjetojne ndikime pozitive si rezultat i zbatimit te objektivave te perfshira ne strategji.

Gjate vleresimit nuk jane identifikuar impakte negative kumulative te rendesishme. Impakte negative te vogla ne disa OM, kryesisht per shkarkimet ne ajer, mund te lindin si rezultat i zbatimit te Strategjise Kombetare te Sektorit te Furnizimit me Uje. Ne kete drejtim, potenciali per impakte negative eshte identifikuar ne lidhje me OM qe kane te bejne me Biodiversitetin; Popullsine dhe Shendetin e Njeriut; Cilesine dhe Sasine e Ujit; Faktoret Klimatike; Token; dhe Peizazhin (impaktet e mundshme mbi Trashegimine Kulturore konsiderohen te pasigurta ne kete faze).

Siç eshte permendur me lart, **permiresimi i infrastruktures ekzistuese dhe sigurimi i infrastruktures dhe sherbimeve te identifikuara ne fazat e zbatimit pritet te krijoje perfitime mjedisore afatgjata.** Njesoj si llojet e tjera te zhvillimit, ndertimi i infrastruktures se re te Furnizimit me Uje dhe Kanalizimeve mund te kete impakte te demshme mjedisore afatshkurtra dhe lokale per shkak te, per shembull, marrjes se tokes, emetimeve ne ajer dhe shqetesimit e krijuara. Probabiliteti/madhesia e impakteve i nenshtrohet numrit, llojit, shkalles dhe vendndodhjes se projekteve te propozuara, si dhe ndjeshmerise se mjedisese pritesa.

Pavaresisht nga kjo, pritet qe potencialet per impaktet e pafavorshme mjedisore te identifikohen dhe, kur eshte e mundur, te adresohen gjate pergatitjes se projekteve te detajuara sipas fazave te zbatimit dhe permes vleresimit adekuat te projekteve perkatese. Sipas fazave te zbatimit te projekteve te propozuara, ndikimet mjedisore do te konsiderohen si pjese e procesit te aplikimit per leje mjedisore (qe mund te kerkoje Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis (VNM) dhe Vleresimin Teknik ne varesi te shkalles, vendit dhe natyres se zhvillimit te propozuar).

Nevojitet integrim i metejshem i zbatimit te strategjiseme planet sektoriale, vendore dhe me planet e menaxhimit qe zbatohen per Zonat e Mbrojtura, me qellim zbatimin e masave dhe proceduave te parashikuara nga VSM-ja dhe VNM-te specifike ne vijim.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

11 MASAT ZBUTESE

Ky seksion percakton udhezimet dhe masat zbutese per te siguruar arritjen e objektivave te rendesishem mjedisore ne fushat e vecanta. Duke zbatuar udhezimet e pergjithshme dhe masat zbutese, ndikimet negative te pershkrura me siper do te parandalohen dhe do te sigurohet arritja e objektivave mjedisore.

Eshte e rendesishme te theksohet se lista e masave zbutese e dhene me poshte nuk eshte shteruese. Masa me te detajuara ne aspektin e permbajtjes dhe analizes do te duhet te pergatiten si pjese e VNM- ve individuale per çdo projekt te arshem qe do te rrjedhe nga kjo strategji.

Ne percaktimin e masave lehtesuese per te zvogeluar ndikimet negative te mundshme direkte dhe/ose indirekte qe rrjedhin nga aktivitetet dhe strukturat e Furnizimit me Uje dhe Kanalizimeve ne territorin e Republike se Shqiperise, eshte perdorur shkalla e meposhtme hierarkike:

- Parandalimi i ndikimeve sa me shume qe te jete e mundur duke hartuar ose duke perdorur masa parandaluese;
- Reduktimi i ndikimeve sa me shume te jete e mundur duke perdorur masa parandaluese per te minimizuar efektet;
- Kompensimi i ndikimeve per efektet e pashmangshme qe nuk mund te reduktohen me tej;
- Fuqizimi i efekteve per te identifikuar mundesite se si mund te perfshihet permiresimi ne skemat ku efektet jane neutralizuar.

Ndikimet negative te lokalizuara lidhen me planifikimin, ndertimin dhe funksionimin e projekteve te Furnizimit me Uje dhe Kanalizimeve apo trajtimin e mbetjeve inerte ne territorin e Republikes se Shqiperise, te cilat perfshijne zenien e tokes, ndikimet mbi biodiversitetin, popullsine dhe shendetin, shfrytezimin e burimeve, trashegimine kulturore, peizazhin etj. Zbutja e ketyre ndikimeve negative ne rrethana te tilla duhet te merret ne konsiderate nga autoritetet perkatese gjate punes per perzgjedhjen e vendit ku do te pozicionohen strukturat / sistemet e furnizimit me uje dhe kanalizimeve. Kur zbutja e ndikimeve negative nuk eshte e mundur, duhet te zbatohen permiresimet kompensuese siç jane restaurimi i habitateve dhe masat e tjera kompensuese.

Zbutja e ndikimeve operacionale duke perfshire ndikimet ne cilesine e mjedisit, burimet ujore dhe ndotjen e tokes duhet te trajtohen si rezultat i kushteve planifikuese/mjedisore brenda lejeve specifike. Kushte te tilla duhet te jene mjaft te rrepta per te zbutur ndikimet ne sektore te ndryshem mjedisore.

11.1 Biodiversiteti

Udhezimet e pergjithshme dhe masat zbutese per te arritur Objektivin Mjedisor

Si udhezim i pergjithshem theksohet nevoja per konsultime te hershme me Ministrine e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) dhe agjencine e saj te mjedisit dhe zonave te mbrojtura. Kjo

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

është veçanërisht e rëndësishme kur planifikohen struktura të reja dhe eliminon ato praktika, të cilat në të kaluarën kanë rezultuar me ndikime të pakthyeshme në zonat e mbrojtura dhe me shkelje të legjislativitetit.

Për të ruajtur në mënyrë të përhershme mjedisin natyror dhe biodiversitetin, duhet të merren parasysh masat e mëposhtme:

- Shfrytëzimi i infrastruktures ekzistuese ka përparësi mbi ndërtimin e infrastruktures së re të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve;
- Nëse aktivitetet në mjedisin e paprekur nuk mund të shmangen, duhet të shmangen aktivitetet në zonat e mbrojtura, zonat me rëndësi mjedisore dhe zonat me karakteristika të çmuara natyrore;
- Prioritet duhet t'i jepet varianteve me më pak ndikim në rruget e migrimit të kafshëve të egra (variante të cilat kalojnë me shumë neper tunele dhe variante të cilat ndërpresin më pak rruget e migrimit);
- Duhet të sigurohen pasazhe të përshtatshme për kafshët e egra, gjë që është në përputhje me praktikën me të mira evropiane. Para se të planifikohet çdo ndërtim i ri, duhet të kryhet një studim apo të përmbledhen rezultatet e studimeve ekzistuese, të cilat do të lehtësojnë integrimin në mënyrë të përshtatshme të një strukture të caktuar në një vend (formen, madhësinë, dhe sistemin e objektit dhe rrethinave të tij). Projektet duhet gjithashtu të parashikojnë pasazhe për kafshët e vogla (amfibet, gjitarët e vegjël, zvarranikeve) në baze të studimeve ekzistuese ose, nëse është e nevojshme, hulumtimeve shtesë.

Në integrimin hapësor të infrastruktures së parashikuar, duhet të shmangët ndërhyrja e projekteve në zonat me karakteristika të çmuara natyrore. Shqyrtimi i udhëzimit do të lehtësojë ruajtjen e llojeve dhe karakteristikave të vlefshme natyrore.

Në integrimin hapësor të infrastruktures të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve së parashikuar, duhet të shmangët ndërhyrja e projekteve në zonat e mbrojtura. Nëse aktivitetet në zona të tilla nuk mund të shmangen, dhe nëse kjo është e lejuar në baze të aktit për mbrojtjen e një zone të caktuar, duhet të merren parasysh udhëzimet, bazat dhe kushtet për ruajtjen e zonave të mbrojtura të natyrës të cilat janë në regjim mbrojtjeje, të miratuar me aktet për mbrojtjen. Shqyrtimi i udhëzimit do të lehtësojë mbrojtjen e zonave të mbrojtura.

Në integrimin hapësor të infrastruktures të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve së parashikuar, ndërhyrja e projekteve në zonat e Natura 2000 duhet të shmangët. Shqyrtimi i udhëzimit do të lehtësojë mbrojtjen e lidhjes dhe integrimin të zonave të Natura 2000.

Periudha për zbatimin e projekteve duhet të rregullohet sipas cikleve jetësore të kafshëve dhe bimëve, dmth:

- duke iu përshtatur kafshëve pa apo me aktivitetet me një shtrirje në një masë të vogël, që perkon me periudhën kur kafshët kanë nevojë për qetësi, ose nuk mund të levizin larg, sidomos gjatë periudhës së riprodhimit, shumimit, rritjes, dhe dimerimit;

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

- duke ju pershtatur bimeve duke lehtësuar prodhimin e fares, mbjelljen natyrore dhe format e tjera të riprodhimit.

Respektimi i masës do të zvogëlojë shqetësimet për ciklet e jetës së kafshëve dhe bimeve dhe do të rrisë probabilitetin për të arritur apo ruajtur një gjendje të favorshme të popullatave. Mundësitë e arritjes së objektivit për ruajtjen e biodiversitetit do të jenë më të larta.

Ne përputhje me objektivin e SKZHI II "*nje rritje e synuar të 17% e sipërfaqes së Zonave të Mbrojtura të territorit nëpërmjet përmirësimit dhe menaxhimit të integruar të zonave të mbrojtura*" sipërfaqja e zonave të mbrojtura pritet të rritet. Prandaj, nderhyrja hapësimore e infrastruktures së parashikuar në zonat e propozuara për mbrojtje duhet të shmangët për të parandaluar konfliktet e mundshme dhe ndikimet negative në arritjen e objektivave mjedisore të ruajtjes së natyrës.

Sa më shumë që të jete e mundur, infrastruktura e re nuk duhet të nderhyjë në zona ku ndikohet në mënyrë të konsiderueshme statusi ekologjik i rrjedhave ujore, për të zvogëluar basenet mbrojtëse ujore, dhe për të prodhuar ndikime kumulative mbi biodiversitetin dhe shërbimet e ekosistemeve të zonave të caktuara. Në rastet e përjashtimeve, kjo duhet të bëhet e mundur vetëm në bazë të argumentimit të ekspertëve, duke deklaruar se elementi i infrastruktures nuk mund të integrohet në vende të tjera pa shpenzime jashtëzakonisht të larta. Në llogaritjen e ketyre shpenzimeve duhet të përfshihen edhe kostot që vijnë si pasojë e pakesimit të shërbimeve që vijnë nga ekosistemi. Shqyrtimi i udhëzimit të lartpërmendur do të bëjë llogaritjen e kostove më të saktë dhe në mënyrë të balancuar sic duhet.

Është e rëndësishme të garantohet që shërbime të reja sipas kërkesës, si dhe lehtësia e përdorimit dhe disponueshmëria e tij, të komunikohen në mënyrë të qartë dhe efektive për të gjithë aktorët e komunitetit, me qëllim të rritjes së ndergjegjesimit dhe garantimit të sistemit do të mirëpërdoret, duke reduktuar incidentet eventuale.

Masa Zbutese Specifike

Projektet duhet të plotësohen me detyrën për të mbrojtur në mënyrë më adekuate llojet e veçanta të kafshëve prej rreziqeve që vijnë si pasojë e ndërtimit të infrastruktures së re. Duhet të zbatohet masa zbutese specifike: ***Sigurimi i korridoreve të migrimit dhe siguria e kafshëve.*** Përbajtja e kesaj mase duhet të jete si më poshtë:

- Te ulet fragmentimi i habitateve të llojeve, duke krijuar pasazhe për kafshët e egra në linjat ekzistuese të lëvizjes (veçanërisht për gjitarët dhe amfibet). Për këtë qëllim, fillimisht, duhet të kryhet një studim apo të përmbledhen të dhënat nga monitorimet ekzistuese rreth vdekshmërisë së kafshëve të egra në rrugë. Pastaj, bazuar në gjetjet e studimit, do të krijohen lehtësira për migrimin e kafshëve të egra. Në kuadrin e kesaj mase, do të përgatitet një listë prioritare e zonave 'të zeza' ku kafshët rrezikohen më shumë dhe në këto zona do të zbatohen masat zbutese përkatëse (sisemim të vendkalimeve, gardhe anësore etj.). Gjithashtu kjo gje ndikon pozitivisht në përmirësimin e sigurisë së trafikut;

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

- Ne zonat ku planifikohet infrastruktura e re e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, duhet të sigurohet ruajtja e rrugëve ekzistuese të migritit, duke ndertuar strukturat e duhura dhe duke kryer gjithë sistemimet e tjera për të parandaluar levizjen e kafshëve të egra (sidomos mishngrenesve, drereve, lakuriqve të nates dhe amfibeve). Për nevojat e planifikimit, do të përgatitet në fazën e parë një studim (ose nëse është e mundur do të përmbledhen rezultatet e studimeve tashme të kryera), i cili do të përfshijë të dhëna për speciet, migrimin dhe cilat do të preket nga aktiviteti, si dhe udhëzime për projektuesin që do të planifikojë objektin apo nderhyrjen (vendndodhja, forma, madhësia, gjelberimi i objektit dhe rrethinave, etj);

Keto masa do të lehtësojnë lidhjet mes habitateve (rivendosin apo ruajnë rruget e migritit) të specieve dhe arrijnë objektivat mjedisore që lidhen me mbrojtjen e natyrës.

11.2 Popullsia dhe Shëndeti i Njeriut

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor

Lidhur me këto tematike propozohen masa zbutëse si më poshtë:

- Të parashtrihen formulime specifike në lidhje me shmangien e efekteve të demshme në shëndetin e njeriut si rezultat i përmirësimit / ndërtimit të infrastrukurës së re të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve. Nga ana tjetër, ky angazhim mund të bëhet si pjesë e çdo iniciative ligjore /rregullatore.
- Garantimi që angazhimet e forta për mbrojtjen e shëndetit të njeriut të bëhen përmes komponenteve të ligjore dhe rregullatore në fushën e shëndetit publik.
- Aty ku është e mundur, propozimet e ardhshme duhet të pozicionohen në mënyrë të tillë që të minimizojnë potencialin për efekte të padëshirueshme në receptoret njerezore.
- Duhet të jepet një specifikim më i madh për mënyrën se si identifikohen, karakterizohen dhe priorizohen rreziqet.
- Mundësia që aktivitetet e ndërtimit të gjenerojnë efekte negative në shëndetin e njeriut duhet të menaxhohet / zvogelohet, aty ku është e mundur, duke përdorur praktikën me të mira.
- Në fazën e projektimit mund të kërkojnë skema planesh zbutëse specifike që lidhen me parashikimet e investimeve kapitale, për të siguruar që çdo efekt negativ mbi receptoret e ndjeshme të shmangen ose minimizohen, duke marrë masa që përfshijnë: njoftimin e hershëm për të ndihmuar planifikimin, periudhën dhe kohezgjatjen e aktivitetëve, ngjeshjen e pluhurit dhe larjen e dheut, përdorimin e barrierave të perkohshme vizuale dhe akustike, si dhe sigurimi i rrugëve alternative për çdo levizje shoqërore të automjeteve (duke përfshirë shqyrtimin e kohës dhe frekuencën e levizjeve dhe nivelet ekzistuese të ngarkesës së trafikut).

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

- Strategjia per Adaptimin dhe Zbutjen e Ndryshimeve Klimatike duhet te perfshije objektiva per reduktimin e mbetjeve dhe çlirimin e gazrave serre.
- Perfshirja e strategjive qe lidhen me shmangien e efekteve te demshme ne shendetin e njeriut, ne peraftrimet, zgjidhjet dhe projektet e propozuara.

11.3 Uji

Udhezimet e pergjithshme dhe masat zbutese per te arritur Objektivat Mjedisore

Ne menyre qe te kufizohen efektet e presionit qe do te ushtroje infrastruktura e parashikuar ne burimet ujore dhe keshtu te parandalohen ndikimet negative ne cilesine e ujit (sidomos ujit te pijshem), duhet te shmanget integrimi hapesinor i infrastruktures se re ne zonat e mbrojtura ujore.

Ne integrimin hapesinor te infrastruktures se re te Furnizimit me Uje dhe Kanalizimeve, eshte e nevojshme qe te shmanget integrimi i objekteve ne zonat ne rrezik nga erozioni. Ne rast te nderhyrjeve ne keto zona, duhet te provohet se niveli ekzistues i rrezikut ne zonen perreth nuk do te rritet. Udhezimi i lartpermendur duhet te merret parasysh ne menyre qe te reduktoje presionin e infrastruktures se re ne zonat ne rrezik nga erozioni, dhe per te siguruar se niveli i rrezikut nga permbytjet ne zona te vecanta nuk do te rritet.

Kur planifikohen nderhyrjet ne zonat me rrezik jashtezakonisht te larte, shume te larte dhe te larte te akuifereve, eshte e nevojshme qe te studiohen dhe planifikohen zgjidhjet e duhura teknike per te parandaluar ndikimet negative gjate ndertimit dhe shfrytezimit, si dhe ne rastin e ngjarjeve te jashtezakonshme (p.sh. rrjedhjet e substancave te rrezikshme). Shqyrtimi i udhezimit te lartpermendur do te reduktoje probabilitetin e ndotjes nentokesore, duke siguruar ndikime te kufizuara te presionit te infrastruktures se re ne ujerat nentokesore.

Sa me shume qe te jete e mundur, infrastruktura e re nuk duhet te nderhyje ne zona ku ndikohet ne menyre te konsiderueshme statusi ekologjik i rrjedhave ujore. Aktivitetet e tilla mund te ndikojne ne menyre te konsiderueshme ne kete status, te zvogelojne basenet mbrojtese ujore, dhe te prodhojne ndikime kumulative mbi biodiversitetin e zones dhe sherbimet e ekosistemeve te zones. Ne rastet e perjashtimit te kesaj mase, kjo duhet te behet e mundur vetem ne baze te argumentimit te eksperteve, duke deklaruar se elementi i infrastruktures nuk mund te integrohet ne vende te tjera pa shpenzime jashtezakonisht te larta. Ne llogaritjen e ketyre shpenzimeve duhet te perfshihen edhe kostot qe vijne si pasoje e pakesimit te sherbimeve qe vijne nga ekosistemi. Shqyrtimi i udhezimit te lartpermendur do te beje llogaritjen e kostove me te sakte dhe te balancuar.

Ne menyre qe te zvogelohen ndjeshem ndikimet negative ne cilesine e ujerave, duhet te merren masat e meposhtme:

- te blihen pajisjet e duhura per t'u marre me derdhjet e substancave te rrezikshme ne rrjedhat ujore;
- te sigurohet qarkullimi i rrjedhave ujore dhe keshtu te parandalohet eutrofikimi permes planifikimit te duhur;

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

- te sistemohen shtreterit e lumenjve me ane te mbjelljes se pemeve pergjate argjinaturave ne forme gardhesh çifte, pas sistemimit te argjinaturave;
- fuqizimi i zbatimit te ligjeve e rregulloreve dhe ne rast shkeljeje, zbatimi i penaliteteve per subjektet qe shfrytezojne shtreterit e lumenjve per te marre materiale, si dhe lumenjte e liqenet per akuakulture, pa licencat perkatese, si dhe miratimi i nje plani te detajuar shfrytezimi.

Masa Zbutese Specifike

Ne rast se zbatimi i nje projekti do te ndikojte ndjeshem ne ndonje akuifer, gjate hartimit te dokumentacionit te projektit duhet bere edhe nje vleresim i demit ndaj ujerave nentokesore.

Ndikimet e ndotjes do te shmangen duke adoptuar praktikat me te mira te menaxhimit te punes ne terren, siç jane:

- Ambientet e magazinimit duhet te rrethohen dhe mbulohen per te parandaluar derdhje te ndryshme;
- Kur derdhjet nga kantieri duhet te shkarkohen ne nje lume, norma e derdhjeve duhet te kontrollohet, ne menyre qe ajo te mos shkaktojte permbytje lokale ne rrjedhen e ujit, apo erozioni;
- Ne rast se ka derdhje serioze te kimikateve apo lengjeve gjate ndertimit, kontraktori duhet te hartojte nje program te masave per ujerat siperfaqesore dhe nentokesore. Marrja e mostrave te ujerave nentokesore duhet te beje in situ matjen e pH, turbullires dhe percjellshmerise elektrike.

Te gjitha veprimet e kerkuara dhe, nese nevojiten, analizat, duhet te behen ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

11.4 Ndryshimet Klimatike

Udhezimet e pergjithshme dhe masat zbutese per te arritur Objektivin Mjedisor

Zbatimi i masave per te arritur objektivat e strategjise duhet te marre parasysh te ashtuquajturat objektiva indikative per te reduktuar emetimet e gazrave serre, te cilat jane te percaktuara deri ne vitin 2020 ne SKZHI II per Reduktimin e Emetimeve te Gazrave Serre. Ne kete kuder duhet mbajtur ne vemendje si me poshte:

- percaktimi i protokolleve dhe monitorimi i rasteve te trajtimit te semundjeve qe vijne si pasoje e ngjarjeve te motit;
- percaktimi i masave te emergjencave civile per te shmangur/zbutur ndikimet nga kushtet ekstreme te motit;
- percaktimi i kriterëve dhe politikave per futjen e teknologjive bashkekohore ne bujqesi si dhe praktikave me te mira te bujqesise organike;
- zbatimi i nje politike parkimi kufizuese ne zonat urbane; dhe

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

- integrimi i çeshtjeve të ndryshmeve klimatike në kuadrin politik dhe ligjor duke specifikuar institucionet dhe përgjegjësitë për identifikimin, zbatimin dhe monitorimin e masave zbutëse/përshtatëse ndaj ndikimeve të ndryshmeve klimatike.

Projektet për zbatimin e strategjisë duhet të hartohen në një mënyrë të tillë që të sigurojnë një përdorim efektiv të burimeve, që do të thotë se ndjeshmeria e infrastrukurës së parashikuar të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve ndaj ndryshimeve klimatike, fatkeqesive natyrore dhe fatkeqesive antropogjenike duhet të verëhet siç duhet. Kjo do të thotë se kur planifikohet infrastruktura, duhet të merren në konsideratë masa nga vlerësimet e rreziqeve, të cilat do të rrisin elasticitetin e infrastrukurës ndaj ndryshimeve klimatike në mënyrën e duhur, veçanërisht në lidhje me reshjet, përmblytjet, temperaturat e larta dhe valet e të nxehtë, thatësitat dhe stuhite. Në këtë kuader, është e nevojshme të:

- përgatitet një analizë e ndjeshmerisë së infrastrukurës së parashikuar të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve ndaj ndryshimeve klimatike;
- zbatohen masat dhe orientimet e bazuara në rezultatet e analizave të cilat përmirësojnë në mënyrën e duhur elasticitetin e infrastrukurës ndaj ndryshimeve klimatike.

Për të arritur objektivin mjedisor në lidhje me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, duhet të sigurohen si më poshtë:

- në terma afatgjatë, infrastruktura e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve duhet të jenë më pak e ndjeshme ndaj pasojave të reshjeve ekstreme (shirave, deborës, apo edhe ngricave);
- gjatë planifikimit të çdo ndërtimi të ri apo zgjerimi të strukturave ekzistuese të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, duhet të kryhet një analizë ndjeshmerie e infrastrukurës së parashikuar në kushtet ekstreme të motit, dhe në bazë të rezultateve të saj, duhet të përgatitet një plan masash për të reduktuar në mënyrë të përhershme pasojat e këtyre fenomeneve;
- zbatimi i masave për të reduktuar ndjeshmerinë e infrastrukurës ndaj kushteve ekstreme të motit duhet të bëhet një detyrë qendrore e menaxhimit të çdo lloji infrastrukture. Qëllimi i zbatimit të këtyre masave duhet të bazohet sidomos në reduktimin e demit të shkaktuar për përdoruesit e infrastrukurës së ndjeshme ndaj motit, nëse ata nuk mund ta përdorin atë;
- duhet të përcaktohen qartë udhëzimet për metodologjinë, procedurat dhe realizimin e mbledhjes së informacionit mbi kushtet ekstreme të motit, si dhe për planifikimin dhe zbatimin e masave për të reduktuar ndjeshmerinë e infrastrukurës së parashikuar ndaj kushtet ekstreme të motit.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

11.5 Toka

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutese për të arritur Objektivin Mjedisor

Duke zënë një territor të caktuar, ndertimi i infrastruktures së parashikuar do të shkaktojë ndikime të gjera të përhershme, të cilat do të pasqyrohen si një ndryshim në strukturën e përdorimit të tokës. Prandaj, kur planifikohet integrimi i infrastruktures së parashikuar në mjedis, duhet të garantohet menaxhimi i qëndrueshëm i tokës dhe mbrojtja e saj.

Aktivitetet në tokën bujqësore dhe pyjore duhet të reduktohen në nivelin më të ulët të mundshëm, dhe duhet t'i jepet prioritet i lartë planifikimit të aktiviteteve në tokë me potencial më të varfër të prodhimit, dhe tokë jashtë zonave të dendura pyjore apo zonave pyjore me funksione të rëndësishme të prodhimit të lëndës së parë të drurit. Me integrimin e infrastruktures së parashikuar në mjedis, përmirësimet brenda korridoreve apo strukturave ekzistuese kanë përparësi mbi ndertimet e reja. Infrastruktura e parashikuar duhet të planifikohet në atë mënyrë që mos të rritë probabilitetin e rreshqitjeve të tokës në zonën përreth aktiviteteve.

Për të siguruar përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, do të duhet që projektet e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve të plotësohen me udhëzime për të promovuar riciklimin dhe ripërdorimin e mbetjeve të ndertimit në ndertimin dhe rikonstruksionin e infrastruktures së re, dhe me e rëndësishmja, përdorimin e materialeve të certifikuara të ndertimit, prodhuar nga riciklimi i post-produkteve ose mbetjeve nga sektoret e tjera. Kur përdoren materiale ndertimi për infrastrukturen e re të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, të cilat nuk janë me origjinë primare natyrore, duhet të merret parasysh fakti se:

- kerkohen sasi më të mëdha të materialeve të ndertimit, kryesisht si mbushje;
- mobilizohen në mënyrë të përhershme disa substanca të rrezikshme nga materialet e mbetjeve;
- materialet e reja të ndertimit mund të kenë cilësi më të mira funksionale se materialet me origjinë natyrore.

Masa Zbutese Specifike

- **Punimet në dhera të ndotura**

- Gjate punimeve mund të zbulohen dhera të ndotura. Keto dhera duhen larguar. Pastaj duhet vendosur tokë artificiale me gjeomembranë, argjilë dhe shtresë plehu, mbi të cilën duhet të mbillet bar dhe pemë. Kjo tokë artificiale duhet të mbulojë edhe sipërfaqet e ndotura që nuk do të levizën.
- Të gjithë materialet ndotes (dherat dhe mbetjet) që do të largohen, duhet të depozitohen dhe propozohen në vende të caktuara ku duhet të jenë të izoluara nga ujërat nëntokësore.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

- **Riperdorimi i materialit te germuar**

- Materiali, i cili germohet nga prerja e seksioneve eshte nje burim natyral dhe perdorimi i tij ne baze te nje skeme do te maksimizohet duke perdorur teknika konstruktive te cilat intensifikojne ngjeshjen e materialeve per t'u perdorur si mbushje inxhinierike.
- Megjithate, pashmangshmerisht do te kete nje sasi te konsiderueshme materiali, i cili, per shkak te veçorive te tij fizike dhe strukturore, nuk eshte i pershtatshem per t'u perdorur si mbushje inxhinierike brenda skemes.
- Megjithate, ky material mund te jete i pershtatshem per aktivitetet e tjera, siç eshte krijimi i peizazhit, ku nuk aplikohen kërkesa kaq te rrepta strukturore. Riperdorimi i ketij materiali do te maksimizohet brenda projektit perkates, dhe çdo material i tepert do te transportohet jashte zones.

11.6 Trashëgimia Kulturore

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutese per te arritur Objektivin Mjedisor

Zhvillimi i infrastruktures se Furnizimit me Uje dhe Kanalizimeve mund te ndikojte te njesite dhe zonat kulturore, veçanerisht ne aspektin e degradimit te karakteristikave te peizazhit te rrethinave te njesive te trashëgimise kulturore, demtimit te objekteve te trashëgimise kulturore, si dhe shkatërrimit te mbetjeve arkeologjike nga vibrimet gjate ndertimit te strukturave te cilat mund te shkaktojne dëme ne objektet e trashëgimise kulturore. Per te shmangur keto ndikime, duhet te merren parasysh si me poshte:

- Prioritet eshte mos vendosja e infrastruktures se re (perfshire edhe rruget lidhese) ne zonat e trashëgimise kulturore. Duhet te ruhet sidomos integriteti dhe tiparet e peizazheve kulturore, zonave te ndikimit te trashëgimise arkitektonike dhe mbetjeve arkeologjike.
- Ne kuader te ruajtjes se mbetjeve arkeologjike dhe/ose zonave te trashëgimise kulturore, aktivitetet ne mjedis konsiderohen akte destruktive (p.sh. germimi). Do te duhet te kryhen hulumtime te shumta paraprake, rezultatet e te cilave do te duhet te merren parasysh kur te percaktohet vendosja e infrastruktures se propozuar te Furnizimit me Uje dhe Kanalizimeve. Gjithashtu do te duhet te zbatohen masat per te ruajtur mbetjet arkeologjike dhe/ose zonat e trashëgimise kulturore.
- Zbulimet e nje rendsie te madhe mund te kerkojne ndryshimin e puneve pergatitore (projektit) per nje detyre te veçante. Ne rast te zbulimit te gjetjeve apo mbetjeve arkeologjike, do te njoftohet menjehere autoriteti perkates. Zona me pas do te studiohet dhe mundesisht do te rrethohet; duke mos lejuar asnje zhvillim te metejsheem ne ate zone derisa çështja te zgjidhet sipas procedurave te percaktuara.
- Me integrimin e infrastruktures se parashikuar ne mjedis, permiresimet brenda korridoreve apo strukturave ekzistuese te Furnizimit me Uje dhe Kanalizimeve kane perparesi mbi ndertimet e reja.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

- E gjithë puna e ndertimit do të jetë e kufizuar brenda korridorit të punimeve. Në rast se nevojiten më shumë hapësira ose aktivitetë të lidhura me ndertimin jashtë korridorit të punimeve, do të informohen paraprakisht autoritetet përkatëse.

11.7 Peizazhi

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor

Gjate zgjedhjes dhe projektimit të detyrave të propozuara, konsiderate duhet t'i jepet shmangies së ndikimeve kudo që të jetë e mundur. Në këtë kuader, alternativa perfundimtare e miratuar për çdo projekt duhet të zgjidhet e tillë që të minimizojë ku të jetë e mundur ndikimin në karakteristikat e banimit, karakteristikat topografike, pemët dhe pyjet. Megjithatë, disa ndikime janë të pashmangshme, dhe masat e propozuara synojnë të zbutin natyrën negative të këtyre ndikimeve.

Për të siguruar ruajtjen e peizazheve të jashtëzakonshme, zonave të peizazheve me karakteristika të dallueshme në nivel lokal e kombëtar dhe një imazh të cilesive së lartë të peizazhit, duhet të ndiqen udhëzimet e mëposhtme:

- Nderhyrjet e infrastruktures së re të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve nuk duhet të integrohen në zonat e veçanta të peizazhit apo peizazheve me karakteristika të dallueshme në nivel lokal e kombëtar;
- Në integrimin hapësor të projekteve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve duhet të kerkohen vende jashtë zonave me peizazhe të vecante apo zonave me peizazhe me karakteristika të dallueshme në nivel lokal e kombëtar;
- Duhet të zbatohen masat e duhura teknike për të siguruar një imazh të cilesive së lartë të peizazhit, veçanërisht në rastin e aktivitetëve në njesitë e ruajtura apo të pasura kulturore të natyrës;
- Në integrimin e infrastruktures së parashikuar të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në mjedis, përmirësimet brenda korridoreve apo strukturave ekzistuese kanë përparësi mbi ndertimet e reja.

Në rastet kur projekti i mbivendoset ndonjë peizazhi ekzistues bujqësor apo rural, duhet të ndiqet një qasje ku synohet mbrojtja e vlerave rurale dhe rezidenciale dhe pasurimi i peizazhit përgjatë anëve të rrugëve. Objektivat e punimeve peizazhistike:

- Të zhvillohet një peizazh, karakteristikat e të cilit lidhen me modelin, shkallën dhe diversitetin e karakteristikave të peizazhit ekzistues;
- Të minimizohen ndërhyrjet vizuale dhe të zvogelohet natyra negative e çdo pengese vizuale;
- Të rikthehen apo të zmadhohen elementet e peizazhit ekzistues, të prekura drejtpërdrejt nga propozimi.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

12 MONITORIMI

Sistemi i monitorimit të ndikimeve në mjedis, të cilat do të shkaktohen nga zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2020-2030, është një mjet i thjeshtë për t'u përdorur për një monitorim efektiv.

Monitorimi i ndikimeve është jashtëzakonisht i rëndësishëm për zbatimin e MP, dhe në përputhje me Ligjin 91/2013 dhe Direktiven 2001/42/EC, zbatimi i një Plani apo Programi duhet të monitorohet, me qëllim që të identifikohen efektet negative të paparashikuara, në mënyrë që të krijohet mundësia për një reagim të hershëm ndaj këtyre efekteve dhe të behen adaptimet e mundshme.

Në këtë kuadër duhet ngritur një Sistem i Monitorimit të ndikimeve kryesore në mjedis, të cilat pritet që të shkaktohen nga zbatimi i strategjisë dhe projekte të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve. Këto ndikime janë identifikuar gjatë vlerësimit të ndikimeve mjedisore të strategjisë. Sistemi i monitorimit përfshin të gjithë indikatorët që përfaqësojnë secilin sektor mjedisor (natyra/biodiversiteti, toka, ndryshimet klimatike, uji, trashëgimia kulturore, peizazhi, etj.) dhe identifikon autoritetin dhe përgjegjësinë për matjen e çdo indikatorit mjedisor të propozuar.

Grumbullimi i të dhënave sugjerohet që të mbështetet në dy burime:

- a. të dhënat baze që merren nga matja e parametrave të mjedisit, dhe
- b. vlerësimi i indikatorëve mjedisore.

Procesi i mbledhjes së të dhënave përmes matjeve mund të realizohet duke përfshirë Autoritetet Rajonale (Qarqet), por edhe Institucionet Shtetërore (përmes Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Pushtetin Vendor, institucione kërkimore shkencore etj.). Matja e indikatorëve mjedisore është një proces kompleks; ai është një proces që kryhet rregullisht dhe për më tepër, në mënyrë të vazhdueshme.

Në këtë këndvështrim duhet që të bazohemi në eksperiencën dhe në sistemet e monitorimit që përdoren nga ente publike e private, duke theksuar, nga njëra anë, monitorimin e zbatimit të standardeve të nevojshme të matjeve të kryera, dhe nga ana tjetër, duke u përqendruar tek procesi i grumbullimit, përpunimit dhe shpërndarjes së të dhënave.

Autoritetet Rajonale duhet të luajnë një rol kyç në procesin e administrimit dhe shpërndarjes së të dhënave. Në këtë kontekst, drejtoritë përkatëse duhet të planifikojnë dhe të veprojnë si një qendër mbledhjeje, analizimi dhe shpërndarjeje të informacionit. Me konkretisht, roli i Autoriteteve Rajonale duhet të përfshijë sa më poshtë:

- Mbledhjen e të dhënave prej matjeve që kryhen nga instalimet publike dhe private rajonale, qoftë në mënyrë të përhershme, qoftë të përkohshme.
- Mbledhjen e të dhënave baze që kryhet nga shoqëritë e shërbimeve publike (ujesjelles – kanalizime, administrimi i mbetjeve, OSHEE, strukturat e menaxhimit të zonave të mbrojtura etj.).

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

- Marrjen e të dhënave baze që mbliidhen nga administrata publike (si psh Sistemi Kombëtar i Monitorimit të Cilësisë së Ujërave Siperfaqësore, etj).
- Marrjen e të dhënave baze që mbliidhen nga institucionet kërkimore shkencore dhe organizata të tjera.
- Analizën dhe sintezën e të dhënave, me qëllim nxjerrjen e konkluzioneve mbi gjendjen e mjedisit brenda një rajoni të caktuar.
- Ruajtjen e të dhënave dhe caktimin e intervaleve kohore me qëllim monitorimin e gjendjes së mjedisit në kohë të caktuara.
- Shpërndarjen e të dhënave përmes raporteve perkatese, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe vendimet e marra në nivel qarku/bashkie. Këto raporte synojnë që:
 - (a) të plotësojnë kërkesat e legjislacionit,
 - (b) të informojnë palet që marrin pjesë në procesin e planifikimit dhe monitorimit të zbatimit të strategjisë (vendim-marresit), dhe
 - (c) të informojnë publikun që preket nga zbatimi i strategjisë.

Monitorimi dhe rishikimi i vazhdueshëm i strategjisë duke përdorur burimet e nevojshme njerezore dhe financiare, çon në një zbatim të suksesshëm të tij. Strategjia parashikohet të pasqyrojë ndryshimet në modelet e konsumit nga ana e popullsisë, zhvillimin e teknologjisë dhe diskutimet e vazhdueshme në nivel rajonal dhe kombëtar lidhur me cilësinë dhe qendrueshmërinë e shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të përdorur.

Kriteret e zgjedhura për të vlerësuar ndikimet mjedisore duhet të jenë të matshme në mënyrë që të ndihmojnë në përcaktimin e suksesit të zbatimit të strategjisë. Për çdo çështje, kriteret duhet të shqyrtohen me tej për të përfshirë parametrat e matshëm të monitorimit, kjo për të lehtësuar vlerësimet që kryhen në kuadër të procesit të monitorimit.

Në shumicën e rasteve këto kritere duhet të vlerësohen duke iu referuar programeve ekzistuese dhe/ose të dhënave të grumbulluara si rezultat i lejeve mjedisore, vlerësimeve mjedisore dhe/ose programeve të tjera monitoruese kombëtare/rajonale/lokale, të cilat lidhen me zbatimin e detyrimeve mjedisore. Kjo do të mundësojë eliminimin e mbivendosjes së punës së kryer.

Qëllimi i programit të monitorimit, në kuadër të këtij raporti është pasja e një grupi të qendrueshëm të të dhënave që lidhen me aktivitetet e menaxhimit të shërbimit perkates, për të cilat (aktivitetet) mund të identifikohen ndikimet e mundshme negative në mjedis.

Të dhëna të rëndësishme që vijnë nga realizimi i objektivave dhe synimeve individuale të strategjisë, të cilat në vetvete kanë për qëllim arritjen e objektivave të strategjisë dhe në të njëjtën kohë përbejnë bazën e monitorimit të rezultateve të pritshme për gjithë strategjinë.

Së fundmi, duhet theksuar se të dhënat mjedisore të përfuara nga programi i monitorimit duhet të raportohen, publikohen dhe të vihen në dispozicion të publikut.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE, 2023-2030

Tabela 12-1: Model i Programit te Monitorimit te Ndikimeve ne Mjedis nga Strategjia

Nr	Aspekti Mjedisor	Indikator Mjedisor	Autoriteti Monitorues	Parametrat Mjedisore	Frekuenca e Monitorimit	Komente
1	Natyra (Biodiversiteti - fauna- flora)	<input type="checkbox"/> Sa habitate te rendesishme jane ne gjendje te kenaqshme <input type="checkbox"/> Numri dhe /ose siperfaqja me zona te mbrojtura <input type="checkbox"/> Permasat e biodiversitetit (numri i specieve endemike dhe te rralla) Numri dhe siperfaqja e mbuluar me zona natyrore	Strukturat e Menaxhimit te Zonave te Mbrojtura Drejtoria pergjegjese ne qark / bashki Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	<input type="checkbox"/> Habitatet <input type="checkbox"/> Numri dhe /ose siperfaqja me zona te mbrojtura <input type="checkbox"/> Numri i specieve endemike dhe te rralla Numri dhe siperfaqja e mbuluar me zona natyrore	Sipas Planit te Menaxhimit Çdo vit	
2	Popullsia – shendetet i njerezve	<input type="checkbox"/> Numri i ankesave te depozituara <input type="checkbox"/> Cilesia e ujit te destinuar per konsum Vitet e jetegjatesise se shendetshme	Drejtoria pergjegjese ne bashki	<input type="checkbox"/> Numri i ankesave te depozituara <input type="checkbox"/> Cilesia e ujit te destinuar per konsum Vitet e jetegjatesise se shendetshme	Çdo vit	

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE, 2023-2030

3	Uji	<input type="checkbox"/> Cilesia e ujerave siperfaqesore dhe nentokesore Ruajtja apo progresi drejt arritjes se statusit te mire ekologjik sipas WFD per ujerat sipefaqesore dhe nentokesore	Drejtoria pergjegjese ne qark Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	<input type="checkbox"/> Total N, total P, BOD, COD, LNP, TDS, pH, percjellshmeria, etj. pH, percjellshmeri, fortesia, kloridet, <input type="checkbox"/> sulfatet, COD, BOD, nitrati, nitrimi, total P, metalet, detergjentet, toksinat, etj. <input type="checkbox"/> Parametrat mikrobiologjike <input type="checkbox"/> Konsumi i ujit per fryme <input type="checkbox"/> Sasia e ujit te nxjerre Cilesia e ujit sipefaqesor dhe nentokesor Satusi ekologjik sipas WFD	Kampionim dhe matje sipas miratimit te kushteve mjedisore. Sipas Sistemit Kombetar te Monitorimit te Cilesise se Ujerave Siperfaqesore	Sipas Ligjit nr. 111/2012 “Per Menaxhimin e Integruar te Burimeve Ujore”. Sipas Ligjit nr. 9915, date 12.5.2008 “Per Kuadrin rregullator te sektorit te furnizimit me uje dhe largimin e trajtimin e ujerave te ndotur”.
4	Faktoret klimatike	<input type="checkbox"/> Shkarkimet e Gazrave Serre <input type="checkbox"/> shkarkimet sipas burimit (%) Kontribut ne reduktimin e rrjedhjeve <input type="checkbox"/> Menaxhimi I pershtashem I mbetjeve Mbyllja e vendepozitimeve ilegale	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit Drejtoria pergjegjese ne qark / bashki	<input type="checkbox"/> SOx, NOx, PM10, gazrat serre, Pb, CO <input type="checkbox"/>	Çdo vit	

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE, 2023-2030

5	Toka	<input type="checkbox"/> Nitratat ne ujera nentokesore Vellimi i <input type="checkbox"/> Planet e Menaxhimit te mbetjeve <input type="checkbox"/> Lendeve Ushqyese Sasite e pesticideve dhe plehrave te importuara Llumi i gjeneruar nga ujerat e perdorura	Drejtoria pergjegjese ne qark \ bashki Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	<input type="checkbox"/> Nitratat ne ujera nentokesore <input type="checkbox"/> Planet e Menaxhimit te mbetjeve <input type="checkbox"/> Lendeve Ushqyese <input type="checkbox"/> Sasite e pesticideve dhe <input type="checkbox"/> plehrave te importuara pH i ujit <input type="checkbox"/> permbajtja e elementeve kimike (Cd, Cu, Ni, Pb, Zn, Hg, Fe, Cr)	Çdo vit Çdo gjashte muaj per llumin	Sipas VKM nr. 99, date 18.2.2005, "Per miratimin e katalogut shqiptar te klasifikimit te mbetjeve" i ndryshuar
6	Trashegimia kulturore Peizazhi	<input type="checkbox"/> Numri i strukturave te pozicionuara larg zonave te trashegimise kulturore dhe arkeologjike, si nje perqindje e numrit total te strukturave per menaxhimin e mbetjeve Vendodhja specifike e strukturave Numri i ankesave te depozituara Numri i instalimeve te reja te vendosura ne peizazhe me nje ndryshim te larte ndaj	Drejtoria pergjegjese ne qark dhe bashki	<input type="checkbox"/> Numri i strukturave te pozicionuara larg zonave te trashegimise kulturore dhe arkeologjike, si nje perqindje e e numrit total te strukturave per menaxhimin e mbetjeve Vendodhja specifike e strukturave Numri i ankesave te depozituara Numri i instalimeve te reja te vendosura ne peizazhe me nje ndryshim te larte ndaj ndryshimit Te dhena qe merren prej VNMve specifike per qdo projekt	Çdo vit	

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

13 KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Procesi i VSM, nisur nga analiza e impakteve të objektivave të strategjise në lidhje me arritjen e Objektivave Mjedisore, konkludon si më poshtë:

- Permiresimi dhe sigurimi i infrastruktures së re të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, të lidhura me angazhimet drejt nxitjes dhe mbështetjes së investimeve që sigurojnë rritjen e shkallës së përpunimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane, me synim rritjen e vlerave të tyre brenda vendit, për të realizuar përpunimin e plotë dhe efikas, si vlerë e shtuar në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, për të arritur objektivat e kuadrit ligjor të BE për cilësinë e ujërave nga shkarkimet e ujërave të ndotura urbane dhe pajtueshmërinë me kuadrin ligjor për trajtimin dhe asgjësimin e llumrave të gjenruara nga trajtimi i ujërave të ndotura, pritet të permiresojë në veçanti statusin ekologjik të trupave ujore dhe ekologjine ujore në Shqipëri.
- Në përgjithësi, evidentohet që duke zhvilluar projektet e detajuara sipas praktikave më të mira dhe duke ndermarre gjithë masat zbutëse, të gjithë grupet e projekteve që do të planifikohen në të ardhmen janë të pranueshme nga këndvështrimi mjedisor.
- Analiza e ndikimeve tregon se gjatë zbatimit të objektivave të Strategjise Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve pritet që të ketë ndikime të rëndësishme pozitive ose me ndikime të vogla negative me mundësi riparimi, ndërkohë që asnjë objektiv nuk është vlerësuar në kundërshtim me Objektivat Mjedisore.
- Përgjithësisht, shumica e ndikimeve negative janë të lidhura me fazën e zbatimit dhe rehabilitimit apo ndërtimit të strukturave apo sistemeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, pasi Shqipëria ka veçori të theksuara diverse dhe të shumta nga ana natyrore, kulturore dhe peizazhiste që mund të ndikohen konsiderueshëm prej zhvillimeve të infrastruktures së strukturave / sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.
- Pritet që potencialet për ndikimet e pafavorshme mjedisore të identifikohen në mënyrë të detajuar gjatë fazave të zbatimit të Strategjise dhe, kur është e mundur, të adresohen gjatë përgatitjes së projekteve të detajuara përmes vlerësimit përkatës. Ndikimet mjedisore do të konsiderohen si pjesë e procesit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Vlerësimit Teknik në varesi të shkallës, vendit dhe natyrës së zhvillimit të propozuar.
- Në përgjithësi, synimet që përbejnë strategjinë vlerësohen të kenë një efekt kumulativ të perzier në Biodiversitet, të konsiderueshëm pozitiv dhe të vogël negativ, megjithatë madhësia e saktë e ndikimeve do të varen nga një masë në numrin, llojin dhe vendndodhjen e projekteve të propozuara.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

- Duke marrë parasysh çështjet ekzistuese të sistemit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Shqipëri, të kombinuara me mosperputhshmerinë ndaj kuadrit ligjor të BE, këto objektiva të vlerësohen të kenë një efekt pozitiv në sistemin e menaxhimit.
- Prioritetet dhe objektivat që përbejnë strategjinë pritet të ndihmojnë në zbatimin e ndryshimeve klimatike dhe të inkurajojnë përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Masat adaptuese në përgjigje të ndryshimeve klimatike përfshijnë zgjerimin e qendrueshmerisë së sistemeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, shqyrtimin e ndryshimeve klimatike dhe ngjarjeve ekstreme të motit në burimet ujore dhe zbatimin e Strategjisë së Adaptimit të Ndryshimeve Klimatike dhe Masave Zbutëse.
- Prioritetet dhe objektivat që përbejnë dokumentin strategjik drejtohen në mënyrë që të sjellin përfitime maksimale për palët e interesuara në sektorin e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Shqipëri, mjedisin dhe nevojat ekonomike të vendit duke njohur mungesën e baraspeshës mes nevojës për investime dhe financimit në dispozicion të kapitalit. Angazhimi me palët e interesuara, si dhe zbatimi i kriterëve transparentë të priorizimit të investimeve pritet të kontribuojnë në përcaktimin e përdorimit më të mirë të burimeve financiare në dispozicion, duke siguruar kështu që sektori i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të njihet dhe trajtohet si një burim ekonomik.
- Prioritetet dhe objektivat që përbejnë strategjinë vlerësohen të kenë një efekt kumulativ negativ të vogël dhe pozitiv të vogël në Tokë, me disa paqartësi në lidhje me llojin e përdorimit të tokës në vendet e përcaktuara për infrastrukturën e re të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në të ardhmen.
- Pritet që potenciali për impakte të pafavorshme mbi pasuritë e Trashëgimisë Kulturore të identifikohen gjatë përgatitjes së projekteve të detajuara dhe të adresohen ku është e përshtatshme përmes VNM aty ku kërkohet.
- Prioritetet dhe objektivat që përbejnë strategjinë vlerësohen se kanë një efekt kumulativ negativ të vogël mbi Peizazhin, me disa pasiguri që dalin nga vendodhjet e punimeve të detajuara dhe ndjeshmeria e mjedisëve përkatëse.

Në vijim raporti i VSM thekson edhe rekomandimet e mëposhtme të përgjithshme:

- ✓ Ka nevojë për të forcuar bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet autoriteteve përkatëse të sektoreve të caktuar për menaxhimin e ujërave me autoritetet e mjedisit dhe shëndetësisë, veçanërisht kur planifikohen ndërtimet e infrastrukturës së re të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve.
- ✓ Ka nevojë për integrim të mëtejshëm të zbatimit të strategjisë në sektorin e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve me planet sektoriale dhe ato vendore, me qëllim zbatimin e masave dhe procedurave të parashikuara nga VSM-ja dhe VNM-te specifike në vijim.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

- ✓ Ka nevojë për të siguruar nderveprimin mes sistemit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve dhe sistemet e trajtimit adekuat të shkarkimeve në mjedis, si dhe administrimin e zonave të mbrojtura, masat adoptuese ndaj ndryshimeve klimatike etj., i cili është i rëndësishëm për të shmangur ndikimet negative mjedisore në zonat apo sektorët përkatës.
- ✓ Plotesimi i standarteve mjedisore duhet të shoqërohet edhe me rritjen e portofolit financiar dhe investimeve në drejtim të menaxhimit dhe mbrojtjes së mjedisit.
- ✓ Rritja e transparencës në marrëdhënie me publikun për investimet e reja të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, kontrollin e shkarkimeve në ujë apo ajër, etj., ndihmon në rritjen e bashkëpunimit me publikun dhe zbatimin e politikave të parashikuara nga strategjia.
- ✓ Të gjitha zhvillimet e infrastruktures së ardhshme në kuadër të sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve do të përmbushin detyrimet e legjislativës për planifikimin dhe mjedisin, i cili do të përfshijë legjislativën përkatëse dhe politiken e planifikimit në lidhje me mbrojtjen e aseteve të trashëgimisë kulturore dhe peizazhin.

Si rekomandime specifike për Strategjinë Kombëtare të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2023 - 2030, për këto këndvështrimë të ndikimeve kumulative, mund të përmenden:

- ✓ Çdo projekt që paraqitet sipas fazave të zbatimit, që mund të ndikojë në një zonë të Natura 2000 do të jetë gjithashtu subjekt i kërkesave të vlerësimit të duhur (appropriate assessment).
- ✓ Lidhur me Zonat e Mbrojtura, krahas zbatimit me prioritet të Legjislativës Mjedisore dhe praktikave me të mira, siç parashikon edhe strategjia, kur projektet krijojnë ndikim të rëndësishëm në zonat e mbrojtura dhe për më tepër kur ato ndodhen brenda tyre duhet të aplikohet me prioritet legjislativën për zonat e mbrojtura.
- ✓ Potenciali për ndikime të padëshirueshme në Shëndetin e Njeriut, në lidhje me afersinë e receptoreve të ndjeshëm dhe kushtet baze si cilësia e trupave ujorë, duhet të menaxhohet/zvogëlohet aty ku është e mundur duke përdorur praktikën me të mira.
- ✓ Punimet e ndërtimit për projektet e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve kanë potencial të shkaktojnë ndotje që mund të kontaminojnë rrjedhat ujore, veçanërisht duke pasur parasysh që disa vepra do të ndërmerren në afersi të rrjedhave ujore. Duhet të merren masat përkatëse që këto efekte të zbuten dhe të rezultojnë në një efekt neutral ndaj Cilësive dhe Sasive të Ujit.
- ✓ Projektet duhet të jenë subjekt të vlerësimit të rrezikut nga përmblytjet, kur është e nevojshme, në mënyrë që ndikimet mbi përmblytjet të mund të shmangen dhe të mos jenë të rëndësishme. Në këtë drejtim, Strategjia për Adaptimin dhe Zbutjen e Ndryshimeve Klimatike vlerëson vulnerabilitetin e shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

per ngjarjet e ndryshimeve klimatike dhe identifikon veprimet per te modifikuar infrastrukturen ose operacionet e Ujit ne Shqiperi.

- ✓ Masat ne lidhje me monitorimin e ujerave si dhe aplikimi i masave adaptuese kundrejt permbytjeve dhe ngritjes se nivelit te detit duhet te nderthuren qe ne fazat e hershme te projektimit. Keto masa jane efektive kur aplikohen te integruara ne pellgun ujembledhes te lumenjve dhe bregdetit. Masat adaptuese jane integruar ne Raportin e Komunikimit te Trete te Shqiperise per UNFCCC.
- ✓ Ne teresi, projektet duhet te projektohen ne harmoni me standartet e ruajtjes se peizazhit dhe mbrojtjen e trashegimise kulturore, ku se bashku me elementet e cilesise se mjedisit te jene paresore duke aplikuar praktikat me te mira.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

SHTOJCE 1

KONSULTIMET ME PUBLIKUN

Ne kuader te procesit te VSM jane organizuar 2 degjesa me grupet e interesit, perkatesisht per procesin e identifikimit te ceshtjeve qe do te trajtoheshin ne raportin e VSM (scoping) me 03.03.2023. Degjesa e dyte eshte zhvilluar per te konsultuar draft raportin e VSM me xx.xx.2023, ku kane marre pjese perfaqesues te instiucioneve shteterore te perfshira ne kete proces dhe perfaqesues te shoqerise civile.

A. KONSULTIMI ME GRUPET E INTERESIT PËR ÇËSHTJET QË DO TË TRAJTOHEN NË RAPORTIN E VSM-së (SCOPING)

STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

03.03.2023, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë - Salla e Mbledhjeve

Sikurse përcaktohet në nenin 9 të Ligjit nr. 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”, procedura e konsultimit me grupet e interesit kërkohet të përmbushet gjatë disa fazave të VSM-së. Qëllimi i fazës së parë të konsultimit ishte arritja e një marrëveshjeje me palët përkatëse të interesit lidhur me çështjet që do të trajtohen në raportin paraprake të VSM-së, i cili do të përgatitet në kuadër të miratimit të Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, 2023-2030.

Më datë 03.03.2023, në Sallën e Mbledhjeve të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, u zhvillua konsultimi me publikun për sa i përket çështjeve që do të trajtohen në raportin e VSM-së së strategjisë së përmendur më sipër.

Në takim ishin të pranishëm përfaqësues nga institucionet e renditura më poshtë:

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Agjencia Kombëtare e Ujësjetillës-Kanalizimeve dhe Mbetjeve;
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC);
- Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore;
- Enti Rregullator i Ujit;
- Shoqata Ujësjetillës Kanalizime e Shqipërisë (SHUKALB);
- Instituti i Shëndetit Publik.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE, 2023-2030

Në vijim paraqitet një përmbledhje e zhvillimit të konsultimit me grupet e interesit për çështjet që do të trajtohen në raportin paraprakë të VSM-së, prezantimi i mbajtur dhe gjithashtu listëprezenca e palëve të pranishme, shoqëruar me foto:

Nr.	Zhvillimi	Personi përgjegjës	Komente
1.	Mirëseardhja dhe qëllimi i takimit	Përfaqësues i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë / AKUM	Fillimisht iu urua mirëseardhja palëve të pranishme në takim dhe gjithashtu iu bë me dije se qëllimi i konsultimit në këtë fazë të VSM-së është përcaktimi i çështjeve që do të trajtohen në këtë raport, për të cilin kontributi nga palët e interesuara është i mirëpritur.
2.	Prezantimi i procesit të VSM që do të ndiqet dhe i çështjeve që propozohen të shqyrtohen gjatë hartimit të VSM	Konsulenti mjedisor	<ol style="list-style-type: none"> 1. U prezantua historiku i Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, 2019-2030 dhe i VSM-së që do të realizohet në 2019; 2. U shpjeguan hapat që do të ndiqen për finalizimin e VSM-së dhe fazat e konsultimit me grupet e interesit që janë të nevojshme për realizimin e raportit të VSM-së. Gjithashtu pjesëmarrësit u vendosën në dijeni se institucionit vendimmarrës (Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit) i është nisur shkresa për njoftimin për fillimin e procedurës.
3.	Prezantimi i qëllimit dhe objektivave të Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit Me Ujë dhe Kanalizimeve, 2023-2030	Konsulenti mjedisor	Shkurtimisht u prezantuan disa informacione bazë të Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, 2023-2030, duke qenë se drafti final i strategjisë është ndarë me grupet e interesit dhe palët ishin familjarizuar tashmë me materialin.
4.	Pyetje dhe diskutime		Pas përfundimit të prezantimit nga Konsulenti, u la hapësirë për pyetje nga palët e interesuara. Një përmbledhje e diskutimit të zhvilluar jepet më poshtë:

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE, 2023-2030

Nr.	Zhvillimi	Personi përgjegjës	Komente
			<p>1. Përveç çështjeve të sugjeruara nga konsulenti mjedisor, nga përfaqësuesja e Institutit të Shëndetit Publik, znj. Lindita Molla u sugjerua që të shtohet dhe biodiversiteti si një çështje kyçe në sektorin e furnizimit me ujë. Duke qenë se burimet ujore shfrytëzohen për furnizimin e popullsisë me ujë të pijshëm, rrjedha ekologjike e këtyre burimeve ndikohet, duke krijuar problematika për biodiversitetin e zonës (pra shfrytëzimi i ujit kthehet në një presion për basenin ujqor, psh: në rastin e rezervuarit të Bovillës, ku tashmë janë hasur probleme në rrjedhën ekologjike të lumit Tërkuzë).</p> <p>2. Një nga pikat e përcaktuara nga Konsulenti në çështjet me interes për VSM ishte dhe “Aksesi në ujë për grupet e cënuara”, ku pas ngritjes së pyetjes nga palët e interesuara, u elaborua më tej se domethënia e grupeve të cënuara konsiston në popullsi e cila ndodhet jashtë rrjetit të mbulimit të ujësjellës – kanalizimeve (kryesisht në zona rurale apo zona gjeografike të vështira), si dhe grupet minoritare që jetojnë në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>Gjithashtu, në kuadër të kapitullit 27. “Mjedisi” të legjislacionit të BE dhe negociatave të Republikës së Shqipërisë për integrimin në BE, palët e pranishme dakordësuan se strategjia ka një ndikim tepër pozitiv.</p> <p>Në mbyllje të konsultimit paraprak të VSM-së, palët e interesuara u njoftuan se brenda një afati kohor dy javor mund të dërgojnë sugjerimet e tyre lidhur me çështjet që do të trajtohen në raportin e VSM-së në formë shkresore ose me e-mail.</p>

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR

STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE, 2023-2030



VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR

STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË
FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE, 2023-2030

KONSULTIMI ME GRUPET E INTERESIT PËR ÇËSHTJET
QË DO TË TRAJTOHEN NË RAPORTIN E VSM-së

03 Mars 2023

“ESDO” SHPK - Konsulencë mjedisi

QËLLIMI I TAKIMIT

- ✓ Të përcaktojë çështjet kryesore që do të trajtohen në mënyrë specifike në raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor,
- ✓ Identifikojë cilat mund të jenë çështjet mjedisore që nuk është e nevojshme të trajtohen me detaje dhe që nuk është e nevojshme të përfshihen në analizë të mëtejshme.

Grupet e interesit që konsultohen në këtë fazë janë:

- ✓ institucionet e mbrojtjes së shëndetit publik;
- ✓ njësitë e qeverisjes vendore;
- ✓ institucionet e mbrojtjes së tokës bujqësore;
- ✓ shoqatat mjedisore (OJF) aktive në fushën e mbrojtjes së mjedisit;
- ✓ institucionet e tjera që identifikohen me përgjegjësi në propozim (ministritë etj.).

VSM DHE RËNDËSIA E TIJ


Vlerësimi Strategjik Mjedisor - Vlerësimi Strategjik Mjedisor është një proces sistematik që vlerëson pasojat në mjedis të një plani ose programi të propozuar për zbatim me qëllim që të sigurojë që këto pasoja mjedisore të adresohen plotësisht që në fazat e hershme të vendimmarrjes përkrah konsideratave ekonomike dhe sociale.

- Gjatë procesit të VSM identifikohen zonat me rëndësi dhe përparësi mjedisore duke u bërë kriter planifikues ato janë shpëtuar nga dëmtime të pakthyeshme dhe shteruese (si rrjeti i burimeve ujore dhe distancat që duhet të ruhen për ndërtimet pranë tyre);
- I zhvilluar që në fazat e hershme të planifikimit VSM mundëson të analizohet një gamë më të gjerë alternativash duke i dhënë mjedisit me shumë shanse të ruajtjes së cilësive të tij. Nëse planifikimi realizohet pa proces VSM atëherë kriteret mjedisore mund të jenë të cënuara edhe për shkak të mos përfshirjes së ekspertëve të mjedisit;



VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR

STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE, 2023-2030



QËLLIMI

- ✓ **Të përcaktojë çështjet kryesore** që do të trajtohen në mënyrë specifike **në raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor,**
- ✓ **Të argumentojë se cilat mund të jenë çështjet mjedisore që nuk është e nevojshme të trajtohen me detaje** dhe që nuk është e nevojshme të përfshihen në analizë të mëtejshme.

SCOPING

Faza e konsultimit me grupet e interesit për çështjet që do trajtohen në raportin e VSM-së (scoping) **renditet e dyta** gjatë fazave të procedurës së Vlerësimit Strategjik Mjedisor.

➤ Kjo fazë **ka rëndësi të veçantë për fazën pasardhëse,** e cila është **hartimi i raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor.**

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR

STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE, 2023-2030

Gjatë kësaj faze, duhet të përshkruhen paraprakisht:

- ✓ **alternativat** e mundshme ose opsionet të cilat duhet të adresohen në kuadër të VSM-së;
- ✓ **dimensionet territoriale** të ndikimeve të mundshme;
- ✓ **analiza dhe sondazhe** që do të kryhen, si dhe **metodat dhe mjetet që do të përdoren**;
- ✓ **Palët e interesuara që do të jenë të përfshira** (duke përfshirë autoritetet mjedisore dhe shëndetësore, si dhe publikun), si dhe nivelin dhe natyrën e përfshirjes së tyre në procedurën e VSM-së.



✓ **Çështjet e identifikuar në këtë fazë** të konsultimit, **adresojnë vlerësimin bazë të mjedisit**, vlerësimin aktual të ndikimeve të mundshme dhe do të mbajë në konsideratë alternativa ose opsione të mundshme, prandaj është dhe një hap kyç për një VSM efikas.

✓ **Qëllimi i përcaktuar mirë i vlerësimit** mundëson mbajtjen e VSM-së të fokusuar në problemet kyçe dhe kështu minimizon kërkesat personale dhe kohën.

✓ **Jo të gjitha aspektet mjedisore duhet të adresohen në çdo vlerësim** - nga ana tjetër, VSM-ja mund të konsiderojë përfshirjen e temave më të gjëra mjedisore ose sociale p.sh. përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike, mundësitë e punësimit etj.




Kjo fazë konsultimi ndihmon:

- i. për të identifikuar lidhjet midis planit/ programit të vlerësuar me të dokumente të tjera strategjike;
- ii. për të mbështetur zjedhjen e çështjeve kyçe (pra, nëse ka objektiva të përcaktuara në dokumenta zyrtar të miratuar, kjo do të thotë se janë të rëndësishme dhe duhet të adresohen në VSM).



EVEN AN EXCELENT PLAN CAN STILL HAVE NEGATIVE CUMULATIVE EFFECTS WITH OTHER PLANS!



VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR

STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE, 2023-2030

STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE, 2023-2030

DEKLARATA E MISIONIT TË STRATEGJISË

Hartimi i politikave të përshtatshme dhe angazhimi i fondeve të mjaftueshme për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura, dhe për të ecur në mënyrë të qëndrueshme drejt përputhjes me standardet e Bashkimit Europian dhe me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

PARIMET Kryesore të Strategjisë së Sektorit

QËNDRUESHMËRI	Shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizime duhet të jenë ekologjikisht, teknikisht dhe financiarisht të qëndrueshëm përmes mbulimit të plotë të kostos.
PËRPUTHSHMËRI	Spektori i furnizimit me ujë dhe kanalizime ofron çasje universale që i plotëson të gjitha kërkesat rregullatore / europiane sipas parimit ndotësi paguan.
EFICIENCË	Shoqëritë e furnizimit me ujë dhe kanalizime të kenë efikasitet dhe performancë të cilësisë së shërbimit të barabartë me praktikën e mirë evropiane.
PËRBALLUESHMËRI	Të sigurohet ofrimi i shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për konsumatorët me një çmim të përballueshëm.
TRANSPARENÇË	Të sigurohet pjesëmarrja e publikut dhe transparencja në politikat e ujit.

- Mbulimi i përgjithshëm i furnizimit me ujë në nivel kombëtar paraqitet në nivelin 78.06% deri në vitin 2022.
- Mbulimi me matje për të gjithë konsumatorët familjarë me gjithë përmirësimet e viteve të fundit, mbetet në nivelin rreth 81.6% në 2022.
- Bazuar në të dhënat e vitit 2022 shërbimi i kanalizimeve iu ofrohet rreth 74% të konsumatorëve që shërbehen edhe me furnizimin me ujë nga ku 91 % në zonat urbane dhe 26 % në zonat rurale.
- Referuar të dhënave nga AKUM, aktualisht janë ndërtuar dhe janë në funksionim 12 impiante në zonat urbane dhe turistike si dhe janë në proces ndërtimi 3 impiante të reja. Gjithashtu, janë planifikuar për t'u ndërtuar 2 impiante në zona urbane me potencial zhvillimi turistik.
- Në vitin 2022, norma mesatare e sigurisë për klorin mbetës ishte 95% dhe 99% për koliformën.

- Si rezultat i rritjes së investimeve kapitale është rritur ndjeshëm numri i zonave urbane dhe rurale me furnizim me ujë mbi 20 orë/ditë.
- Vazhdimësia e shërbimit, është vlerësuar mesatarisht rreth 14.9 orë/ditë në të gjithë vendin për vitin 2021.
- Në vitin 2022, niveli mesatar i ujit pa të ardhura (UPA) për të gjithë sektorin ishte rreth 63.7 %, shifër ende shumë e lartë, por me një nivel përmirësimi prej 1.5 % krahasuar me të dhënat e viteve paraardhëse. Gjithashtu, niveli i ujit pa të ardhura ndryshon shumë nga një shoqëri në tjetrën, duke variuar në vlerat 20% deri 84%.
- Të ardhurat nga tarifat përfaqësojnë afërsisht 46% të burimeve të financimit të përgjithshëm të sektorit të ujit në Shqipëri. Subvencionet/ Taksat përfaqësojnë 32%, që kryesisht vijnë nga buxheti i shtetit ndërsa trasfertat nga Donatorët e huaj përfaqësojnë deri në 22%.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR

STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE, 2023-2030

Qëllimi i Politikës I:

Zgjerimi dhe përmirësimi i aksesit në sistemet e furnizimit me ujë për popullsinë.

OBJEKTIVI SPECIFIK 1.1 Rritja e aksesit të popullsisë në sistemet e furnizimit me ujë të sigurt.

OBJEKTIVI SPECIFIK 1.2 Rritja e orëve të furnizimit me ujë për popullsinë në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërive rajonale UK.

OBJEKTIVI SPECIFIK 1.3 Hartimi i planeve për përdorimin e ujit me efikasitet në të gjithë sektorët, duke siguruar furnizim të qëndrueshëm dhe duke rritur ndjeshëm ripërdorimin e tij sipas parimeve të ekonomisë qarkulluese.

OBJEKTIVI SPECIFIK 1.4 Hartimi dhe zbatimi i planeve rajonale për reduktimin i nivelit të Ujit Pa të Ardhura..

OBJEKTIVI SPECIFIK 1.5 Përmirësimi i cilësisë së ujit të pijshëm.

Qëllimi i Politikës II:

Zgjerimi dhe përmirësimi i aksesit në sistemet për grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura për popullsinë.

OBJEKTIVI SPECIFIK 2.1 Rritja e aksesit të popullsisë të lidhur me sistemin e grumbullimit dhe largimit të ujrave të ndotura.

OBJEKTIVI SPECIFIK 2.3 Rritja e aksesit të popullsisë të lidhur me një impiant të trajtimit të ujrave të ndotura.

Qëllimi i Politikës III:

Zbatimi i programit për riorganizimin e shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura në baza rajonale.

OBJEKTIVI SPECIFIK 3.1 Zhvillimi i një programi të bashkënduar me NJOV për riorganizimin e të gjithë shoqërive egjistuese UK në shoqëri rajonale si Subjekte të Kompetencave të Përbashkëta UK.

OBJEKTIVI SPECIFIK 3.2 Ristrukturimi dhe reformimi rrënjësor i institucioneve qëndrore në funksion të zbatimit të programit për riorganizimin e shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura në baza rajonale.

OBJEKTIVI SPECIFIK 3.3 Ngritja e një sistemi për monitorimin dhe vlerësimin e ecurisë së zbatimit të procesit për riorganizimin e shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura në baza rajonale.

Qëllimi i Politikës IV:

Forcimi i qëndrueshmërisë financiare dhe përbalueshmërisë së shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizime ndaj parimeve të kontrollit të koston dhe mbulimit të plotë të koston.

OBJEKTIVI SPECIFIK 4.1 Mbulimi i koston të mirëmbajtjes, dhe shpenzimeve kapitale për riparime dhe zëvendësime.

OBJEKTIVI SPECIFIK 4.2 Zhvillimi dhe unifikimi gradual i tarifave sipas zonave rajonale të shërbimit, për të mundësuar gradualisht, mbullimin e plotë të koston duke synuar mbrojtjen e konsumatorit me të ardhura të ulta...

OBJEKTIVI SPECIFIK 4.3 Rritja e nivelit të arkëtimit, duke synuar praktikat më të mira ndërkombëtare.

OBJEKTIVI SPECIFIK 4.4 Përmirësimi i sistemit të faturimit dhe instalimi i sistemit të pagesave online për konsumatorët.

OBJEKTIVI SPECIFIK 4.5 Hartimi dhe zbatimi efektiv i një sistemi të unifikuar të menaxhimit dhe mirëmbajtjes së aseteve për shoqëritë rajonale UK.

OBJEKTIVI SPECIFIK 4.6 Implementimi i një qasje të re në investimet në sektor drejt reduktimit të konsumit të energjisë nga shoqëritë rajonale UK, nëpërmjet implementimit i një qasje të re në investimet në sektor drejt reduktimit të konsumit të energjisë nga shoqëritë rajonale UK, nëpërmjet investimeve për furnizimin me energji nga fotovoltazhet, vendosjes së pompave sipas krieseve të BE dhe instalimi i programit SCADA që rrit efektivitetin e tyre.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR

STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE, 2023-2030

Qëllimi i Politikës V:

Rritja e kapaciteteve dhe miradministrimi i shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura.

OBJEKTIVI SPECIFIK 5.1 Hartimi i një platforme dhe mekanizmave për zhvillimin e njohurive dhe trajnimeve për të gjithë aktorët sektoriale në nivel qendror dhe lokal.

OBJEKTIVI SPECIFIK 5.2 Zbatimi i vazhdueshëm i programit për trajnimin e punonjëseve të shoqërive rajonale UK për rritjen e kapaciteteve profesionale, forcimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimin e eksperiencave mes tyre.

OBJEKTIVI SPECIFIK 5.3 Zbatimi i programit kombëtar të certifikimit sipas objektivave që janë përcaktuar për secilin shoqëri rajonale UK.

OBJEKTIVI SPECIFIK 5.4 Implementimi i një strukture re eficiente të unifikuar për shoqëritë rajonale UK.

OBJEKTIVI SPECIFIK 5.5 Hartimi dhe zbatimi i një plani të detajuar për transformimin dixhital dhe i një qasjeje të integruar për sigurinë kibernetike për administrimin e shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura.

Qëllimi i Politikës VI:

Permiresimi dhe perditësimi i kuadrit ligjor, rregullator që mundëson ofrimin e shërbimeve furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura për popullsinë.

OBJEKTIVI SPECIFIK 6.1 Përmirësimi dhe zgjerimi i akteve ligjore dhe rregullatore të nevojshme për të lehtësuar procesin e riorganizimit të shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura, në baza rajonale.

OBJEKTIVI SPECIFIK 6.2 Hartimi i ligjit të ri sektorial për shërbimet e furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura, me qëllim shtimin e mekanizmave për bashkërendimin e politikave dhe përgjegjësi të aktorëve kryesorë sektoriale.

OBJEKTIVI SPECIFIK 6.3 Harmonizimi i buadrit ligjor kombëtar për shërbimet e furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura në përputhje me direktivat e BE për ujën.

OBJEKTIVI SPECIFIK 6.4 Hartimi dhe Zbatimi i Paketave të Ndërgjegjësimi dhe Informimi për Qytetarët.

OBJEKTIVI SPECIFIK 6.5 Zbatimi i mekanizmave për forcimin dhe përfshirjen gjimore në sektorin e ujit.

DISA NGA CESHTJET ME INTERES PER VSM

- Shfrytëzimi i burimeve ujore
- Ndërtimet ne terren te infrastruktures
- Ndotja e ujrave nga shkarkimet
- Trajtimi dhe perdorimi i llumit
- Cilesia dhe higjena e plazheve
- Cilesia e ujit te pijshem dhe shendeti publik
- Aksesi ne uje per grupet e cenuara
- Ndryshimet klimatike

Kontakt:

Per komente dhe sugjerime lutemi te kontaktoni ne adresat e meposhtme:

Gerta.Ismailaja@infrastruktura.gov.al

Florian.Demi@akum.gov.al

env.sd.office@gmail.com

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE, 2023-2030

Lista e pjesëmarrësve

Konsultimi me grupet e interesit për çështjet që do të trajtohen në raportin e VSM-së (scoping)

Strategjia Kombëtare e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, 2023-2030

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, 3 Mars 2023

Nr.	Emër Mbiemër	Institucioni	pozicioni	e-mail	Firma
1	Flora Demi	AKUM	Dr. Ekonomik	flora.demi@akum.gov.al	[Signature]
2	Sokol Kriza	ERRU	Dr. Teleniko Ekonomik	sokol.kriza@erru.al	[Signature]
3	Eliana Gjini	SASPAC	Dr. Projektore	eliane.gjini@saspac.gov.al	[Signature]
4	Alda Zeiraj	AKUM	Dr. Planifikim Invest	alda.zeiraj@akum.gov.al	[Signature]
5	Gerta Ismailaj	MIE	Perzi Sektor	gerta.ismailaj@infushkme.gov.al	[Signature]
6	Ornelo Shabani	ESDO	exp. mjedisi	-/-	[Signature]
7	Greta Malaj	ESDO	specialiste mjedisi	greta0malaj@gmail.com	[Signature]
8	Ilda Shahu	MTM	specialist	ilda.shahu@turizmi.gov.al	[Signature]
9	Shkëlqë Kelle	ISHP	shf departuli	shkelqekelle@ishp.gov.al	[Signature]
10	Zhaneta Muska	NRKMS	shkëmbimi	zhaneta.muska@nrkms.gov.al	[Signature]
11	ARBANA KOLA	SHUKALB	Menaxhere Projekti	arbana.kola@shukalb.al	[Signature]
12	Geo Boduni	MIE	Specialist	geo.boduni@infushkme.gov.al	[Signature]
13	Rovena Meksi	AKUM	P/Sektor	rovena.meksi@akum.gov.al	[Signature]
14	Elsa Belba	AKUM	S/D Planifikim Invest	elsa.belba@akum.gov.al	[Signature]
15					
16					
17					
18					

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

Foto gjatë zhvillimit të konsultimit me publikun për sa i përket çështjeve që do të trajtohen në raportin e VSM-së



VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030



VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030



VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030

